



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

SPECIFIKIME TEKNIKE

ARTIKUJT

KOSTUMI I UNIFORMËS PËR FEMRA, PËR PUNONJËSET E POLICISË SË SHTETIT

KOSTUMI I UNIFORMËS PËR MESHKUJ, PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

KRAVATË E KOSTUMIT TË UNIFORMËS, PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

PANTALLONA VERORE PËR MESHKUJ, PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

PANTALLONAT DHE FUNDI VEROR PËR FEMRA, PËR PUNONJËSET E POLICISË SË SHTETIT

KAPELE E UNIFORMËS VERORE PËR MESHKUJ DHE FEMRA, PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

KOSTUMI I SHËRBIMIT CIVIL PËR FEMRA, PËR PUNONJËSET E ZYRËS SË PRITJES SË QYTETARËVE NË POLICINË E SHTETIT

KOSTUMI I SHËRBIMIT CIVIL PËR MESHKUJ, PËR PUNONJËSIT E ZYRËS SË PRITJES SË QYTETARËVE NË POLICINË E SHTETIT

Specifikimet Teknike të artikujve të mësipërme janë hartuar në përputhje me V.K.M-në Nr.55 dt.27.01.2016, VKM -në Nr.399 dt.01.06.2016, dhe urdhërit të Ministrit të Punëve të Brendshme Nr. 548 datë 05.10.2016 "Për miratimin e ndryshimeve të disa elementëve të uniformës së Policisë së Shtetit". Këto Specifikime Teknike parashtrojnë në mënyrë të detajuar kërkesat themelore teknike të domosdoshme për ndërtimin e prototipit dhe prodhimin e artikullit.

Specifikimet Teknike përcaktojnë gjithashtu edhe kërkesat teknike të aksesorëve që duhet të shoqërojnë artikullin.

Prodhuesit janë të detyruar që t'i zbatojnë të gjitha specifikimet teknike të këtij dokumenti.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Kostumi i uniformës për femra

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *kostumi i uniformës për femra* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Per tekstin e xhaketes, pantallonave dhe fundit

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja %	100% Lesh "pura lana vergine" Hollesia e leshit 19 m.c $\pm 5\%$ Gjatesia e fibres min. 65 mm	
Thurja	diagonale 2/1 (sarzh)	
Masa gr/m ² % ($\pm 3\%$)	210 gr/m ²	
Hollesia e fijos ($\pm 5\%$)	Baza - 2/60 Nm 7.6	Indi - 2/60 Nm
Dendësia ± 1	Baza 36 fije/cm	Indi 24 fije/cm
Qëndrueshmëria ne terheqje	Baza $\geq 380N$	Indi $\geq 280N$
Tkurrrja ne pastrim ne te thate	Baza $< 1\%$	Indi $< 1\%$
Pershkueshmëria e ajrit	$> 45 \text{ lm}^2/\text{s}$	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi) (2000)	nota 4–5	
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4.0 - 9.0	

Per tekstin e kapeles

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja %	100% Lesh "pura lana vergine" Hollesia e leshit 21.25 m.c $\pm 5\%$ Gjatesia e fibres min. 58.75 mm	
Thurja	diagonale 2/1 (sarzh)	
Masa gr/m ² % ($\pm 3\%$)	200 gr/m ²	
Hollesia e fijos ($\pm 5\%$)	Baza - 2/65 Nm	Indi - 2/64.76 Nm
Dendësia ± 1	Baza 37 fije/cm	Indi 22, 5 fije/cm
Qëndrueshmëria ne terheqje	Baza $\geq 440 N$	Indi $\geq 250N$
Tkurrrja ne pastrim ne te thate	Baza $< 1\%$	Indi $< 1\%$
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.

Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle
Efekti pilling (kokërrzimi)	5-6
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm
pH	4.0 - 7.5

Per astaret e brendshëm te kostumit (xhakete, pantallona dhe fund)

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja %	100% Viskoze	
Thurja	diagonale (sarzh)	
Masa gr/m ² (± 3%)	84 gr/m ²	
Hollesia e fijos (± 3%)	Baza 78Dtex	Indi 120 Dtex
Dendësia ±1	Baza 53 fije/cm	Indi 30 fije/cm
Kendi i rekuperimit pas ngjeshjes	Baza >100°	Indi > 92°
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota 5 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4.0 - 9.0	

Per astarin e brendshëm te kapeles

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja %	100% Viskoze	
Thurja	diagonale (sarzh)	
Masa gr/m ² % (± 3%)	80 gr/m ²	
Hollesia e fijos (± 3%)	Baza 87.2Dtex	Indi 112.7 Dtex
Dendësia ±1	Baza 52.5 fije/cm	Indi 30.5 fije/cm
Kendi i rekuperimit pas ngjeshjes	Baza >103°	Indi > 92°
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota 5 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4.0 - 9.0	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të

jetë: e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: jo më pak se – nota 6: shumë e mirë.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në ofertën teknike do të kryhet ky testim: kampioni i tekstit me ngjyrë blu të errët do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu e errët nuk njollos tekstin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

XHAKETA

b. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *xhaketa e kostumit të uniformës për femra*:

Astar		
Shtresë prej shajaku për nën jakën	Përbërja	50% lesh, 50% poliestër
	Ngjyra	blu e errët
	Pesha	185 gr/m ² ± 5%
Përforcues		
Krinolinë	Thurja	Garniturë
	Pesha	295 gr/m ² ± 5%
Shtresë prej frazeline termoadezive me ngjyrë të errët.		
Shtresë prej frazeline termoadezive me ngjyrë antracite për paramonturën/jakën.		
Shtresë prej frazeline termoadezive me ngjyrë të zezë për jakën.		
Shtresë prej frazeline termoadezive me ngjyrë të zezë për spaletat, kapakët e xhepave dhe xhepat.		
Shirit prej frazeline termoadezive për ngjitjen e palës në fund të xhaketës me lartësi rreth 4cm.		
Fileto zbukuruese		
Fileto cilindrike zbukuruese për mëngët dhe jakën.	Trashësia	± 3 mm
	Përbërja	100% <i>viscose</i>
	Ngjyra	e kuqe
Aksesorë të tjerë		
Element <i>Velcro</i> femër për vendosjen e numrit të identifikimit/shenjës ose mbiemrit dhe elementë <i>Velcro</i> me formën e stemës dhe shenjave që do të vendosen tek mëngët e xhaketës.	Përmasat <i>Velcro</i> të gjoksit (1 copë)	86 mm x 30 mm
	Përmasat <i>Velcro</i> të mëngëve (2 copë)	70 mm x 80 mm
	Përbërja	100% fibra poliamide
	Trashësia	2.2 mm

	Masa lineare		41 g/m ± 5%
	Ngjyra		njësoj si xhaketa
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë		- 30° C
	E nxehtë	pika e dobësimit	180° C
		pika e shkrirjes	210 – 250° C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
	Në larje	jo më pak se 3	
	Në ujë të nxehtë		
	Në djersë		
Në fërkim			
Vatina prej materiali 100% poliamid			
Filli			
Fill qepës për të gjitha qepjet (përfshi vrimat dhe travetat).	Përbërja		100% poliestër
	Numri metrik		80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje		jo më pak se 12N
	Ngjyra		njësoj si xhaketa
Fill për tegelat zbukurues të brendshëm të xhaketës.	Numri metrik		30 Nm
	Ngjyra		e kuqe
Kopsa metalike			
 shembull 	4 copë me d 25 mm* + 1 rezervë		
	12 copë me d 15 mm** + 2 rezervë, një me pamje në të majtë dhe një me pamje në të djathtë.		
	Trashësia	në qendër	* 3 mm
			** 2 mm
		në buzë	* 2 mm
			** 1 mm
	Gjerësia e konturit rrethues		* 2 mm
			** 1 mm
	Tipi	me këmbëz me karficë	
		gjatësi	* 7 mm
			** 5mm
		gjerësi	4 mm
		trashësi	2 mm
	diametri i vrimës		2 mm
	Ngjyra e kopsës		e artë, me shkëlqim mat
	Materiali		tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm
			Përkrenarja e Skënderbeut
	Gdhendje	përmasa	* 12x16 mm
			** 8x10 mm

Aksesorë metalikë			
2 ornamente me formën e stilizuar të <i>Përkrenares së Skënderbeut</i> që do të vendosen tek jaka.		Tipi	me 2 këmbëza me filetimit
		Përmasat	25 x 31 mm
		Trashësia	2.5 mm
		Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm
		Ngjyra	e artë, me shkëlqim mat
		Reliev	sipas ilustrimit zyrtar
Etiketa			
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese, masën e xhakëtës dhe instruksionet e mirëmbajtjes.		Përbërja	100% poliestër
		Ngjyra	e bardhë

PANTALLONAT

c. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesoreve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *pantallonat e kostumit të uniformës për femra*:

Astar		
Tekstil <i>Silesia</i> prej pambuku për qemerin, profilimin e sallkisë dhe astarin e xhepave.	Përbërja	100% pambuk
	Thurja	diagonale me vija
	Ngjyra	e zezë
Përforcues		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me vrima me gjerësi rreth 6 cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me lartësi rreth 3.5cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive e hollë për ylykët.		
Fileto zbukuruese		
Fileto cilindrike zbukuruese për pantallonat (për policet).	Trashësia	± 3 mm
	Përbërja	100% <i>viscose</i>
	Ngjyra	e kuqe
Aksesorë të tjerë		
Zinxhir	Gjatësia	16–18 cm
	Përbërja	100 % poliestër
	Ngjyra	njësoj si pantallonat
1 kapëse metalike femër-mashkull për qemerin e pantallonave.		
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet (përfshi vrimat dhe travetat).	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N

	Ngjyra	njësoj si tekstili
Etiketa		
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese dhe instruksionet e mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë
Kopsa plastike		
Kopsa plastike	1 copë Nr. 34 (d 21mm) + 1 rezervë	
	Ngjyra e kopsës	blu e errët
	Materiali	100% poliestër
	Qepja e kopsës	Kryq

FUNDI

d. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit fundi i kostumit të uniformës për femra:

Astar		
Tekstil <i>Silesia</i> për xhepat	Përbërja	100% pambuk
	Thurja	diagonale me vija
	Ngjyra	e zezë
Përforcues		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me vrima me gjerësi rreth 6 cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me lartësi rreth 3.5cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive e hollë për ylykët.		
Fileto zbukuruese		
Fileto cilindrike zbukuruese për fundin (për policet).	Trashësia	± 3 mm
	Përbërja	100% <i>viscose</i>
	Ngjyra	e kuqe
Aksesorë të tjerë		
1 zinxhir me dhëmbëza plastikë me ngjyrë blu të errët me të njëjtin tonalitet si tekstili.	Gjatësia	16–18 cm
	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	njësoj si fundi
1 kapëse metalike femër-mashkull për qemerin e fundit		
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet (përfshi vrimat dhe travetat).	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N

	Ngjyra	njësoj si fundi
Kopsa plastike		
	1 copë Nr. 34 (d 21mm) + 1 rezervë.	
	Ngjyra e kopsës	blu e errët
	Materiali	100% poliestër
	Qepja e kopsës	Kryq
Etiketa		
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese dhe instruksionet e mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë

KAPELA

d. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *kapela e uniformës për femra*

Përforcues		
Tekstil i kollarisur për përforcimin e kurorës	Përbërja	100% pambuk
	Pesha	250 g/m ² ± 5%
Tekstil i kollarisur për përforcimin e strehës.	Përbërja	100% pambuk
	Pesha	220 g/m ² ± 5%
Fileto zbukuruese		
fileto cilindrike zbukuruese për kurorën e kapelës.	Trashësia	± 3 mm
	Përbërja	100% viskoze
	Ngjyra	e kuqe
Fashë dekorative me konture të kuqe.	Gjerësia	30 mm
	Trashësia e kontureve	3 mm
	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	Blu shumë e errët
Aksesorë të tjerë		
Shirit prej lekure gjedhi me ngjyrë të zezë për pjesën e perimetrit të brendshëm të kapeles.		
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese dhe instruksionet e mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë
Llastik i zi me gjerësi 1 cm dhe gjatësi 36 cm për kapjen e kapelës në kokë.		
Filli		
Fill për të gjitha qepjet.	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	njësoj si kapela
Fill për qepjen e strehës.	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	30 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N

Ngjyra		njësoj si kapela		
Aksesorë të lëvizshëm				
Kopsa metalike  Shembull 		2 copë me d 15 mm një me pamje nga e majta dhe një me pamje nga a djathta.		
		Trashësia	në qendër	2 mm
			në buzë	1 mm
		Gjerësia e konturit rrethues		1 mm
		Tipi	me këmbëz rrumbullake	
			gjatësia	5 mm
			gjerësia	4 mm
			trashësia	2 mm
		diametri i vrimës		2 mm
		Ngjyra	e artë, me shkëlqim mat	
Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm			
Gdhendje	Përkrenarja e Skënderbeut			
	përmasa	8 x 10 mm		
Karficë metalike për montimin e kopsave në kapele.				
Rrip dekorativ me ylykë për shtrëngim. 		Rripi dekorativ		
		Përbërja	100 % PVC	
		Ngjyra	e zezë, me shkëlqim	
		Lartësia	14 mm	
		Trashësia	1 mm	
		Gjatësia	25 cm	
		Unaza 2 (copë)		
		Gjerësia	15 mm	
		Lartësia	17 mm	
		Trashësi	1 mm	
		Përbërja	Plastike	
		Perçina (2 copë)		
		Diametër	7 mm	
		Përbërja	Metalike	
		Ngjyra	e zezë	
				

Stema metalike		Tipi	me 2 këmbëza me filetimit
		Përmasat	6 x 5 cm
		Trashësia	± 2 mm
		Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm
		Ngjyra	e artë, me shkëlqim mat
		Skalitje	detajet e emblemës

Kopsat metalike, stema, rripi dekorativ i zi i kapelës dhe ornamentet e jakës do t'u nënshtrohen testeve të mëposhtme:

- **Rezistencës ndaj ujit.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur në ujë të distiluar për 24 orë në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria ndaj solucioneve larëse.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për 24 orë në ujë me solucion sapun larës 3% në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria ndaj solucioneve tretëse.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë fërkuar lehtë me furçë, me alkool metilik e më pas me benzinë.
- **Qëndrueshmëria ndaj klorurit të sodiumit.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për një orë në 1% klorur sodiumi në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje.** Nuk duhet të ketë ndryshime të ngjyrës pasi të jetë trajtuar me 5% solucion HCl.
- **Rezistenca ndaj korrozionit.**

Produkti final do t'i nënshtrohet kontrollit fizik të thjeshtë në mënyrë që të vërtetohet plotësimi i kushteve teknike për secilin element si p.sh: që materialet e përdorura janë të përshtatshme për produktin, pamja dhe konstruksioni i përgjithshëm, stilizimi, vlerat estetike, etj. Kontrolli do të bëhet me sy të lirë dhe me mjete të caktuara.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë kopsa, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- kokërrzim (punime të ashpra),
- tonalitete të ngjyrës,
- ndryshim në dendësi të materialit,
- deformime të imazhit të skalitur,
- shkëputje të pjesëve,
- gropëzime ose plasaritje,
- relieve jo të rregullta,
- metalizim jo i rregullt dhe jo rezistent,
- oksidime,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon pamjen funksionale dhe estetike të produktit.

e. Materialet që nevojiten për paketimin e artikullit *kostumi i uniformës për femra*
Fotografitë e mëposhtme shërbejnë vetëm si shembull ilustrues.

	
kremastar për xhaketën dhe pantallonat	çantë pambuku për paketimin e kostumit
	
kremastar për fundin	qese polietilene për kopsat rezervë
kuti kartoni për paketimin e kostumeve	
qese plastike polietilene për paketimin e kapeles	

Të gjithë mjetet dhe aksesoret mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *kostumi i uniformës për femra* do të porositet dhe do të prodhohet në masat 36–54 dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



1	Perimetri i kokës	cm.
2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i krahavorit (poshtë gjoksit)	cm.
5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.
9	Distanca mes gjokseve	cm.
10	Perimetri i krahut	cm.
11	Perimetri i kyçit të dorës	cm.
12	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.
13	Lartësia nga vija e belit në vijën e kockës abdominale	cm.
14	Lartësia e pjesës abdominale (nga vija e belit në vijën e vitheve)	cm.
15	Gjatësia nga beli në vijën e gjurit (poshtë kupës së gjurit)	cm.
16	Gjatësia nga beli në kockën e kavaljes	cm.
17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
18	Lartësi e përgjithshme e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në tokë)	cm.
19	Gjatësia e supit	cm.
20	Gjatësia nga supi në bërryl	cm.
21	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës.	cm.
22	Gjatësia e shtratis e matur ulur.	cm.
23	Gjatësia e brendshme këmbës deri në vijën e gjurit.	cm.
24	Gjatësia e brendshme këmbës deri në kavalje	cm.
25	Gjatësia e personit	cm.

3. NGJYRAT REFERENCË



Ngjyra blu spektri sipas CIECLCH 18, 14.587, 295.349 për të gjitha pjesët e kostumit të uniformës, astarit dhe kapelës.

Ngjyra e kuqe spektri sipas CIECLCH 41, 70.780, 28.754 për filetot dhe fijet dekorative.

Ngjyra e artë spektri sipas CIECLCH 72, 63.619, 74.057 për kopsat metalike dhe për shenjat dekorative metalike.

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *kostumi i uniformës për femra*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Kollaritja

Ngjitja e materialit tekstil kollaritës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 130–140° C, me kohëzgjatje 8–10 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet kollaritja me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I KOSTUMIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të kostumit të uniformës për femra.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.


I. XHAKETA



Khaketa e uniformës për femra është e njëjtë në tekstil dhe ngjyrë me atë të meshkujve, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra dhe kopsave, të cilat duhet të jenë në anën e majtë.

Pjesët përbërëse të xhaketës:

- Pjesa e përparme (me dy pjesë)
- Dy xhepa me kapakë të gjoksit
- Dy xhepa të mëdhenj të poshtëm me kapakë
- Dy pjesë anësore (fianket)
- Dy paramontura
- Jaka e poshtme dhe e sipërme
- Pjesa e pasme (me dy pjesë)
- Dy spaleta
- Dy mëngë
- Astari i brendshëm



Elementë dekorativ metalik



Kopsa e madhe d.25 mm



Kopsa e vogël d.15 mm



PJESA E PËRPARME E XHAKETËS

Pjesët e përparme. (1) Buzët e pjesës së përparme duhet të përshkohen vertikalisht nga një tegel zbukurues sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 1mm nga buza. Tegeli duhet të fillojë në cepin e poshtëm dhe duhet të përfundojë në afërsi të jakës.

Struktura e xhakëtës duhet të përforcohet me dy shtresa: një prej frazeline termoadezive dhe tjetra prej krinoline. Shtresat duhet të vendosen vetëm në pjesët e përparme. Shtresa prej frazeline termoadezive duhet të vendoset në të gjithë sipërfaqen e xhakëtës ndërsa krinolina vetëm tek supet dhe tek gjoksi. Shtresat përforcuese duhet të jenë fshehura mes astarit dhe tekstit të xhakëtës.

Jaka e poshtme duhet të jetë standarde me kulme. Duhet pasur kujdes që gjatë palosjes së jakës mos të shfaqen defekte.

Pencat (2) duhet të fillojnë në mes të pjesës fundore të xhepave të gjoksit dhe përfundojnë në anë të pjesës së sipërme të xhepave të mëdhenj.

Kopsat. Xhaketa duhet të jetë e pajisur me katër kopsa metalike me diametër 2.5 cm.

Kopsat duhet të qepen në anën e majtë të xhakëtës në një distancë 8.5 cm nga njëra-tjetra. Qepja e kopsave të mëdha duhet të bëhet sipas ilustrimit të mësipërm të xhakëtës.

Vrimat e kopsave duhet të hapen në pjesën e djathtë (të veshur) të xhakëtës me drejtim horizontal.

Gjatësia e vrimave të kopsave duhet të jetë 30 mm, distanca e vrimave nga buza e xhakëtës duhet të jetë 15 mm ndërsa distanca e vrimave nga njëra-tjetra duhet të jetë 85 mm.

Vrima e parë duhet të hapet atje ku fillon thyerja e jakës.

Fundi i xhakëtës (3) duhet të përfundojë me një palosje të brendshme 3cm. Palosja duhet të përforcohet me frazeline termoadezive me lartësi 4cm. Në fillim duhet të vendoset frazelina pastaj duhet të bëhet palosja. Fundi i xhakëtës duhet të mbulojë vithet. *Shiko kapitullin e marrjes së masave*

Vatat duhet të përbëhen nga një shtresë vatin e përforcuar në të dy anët me tekstil adeziv methurje garniturë (1:1).

Vatat duhet të kenë formë ovale nga njëra anë dhe të drejtë nga ana tjetër.

Ajo duhet të qepet në brendësi të xhakëtës, tek linja e supëve, midis tekstit të xhakëtës dhe astarit. Brinja e drejtë duhet të qepet tek tegeli i gavaturës ndërsa brinja rrethore duhet të jetë e lirë.

Vatina duhet të jenë prej materiali 100% poliamid.

JAKA E SIPËRME

Jaka e sipërme (6) duhet të përbëhet nga një shtresë tekstili me ngjyrë blu të errët të përforcuar me frazelinë termoadezive dhe një shtrese prej shajaku me ngjyrë të zezë.

Tekstili dhe shtresa prej shajaku duhet të bashkohen me njëra-tjetrën nëpërmjet një tegeli linear një gjilpërësh me distancë 1 mm nga buza e jakës.

Ndërmjet dy shtresave duhet të qepet një shirit cilindrik (fileto) dekorativ i kuq me trashësi 3 mm. Shiriti duhet të qepet në të tre anët e jakës.

Jaka e sipërme, gjuhëza dhe trupi i xhakëtës duhet të bashkohem me anë të tegelave linearë një gjilpërësh me distancë rreth 1 mm nga buzët.

Tek kulmet e jakës së sipërme duhet të montohen ornamentet metalike dekorative ngjyrë ari me formën e stilizuar të *Përkrenares së Skënderbeut*. Ornamentet duhet të montohen me anë të mbërtheckave metalike me fileto. Përkrenaret duhet të shohin nga njëra-tjetra.



PARAMONTURAT (7)

Të dy pjesët e përparme të xhaketës duhet të pajisen me paramontura me drejtim vertikal. Ato duhet të jenë dy pjesë tekstili të prera me formën e buzës së xhaketës dhe duhet të qepen nga brenda.

Paramonturat duhet të jenë të përforcuara me frazelinë termoadezive për paramonturë. Shtresa përforcuese prej frazeline termoadezive duhet të bashkohet me shtresën e paramonturës në tranxhë me avull të nxehtë.

Të gjitha shtresat (pjesët e përparme, paramonturat, astari) duhet të qepen me tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor me ngjyrë të kuqe me hapje 4 mm.

PJESËT ANËSORE (FIANKET) (9)

Fianket nuk kanë nevojë për përforcim me shtresa përforcuese.

PJESA E PASME E XHAKETËS (10)

Pjesa e pasme e xhaketës duhet të përbëhet nga dy pjesë.

Çarja e pasme e xhaketës duhet të ketë lartësi rreth 21 cm dhe thellësi 4 cm. Ana e majtë duhet të jetë mbi anën e djathtë.

Çarja duhet të jetë e përforcuar me shtresë frazeline dhe në pjesën e sipërme çarja duhet të jetë e kufizuar me anë të tegelit qepës në drejtim transversal.

Fundi i xhaketës duhet të përfundojë me një palosje të brendshme 3 cm të përforcuar me frazelinë termoadezive me lartësi 4 cm. Në fillim vendoset frazelina pastaj bëhet palosja.

ASTARI


Trupi i xhaketës dhe mëngët duhet të jenë të veshur nga brenda me astar. Astar duhet të jetë i ndarë në gjashtë pjesë kryesore (katër pjesë përpara dhe dy pjesë mbrapa), të bashkuara ndërmjet tyre me anë të tegelit linear një gjilpërësh. Astar duhet të qepet tek palosja e brendshme e fundit të xhaketës dhe duhet të qëndrojë pak i varur, si thes. Që astari të qëndrojë si thes, ai duhet të jetë 1.5 cm më i gjatë se pjesa e pasme e xhaketës.

XHEPAT E BRENDSHËM

Xhaketa duhet të pajiset me dy xhepa të brendshëm me fileto të dyfishtë, me hapje 13 cm, thellësi 17 cm dhe distancë 8.5 cm nga buza e përparme e xhaketës. Një xhep në të majtë dhe një në të djathtë.

Astar i xhepit duhet të përshkohet nga një tegel linear një gjilpërësh me distancë rreth 5 mm nga buza. Hapja e xhepit duhet të jetë në të njëjtin drejtim me vrimën e dytë të xhaketës.

XHEPAT E GJOKSIT (4)



Xhaketa duhet të ketë xhepa të vegjël me kapak me kopsë, palë të dyanshme dekorative dhe tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Përmasat e xhepave duhet të jenë 12 x 12.5 cm ndërsa përmasat e kapakëve të xhepave duhet të jenë 12 x 5.5 cm. Pala dekorative duhet të jetë 3cm e gjerë. Xhepat dhe kapakët duhet të kenë formë drejtkëndore dhe kulme në formë trapezi.

Xhepat dhe kapakët duhet të përshkohen nga një tegel linear një gjilpërësh me distancë 1 mm nga buzët.

Xhepat dhe kapakët e xhepave duhet të përbëhen nga një shtresë tekstili e përforcuar me frazelinë termoadezive dhe astari. Shtresa përforcuese prej frazeline termoadezive duhet të bashkohet me tekstin në tranxhë me avull të nxehtë.

Xhepat duhet të qepen në lartësinë e gjoksit dhe në linjë me kopsën e parë të xhaketës. Kapakët e xhepave duhet të qepen me kthim pale 5 mm dhe në një lartësi prej 15 mm mbi xhepa.


Vrima e kopsës duhet të jetë 20 mm e gjatë me drejtim vertikal. Ajo duhet të vendoset në aksin qendror të kapakut me distancë 15 mm nga buza e poshtme e kapakut. Kopsa gjithashtu duhet të vendoset në aksin qendror të xhepit me distancë rreth 15 mm nga buza e sipërme. Kopsa duhet të jetë me diametër 15 mm, metalike, ngjyrë ari dhe me *Përkrenaren e Skënderbeut* të skalitur në sipërfaqe.

Kujdes! Kopsat me *Përkrenaren e Skënderbeut* duhet të shohin njëra-tjetrën. (Shiko ilustrimin teknik të xhaketës.)

Mbi xhepin e djathtë (të veshur) duhet të qepet një element *Velcro* femër ngjyrë blu (si materiali bazë i xhaketës) me përmasa 8,6 x 3 cm, e cila do të shërbejë për fiksimin e gradës së gjoksit ose numrit të identifikimit.

Kujdes! Vendosja e xhepave mund të ndryshojë tek masat e vogla dhe të mëdha të kostumit.

XHEPAT E MËDHENJ TË POSHTËM (5)



Xhaketa duhet të ketë xhepa të mëdhenj me kapak me kopsë, palë të dyanshme dekorative dhe tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Përmasat e xhepave duhet të jenë 18 x 17 cm ndërsa përmasat e kapakëve të xhepave duhet të jenë 18 x 6 cm. Pala dekorative duhet të jetë 3.5 cm e gjerë. Xhepat dhe kapakët duhet të kenë formë drejtkëndore dhe kulme në formë trapezi.

Xhepat dhe kapakët duhet të përshkohen nga një tegel linear një gjilpërësh me distancë 1 mm nga buzët.

Xhepat dhe kapakët e xhepave duhet të përbëhen nga një shtresë tekstili e përforcuar me frazelinë termoadezive dhe astari. Shtresa përforcuese prej frazelinë termoadezive duhet të bashkohet me tekstilin në tranxhë me avull të nxehtë.

Xhepat duhet të qepen në një linjë horizontale me kopsën e katër. Kapakët e xhepave duhet të qepen me kthim pale 5 mm dhe në një lartësi prej 15 mm mbi xhepa.


Në brendësi të xhepit, rreth 1cm poshtë buzës së sipërme, duhet qepur një copë tekstili me të njëjtin material si astari dhe me përmasa 1.5 x 13 cm. Ky përforcues i qepur në të katërta anët shërben për të mbuluar e forcuar qepjen e pencave dhe të fiankeve.

Vrima e kopsës duhet të jetë 20 mm e gjatë me drejtim vertikal. Ajo duhet të vendoset në aksin qendror të kapakut me distancë 15 mm nga buza e poshtme e kapakut. Kopsa gjithashtu duhet të vendoset në aksin qendror të xhepit me distancë rreth 15 mm nga buza e sipërme. Kopsa duhet të jetë me diametër 15 mm, metalike, ngjyrë ari dhe me *Përkrenaren e Skënderbeut* të skalitur në sipërfaqe.

Kujdes! Kopsat me *Përkrenaren e Skënderbeut* duhet të shohin njëra-tjetrën. (Shiko ilustrimin teknik të xhakëtës.)

Kujdes! Vendosja e xhepave mund të ndryshojë tek masat e vogla dhe të mëdha të kostumit.

SPALETAT(8)



Spaletat duhet të jenë drejtkëndore në njërin anë dhe me kulm (me formë shigjete) në anën tjetër. Ana drejtkëndore duhet të qepet tek tegeli i rrethit të mëngës (gavatura). Katër brinjët e tjera përshkohen nga një tegel perimetral sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 5 mm nga buza.

Spaleta duhet të ndërtohet me dy shtresa tekstili ngjyrë blu (njësoj si xhaketa) me përmasa të njëjta. Shtresa e sipërme e spaletës duhet të përforcohet me frazelinë termoadezive.


Vrima e kopsës duhet të jetë në anën e “shigjetës”, distancë rreth 1.5cm nga kulmi. Gjatësia e vrimës së kopsës duhet të jetë 20mm.

Kopsa duhet të qepet në të njëjtin pozicion tek supi i xhaketës. Kopsa duhet të jetë me diametër 15 mm, metalike, ngjyrë ari me Përkrenaren e Skënderbeut të skalitur në sipërfaqe. **Kujdes!** Kopsat e vogla të spaletave me Përkrenaren e Skënderbeut duhet të shohin njëra-tjetrën (shiko ilustrimin teknik të xhaketës).

Gjatësia e spaletës duhet të ndryshojë në varësi të masës së xhaketës. Gjatësia e spaletës duhet të rritet me 2–3 mm për çdo masë. Dimensionet bazë duhet të jenë këto: 13.5 x 4,8 cm për masën më të vogël të xhaketës dhe 15 x 4,8 cm për masën më të madhe të xhaketës

Aksi qendror gjatësor i spaletave duhet të përputhet me tegelin qepës të supeve.

MËNGËT (11)



Mëngët duhet të përbëhen nga dy pjesë: mënga e sipërme dhe mënga e poshtme. Dy pjesët duhet të qepen me njëra-tjetrën me tegel linear një gjilpërësh.

Mëngët duhet të përfundojnë me një çarje false gjatësore me lartësi 8 cm për kopsat. Buzët e çarjes duhet të jenë të mbivendosura me rreth 4 cm.

Kopsat dhe vrimat duhet të jenë gjithashtu false, vetëm për funksion estetik. Kopsat duhet të jenë metalike ngjyrë ari me diametër 15 mm dhe me *Përkrenaren e Skënderbeut* të skalitur në sipërfaqe ndërsa vrimat e kopsave duhet të jenë 20 mm të gjata.

Në fillim të çarjes, 8 cm nga fundi i mëngës duhet vendosur një shirit (fileto) cilindrik perimetral dekorativ me diametër 3 mm.

Mënga duhet të mbyllet në fund me një palosje të brendshme me lartësi 3 cm që qepet me astarin.


VELCRO (12)

Khaketa e kostumit të uniformës duhet të pajiset me tre elementë *Velcro* femër:


- 1 copë për vendosjen e gradës së gjoksit/ numrit të identifikimit me përmasa 86 x 30 mm.
- 1 copë për vendosjen e stemës së policisë në mëngën e majtë me përmasa 70 x 80 mm.
- 1 copë për vendosjen e shenjave në mëngën e djathtë me përmasa 70 x 80 mm.

Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel zig-zag perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonale. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e shtresës përforcuese prej frazeline në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstit gjatë qepjes dhe përdorimit. Elementët *Velcro* në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 6 cm nga gavatura e mëngës.

Kujdes! Elementët *Velcro* për mëngën e djathtë duhet të priten në përputhje me shërbimet që kryen punonjësja e policisë. Kufiri i lejuar i gabimit për elementët *Velcro* është ± 1 mm.



II. PANTALLONAT



Konstruksioni i pantallonave për femra duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pjesët përbërëse të pantallonave:

- Qemeri
- Dy pjesët e këmbëve
- Dy xhepat e përparmë

QEMERI (1)

Lartësia e qemerit duhet të jetë 3.5 cm. Qemeri duhet të jetë i përbërë nga dy shtresa tekstili me përmasa të njëjta (brenda dhe jashtë) dhe nga dy shtresa të brendshme përforcuese. Renditja e shtresave të qemerit duhet të bëhet si më poshtë:

1. Shtresa e jashtme prej tekstili të njëjtë me pantallonat.
2. Shtresa e dytë e brendshme me lartësi rreth 6 cm prej tekstili termoadeziv.
3. Shtresa e tretë përforcuese me frazelinë termoadezive me vrima.
4. Shtresa e brendshme (e pantallonave) me tekstil *Silesia* me lartësi rreth 7 cm.

Qemeri duhet të bashkohet me pantallonat me tegel të padukshëm.

Qemeri duhet të ketë një shtesë prej 3 cm (nga vijat e zinxhirit) në të dy anët. Shtesat duhet të përfundojnë me kulme në formë shigjete. Në njërin shtesë duhet të hapet vrima e kopsës me gjatësi 25 mm ndërsa në tjetrën duhet të qepet kopsa e pantallonave.

Në anën e brendshme të qemerit, në linjë me zinxhirin duhet të montohet një kapëse e thjeshtë me mekanizëm “femër-mashkull”.



Kopsat duhet të jenë Nr. 34 (21 mm) me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsave duhet të bëhet kryq.

Ylykët (2) Pantallonat duhet të kenë gjithsej 5 ylyqe me gjatësi 5 cm dhe gjerësi 1 cm. Dy përpara dhe tre mbrapa. Ylykët e përparme duhet të vendosen ngjitur me xhepat. Dy ylyqe të pasme duhet të vendosen ngjitur me pencat nga pjesa e brendshme dhe një në linjën qendrore të pantallonave.

Ylykët duhet të përbëhen nga dy shtresa tekstili ngjyrë blu (si pantallonat) dhe një shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive.

Ato duhet gjithashtu të përforcohen në të dy skajet me traveta ngjyrë blu të errët.

DY PJESET E KËMBËVE

Sallkia (4) duhet të ndërtohet me dy pjesë: pjesa e mbuluar dhe kapaku (e zinxhirit). Pjesa e mbuluar duhet të jetë e veshur me tekstil *Silesia* nga brenda dhe me tekstinin e pantallonave nga jashtë ndërsa kapaku duhet të qepet nga të dyja anët me tekstinin e pantallonave.

Zinxhiri i sallkisë. Gjatësia e zinxhirit mund të ndryshojë sipas masave, nga 16–18 cm.

Zinxhiri duhet të jetë me fiksion tek koka në mënyrë që të mos hapet vetë gjatë veshjes.

Ngjyra e zinxhirit duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e pantallonave.

Shiritat e kuq dekorativë. (3) Tek tegelat anësorë të këmbëve duhet të qepet fileto dekorative cilindrike me gjerësi ± 3 mm.

Pencat. (5) Në pjesën e pasme të pantallonave, poshtë qemerit, duhet të qepen dy penca vertikale me gjatësi 7 cm, një në të majtë dhe një në të djathtë.

Astari. Pantallonat duhet të jenë të veshura me astar vetëm në pjesën e përparme, deri poshtë linjës së gjurit. Astari duhet të jetë prej materiali me përbërje 100% *viscose*.

Tegeli anësor i këmbëve dhe fundet e pantallonave duhet të jenë të profiluara me syzator.

XHEPAT (6)

Xhepat diagonalë. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonalë. Hapja e xhepit duhet të fillojë poshtë qemerit, në një distancë 3 cm nga tegeli anësor i pantallonave dhe të përfundojë po tek tegeli anësor.

Xhepat duhet të jenë 16 cm të gjatë. Ai duhet të përforcohet në të dy ekstremitetet e tij me travetë.

Xhepat duhet të përshkohen gjatë gjithë gjatësisë nga një tegel linear me distancë 7 mm nga buza e jashtme.

Në pjesën e dukshme (mostra) xhepat duhet të jenë të veshur me tekstil të njëjtë me pantallonat. Astari i xhepave duhet të jetë prej tekstili *Silesia*.

III. FUNDI I UNIFORMËS PËR FEMRA



Konstruksioni i fundit për femra duhet të jetë sipas modelit klasik me gjatësi deri poshtë kupës së gjurit. *Shiko linjat për referencë te figura e marrjes së masave.*

Pjesët përbërëse të fundit:

- Qemerit
- Pjesa e përparme
- Pjesa e pasme (me dy pjesë)
- Dy xhepat e përparmë

QEMERI (1)

Qemeri duhet të jetë i përbërë nga një shtresë e vetme tekstili e palosur në dysh e përforcuar me frazelinë termoadezive.


Qemeri duhet të jetë 3.5 cm i lartë dhe duhet të bashkohet me fundin me tegel të padukshëm.

Qemeri duhet të zgjatet me 3 cm në të dyja anët. Shtesat duhet të përfundojnë me formë drejtkëndore. Tek shtesa duhet të hapet vrima e kopsës me gjatësi 25 mm ndërsa në ekstremitetin tjetër të qemerit duhet të qepet kopsa e fundit.

Kopsat duhet të jenë Nr. 34 (21 mm) me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsës duhet të bëhet me vija paralele.

Ylykët.(2) Fundi duhet të ketë gjithsej 4 ylyqe me gjatësi 5 cm dhe gjerësi 1 cm, dy përpara dhe dy mbrapa. 2 ylykët përpara dhe 2 ylykët mbrapa duhet të vendosen ngjitur me pencat, nga ana e brendshme. *Shiko ilustrimin më poshtë.*

Ylykët duhet të jenë të përbërë nga një shtresë e vetme tekstili e palosur në dysh e përforcuar me frazelinë termoadezive. Ato duhet gjithashtu të përforcohen në të dy skajet me traveta ngjyrë blu të errët.



PJESA E PËRPARME DHE E PASME

Xhepat diagonalë. (5) Fundi duhet të pajiset me dy xhepa të përparmë diagonale.

Hapja e xhepit duhet të fillojë poshtë qemerit, në një distancë 3 cm nga tegeli anësor i fundit dhe të përfundojë po tek tegeli anësor. Xhepat duhet të jenë 16 cm të gjatë. Ato duhet të përforcohen në të dy ekstremitetet e tyre me travetë.

Xhepat duhet të përshkohen gjatë gjithë gjatësisë nga një tegel linear me distancë 7 mm nga buza e jashtme.

Në pjesën e dukshme (mostra) xhepat duhet të jenë të veshur me tekstil të njëjtë me fundin. Astari i xhepave duhet të jetë prej tekstili *Silesia*.

Pencat (3): Fundit duhet t'i vendosen përpara dy penca me gjatësi 7 cm dhe dy penca mbrapa me gjatësi 9 cm.

Shiritat e kuq dekorativë. (4) Tek tegelat anësore duhet të qepen fileto dekorative cilindrike me gjerësi ± 3 mm.

Zinxhiri (7) duhet qepet në aksin qendror, mbrapa dhe duhet të jetë i mbuluar. Gjatësia e tij do të ndryshojë sipas masave nga 16–18 cm. Zinxhiri duhet të jetë me fiksime që të mos hapet vetë gjatë përdorimit të fundit.

E çara e fundit (8) duhet të jetë në fund të linjës së prerjes dhe të ketë lartësi 15 cm. Në brendësi duhet të ketë një palë të brendshme me gjerësi 5.5 cm.

Pala duhet ta ketë palosjen: pjesa e djathtë mbi të majtën.

Astari duhet të ndërtohet me tre pjesë (një para dhe dy mbrapa) dhe të ketë të njëjtën prerje si fundi. Ai duhet të qepet tek buza e poshtme e qemerit.


Njësoj si tek fundi, edhe tek astari duhet të qepen dy penca përpara dhe dy penca mbrapa.

Në linjën fundore të tij astari duhet të jetë i kthyer dy herë dhe i qepur me tegel qepës linear.

Astari duhet të ndërtohet me tekstil, përbërja e të cilit duhet të jetë 100% material *viscose*.

IV. KAPELA E UNIFORMËS PËR FEMRA





Kapela do të porositet dhe do të prodhohet në masat 51 – 60 dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të *Policisë së Shtetit*.

Pjesët përbërëse të kapelës:

1. Tavani i kapelës (pjesa e sipërme e kapelës)
2. Kurora
3. Streha
4. Brendia
5. Shiriti dekorativ prej tekstili me kotur të kuq
6. Fileto cilindrike dekorative
7. Kopsat metalike anësore
8. Stema
9. Rripi i zi dekorativ
10. Llastiku

Përmasat e masës 51	
Lartësia e kurorës	8 cm
Perimetri i kokës	54 cm
Perimetri i tavanit	47 cm
Gjatësia e strehës përpara	7 cm
Gjatësia e strehës prapa	5.5 cm
Gjatësia e strehës anash	7 cm
Perimetri i strehës (e hapur)	80 cm

Tavani i kapelës duhet të ketë formë ovale. Ajo duhet të përbëhet nga një shtresë tekstili ngjyrë blu të errët (si xhaketa) dhe një shtresë tekstili pambuku të kollarisur për t'i dhënë formë kapelës.

Kurora e kapelës duhet të përbëhet nga një shtresë tekstili ngjyrë blu të errët (si xhaketa) dhe një shtresë tekstili pambuku të kollarisur për t'i dhënë formë kapelës.

Kurora duhet të qepet në pjesën e pasme të kokës.

Lartësia e kurorës duhet të ndryshojë në varësi të masës së kapelës.

Astari i brendshëm i kapelës duhet të jetë i bardhë me material 100% viskoze. Ai duhet të veshë të gjithë brendinë e kapelës.




Foto për referencë e tekstilit të pambukut të kollarisur

Streha e kapelës duhet përbëhet nga dy shtresa tekstili ngjyrë blu të errët (si xhaketa) me përmasa të barabarta të përforcuara secila me nga një shtresë tekstili pambuku të kollarisur për t'i dhënë formë strehës.

Shtresat e strehës duhet të bashkohen me njëra-tjetrën me anë të 9 tegelave lineare një gjilpërësh sipërfaqësorë në largësi çdo 5 mm.

Pjesët anësore të strehës duhet të qëndrojnë të palosura dhe të fiksuara në anë të kurorës.

Në të majtë dhe në të djathtë kurorës vendoset nga një kopsë metalike.

Shirit prej lëkure. Tek buza e poshtme e fashës rrethore të kapelës duhet të qepet një shirit perimetral prej lëkure që shërben për mbrojtjen e kapelës nga djersët. Buza e sipërme e shiritit duhet të jetë e lirë. Shiriti duhet të jetë prej lëkure gjedhi me ngjyrë të zezë dhe me vrima për ajrosje.

Midis fashës rrethore dhe shiritit perimetral prej lëkure duhet të qepet një fije plastike përforcuese perimetrale me trashësi 0.5 mm që ndihmon ruajtjen e formës së kapelës.

Etiketa me emrin e fabrikës duhet të qepet tek astari i tavanit.

ELEMENTËT DEKORATIVË

Llastiku i zi me përmasa 1 cm gjerësi dhe gjatësi 35 cm duhet të qepet në të dyja anët e kapelës ndërmjet shiritit prej lëkure dhe kurorës.

Shiriti dekorativ duhet të jetë ngjyrë blu shumë e errët (pothuajse në të zezë) dhe i konturuar me shirita të kuq në buzë. Sipërfaqja e fashës duhet të jetë e vijëzuar (me kurrije).

Shiriti duhet të jetë i lartë 3 cm ndërsa konturet e kuqe duhet të kenë trashësi ± 3 mm.

Shiriti duhet të bashkohet me kapelën me anë të tegelit qepës përgjatë bordurës së poshtme të shiritit.

Në anën e pasme duhet të modelohet një shirit tjetër si fjongo për efekt dekorativ. *Shiko më sipër modelin e kapelës.*

Filetoja cilindrike dekorative duhet të qepet atje ku bashkohet kurora me kupolën e kapelës. Ajo duhet të ketë të njëjtën ngjyrë me vijat e kuqe tek shiriti dekorativ. Filetoja duhet të jetë prej materiali 100% viskoze.

ELEMENTËT DEKORATIVË TË LËVIZSHËM

Kopsat metalike. Në të majtë dhe në të djathtë të fashës rrethore, në pjesën poshtme të saj, duhet të montohen dy kopsa metalike me diametër 15 mm. Kopsat duhet të kenë formë kuqe me bordurë anësore. Montimi i kopsave duhet të bëhet me karficë metalike për kopsat. Kopsat duhet të kenë *Përkrenaren e Skënderbeut* të gdhendur në sipërfaqe. Kopsat shërbejnë për fiksimin e rripit të zi dekorativ.

Stema duhet të jetë prej tunxhi me ngjyrë të artë me përmasa 6 x 5 cm. Sipërfaqja e saj duhet të jetë me relief sipas pamjes zyrtare.

Ajo duhet të montohet në ballë të kapelës dhe të fiksohet tek kapela me dy këmbëza me filetim. Këmbëzat duhet të jenë të mjaftueshëm të gjata që të montohen me lehtësi. Montimi i stemës nuk duhet të krijojë tendosje të tekstilit dhe astarit.



Rrip i zi dekorativ duhet të jetë i përbërë nga dy rripa me gjatësi të njëjtë. Secili rrip duhet të jetë i përbërë nga dy shtresa plastike me ngjyrë të zezë me shkëlqim.

Rrip i duhet të jetë në total 25 cm i gjatë dhe 14 mm i lartë. Çdo komponent i rripit duhet të jetë rreth 1 mm i trashë.

Rrip i duhet fiksohet tek kapela me anë të kopsave metalike anësore. Ai duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të mbështetet tek streha e kapelës.

Rrip i duhet të pajiset me mekanizëm për shtrëngim dhe lirim që të përshtatet me masën e kapelës.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së kostumit duhet të jenë me hap 6 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e kostumit duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili i kostumit duhet të ruajë hekurosjen për një kohë të gjatë.
- Kostumi duhet të jetë i lehtë për tu mirëmbajtur.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e kostumeve është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Qepja e kopsave në kostum duhet të bëhet rreptësisht sipas përshkrimit tek *Specifikimet Teknike*.
- Kopsat duhet të kenë pamje të rregullta. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash, kopsat nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishen ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Kopsa nuk duhet të lenë shenja tek materialet me të cilat do të bien në kontakt.
- Kopsat duhet të jenë 100% prej materialit të përcaktuar në këtë dokument.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.

- Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Të gjithë artikujt e *kostumit të uniformës për femra* duhet të pajisen me etiketa prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa e xhakës duhet të qepet tek tegeli i majtë, anësor i astarit.

Etiketa e pantallonave dhe e fundit duhet të qepet në qendër të qemerit, mbrapa (në brendësi). Tek etiketa e pantallonave dhe e fundit duhet të qepet edhe 1 kopsë plastike rezervë.

Kopsat rezervë metalike duhet të vendosen në një qese plastike polietileni ose prej kartoni të hollë, të mbyllur mirë. Kopsat rezervë duhet të jenë të pranishme tek secili kostum. Ato duhet të vendosen gjatë paketimit në vrimën e dytë të xhakës me një fije plastike të siguruar mirë.

Kujdes! Duhet të jenë 3 kopsa rezervë metalike, 1 e madhe dhe 2 të vogla (një me pamje në të majtë një me pamje në të djathtë).

Në momentin e dorëzimit kostumet duhet të jenë të pastër, të hekurosur, pa njolla dhe të varur në kremstarë (varëse) të fortë plastike.

Për kostumin nevojiten 1 kremstar për xhakën dhe pantallonat dhe 1 kremstar me kapse për fundin. Kremstari për xhakën duhet të jetë i përshtatshëm për të ruajtur formën e supeve dhe të jetë të pajisur me bosht transversal për varjen e pantallonave. Boshti i kremstarit duhet të jetë i veshur me “push” që pantallonat të mos rrëshqasin apo të pësojnë rrudha.

Xhaketa, fundi dhe pantallonat duhet të futen bashkë në një çantë mbrojtëse prej pambuku, me mbyllje me zinxhir në pjesën qendrore dhe me etiketë transparente për vendosjen e emrit të punonjës.

Kapela duhet të paktohet në një qese më vete.

Artikujt duhet të paktohen me nga 10 kostume për kuti.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e kostumit, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).



ANEKS - Lista e testeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testeve

Xhaketa, pantallonat dhe fundi

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Hollesia e fijeve	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Dendësia	EN 1049-2 1993/ ISO 7211-2: 1984 Tekstile - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 2: Përcaktimi i numrit të fijeve për njësi të gjatësisë.
Qëndrueshmëria në tërheqje	EN ISO 13934-1:2013 Tekstile - Vetitë e pëlhurave në tërheqje - Pjesa 1: Përcaktimi i forcës maksimale dhe zgjatimit në forcën maksimale duke përdorur metodën shirit.
Tkurrja në pastrim në të thatë	EN ISO 3759-2011
Pershkueshmëria e ajrit	EN ISO 9237:1995 Tekstilet - Përcaktimi i depërtueshmërisë së pëlhurave nga ajri
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
	EN ISO 105 - X11
	EN ISO 105 - D01
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë

	me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
Ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

Kapele

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Hollesia e fijeve	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Dendësia	EN 1049-2 1993/ ISO 7211-2: 1984 Tekstile - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 2: Përcaktimi i numrit të fijeve për njësi të gjatësisë.
Qendrueshmëria në tërheqje	EN ISO 13934-1:2013 Tekstile - Vetitë e pëlhurave në tërheqje - Pjesa 1: Përcaktimi i forcës maksimale dhe zgjatimit në forcën maksimale duke përdorur metodën shirit.
Tkurrja në pastrim në të thatë	EN ISO 3759-2011
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. . (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01:

	Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
	EN ISO 105 - D01
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
Ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

Per astaret e brendshëm te kostumit

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Hollesia e fijeve	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Dendësia	EN 1049-2 1993/ ISO 7211-2: 1984 Tekstile - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 2: Përcaktimi i numrit të fijeve për njësi të gjatësisë.
Kendi i kthimit pas ngjeshjes	EN 22313:1993
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105-E04 :2013

	Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016
	Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
	EN ISO 105 - X11
	EN ISO 105 - E06
	EN ISO 105 - D01
	EN ISO 105 - X05
	EN ISO 105 - E07
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
Ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

Per astarin e kapeles

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/ m2	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Hollesia e fijeve	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Dendësia	EN 1049-2 1993/ ISO 7211-2: 1984 Tekstile - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 2: Përcaktimi i numrit të fijeve për njësi të gjatësisë.
Kendi i kthimit pas ngjeshjes	EN 22313:1993
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04:

	Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
	EN ISO 105 - X11
	EN ISO 105 - E06
	EN ISO 105 - D01
	EN ISO 105 - X05
	EN ISO 105 - E07
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
Ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Kostumi i uniformës për meshkuj

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *kostumi i uniformës për meshkuj* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Per tekstin e xhaketes dhe pantallonave

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja %	100% Lesh "pura lana vergine" Hollesia e leshit 19 m.c ± 5% Gjatesia e fibres min. 65 mm	
Thurja	diagonale 2/1 (sarzh)	
Masa gr/m ² % (± 3%)	210 gr/m ²	
Hollesia e fijos (± 5%)	Baza - 2/60 Nm 7.6	Indi - 2/60 Nm
Dendësia ±1	Baza 36 fije/cm	Indi 24 fije/cm
Qëndrueshmëria ne terheqje	Baza ≥ 380N	Indi ≥280N
Tkurrja ne pastrim ne te thate	Baza < 1%	Indi < 1%
Pershkueshmëria e ajrit	> 45 lm ² /s	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi) (2000)	nota 4–5	
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4.0 - 9.0	

Per tekstin e kapeles

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja %	100% Lesh "pura lana vergine" Hollesia e leshit 21.25 m.c ± 5% Gjatesia e fibres min. 58.75 mm	
Thurja	diagonale 2/1 (sarzh)	
Masa gr/m ² % (± 3%)	200 gr/m ²	
Hollesia e fijos (± 5%)	Baza - 2/65 Nm	Indi - 2/64.76 Nm
Dendësia ±1	Baza 37 fije/cm	Indi 22, 5 fije/cm
Qëndrueshmëria ne terheqje	Baza ≥ 440 N	Indi ≥250N
Tkurrja ne pastrim ne te thate	Baza < 1%	Indi < 1%
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.

Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle
Efekti pilling (kokërrzimi)	5-6
Azo Ngjyrujes	Nuk duhet të jenë të pranishëm
pH	4.0 - 7.5

Per astaret e brendshëm te kostumit (xhakete dhe pantallona)

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja %	100% Viskoze	
Thurja	diagonale (sarzh)	
Masa gr/m ² (± 3%)	84 gr/m ²	
Hollesia e fijos (± 3%)	Baza 78Dtex	Indi 120 Dtex
Dendësia ±1	Baza 53 fije/cm	Indi 30 fije/cm
Kendi i rekuperimit pas ngjeshjes	Baza >100°	Indi > 92°
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota 5 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Azo Ngjyrujes	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4.0 - 9.0	

Per astarin e brendshëm te kapeles

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja %	100% Viskoze	
Thurja	diagonale (sarzh)	
Masa gr/m ² % (± 3%)	80 gr/m ²	
Hollesia e fijos (± 3%)	Baza 87.2Dtex	Indi 112.7 Dtex
Dendësia ±1	Baza 52.5 fije/cm	Indi 30.5 fije/cm
Kendi i rekuperimit pas ngjeshjes	Baza >103°	Indi > 92°
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota 5 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Azo Ngjyrujes	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4.0 - 9.0	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të

jetë: e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: jo më pak se – nota 6: shumë e mirë.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në ofertën teknike do të kryhet ky testim: kampioni i tekstit me ngjyrë blu të errët do të fërkohej për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu e errët nuk njollos tekstin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë Velcro që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

XHAKETA

b. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit xhaketa e kostumit të uniformës për meshkuj:

Astar		
Tekstil i dërstiluar për nën jakën	Përbërja	50% lesh + 50% poliestër
	Ngjyra	blu e errët
	Pesha	185 gr/m ² ± 5%
Përforcues		
Krinolinë	Thurja	Garniturë
	Pesha	295 gr/m ² ± 5%
Shtresë prej frazeline termoadezive me ngjyrë të errët.		
Shtresë prej frazeline termoadezive me ngjyrë antracite për paramonturën/jakën.		
Shtresë prej frazeline termoadezive me ngjyrë të zezë për jakën.		
Shtresë prej frazeline termoadezive me ngjyrë të zezë për spaletat, kapakët e xhepave dhe xhepat.		
Shirit prej frazeline termoadezive për ngjitjen e palës në fund të xhaketës me lartësi rreth 4 cm.		
Fileto zbukuruese		
Fileto cilindrike zbukuruese për mëngët dhe jakën.	Trashësia	± 3 mm
	Përbërja	100% viscose
	Ngjyra	e kuqe
Aksesorë të tjerë		
	Përmasat Velcro të gjoksit	86 mm x 30 mm
	Përmasat Velcro të mëngëve	70 mm x 80 mm
	Përbërja	100% fibra poliamide

Element <i>Velcro</i> femër për vendosjen e numrit të identifikimit/shenjës së mbiemrit dhe elementë <i>Velcro</i> me formën e stemës dhe shenjave që do të vendosen tek mëngët e xhakëtës.	Trashësia		2.2 mm
	Masa lineare		41 g/m ± 5%
	Ngjyra		njësoj si xhaketa
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë		- 30° C
	E nxehtë	pika e dobësimit	180° C
		pika e shkrirjes	210—250° C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
	Në larje		jo më pak se 3
	Në ujë të nxehtë		
Në djersë			
Në fërkim			
Vatina prej materiali 100% poliamid			
Filli			
Fill qepës për të gjitha qepjet (përfshi vrimat dhe travetat).	Përbërja		100% poliestër
	Numri metrik		80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje		jo më pak se 12N
	Ngjyra		njësoj si xhaketa
Fill për tegelat zbukurues të brendshëm të xhakëtës.	Numri metrik		30 Nm
	Ngjyra		e kuqe
Kopsa metalike			
 shembull 	4 copë me d 25 mm* + 1 rezervë		
	12 copë me d 15 mm** + 2 rezervë, një me pamje në të majtë dhe një me pamje në të djathtë.		
	Trashësia	në qendër	* 3 mm
			** 2 mm
		në buzë	* 2 mm
			** 1 mm
	Gjerësia e konturit rrethues		* 2 mm
			** 1 mm
	Tipi	me këmbëz me karficë	
		Gjatësi	* 7 mm
			** 5 mm
		Gjerësi	4 mm
		trashësi	2 mm
		diametri i vrimës	2 mm
	Ngjyra e kopsës	e artë, me shkëlqim mat	
	Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm	
	Skalitje	Përkrenarja e Skënderbeut	

		Përmasa	* 12x16 mm ** 8x10 mm
Aksesorë metalikë			
2 ornamente me formën e stilizuar të <i>Përkrenares së Skënderbeut</i> që do të vendosen tek jaka.		Tipi	Me 2 këmbëza me filetimit
		Përmasat	25 x 31 mm
		Trashësia	2.5 mm
		Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm
		Ngjyra	e artë, me shkëlqim mat
		Reliev	sipas ilustrimit zyrtar
Etiketa			
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese, masën e xhakëtës, përbërjen dhe instruksionet e mirëmbajtjes.		Përbërja	100% poliestër
		Ngjyra	e bardhë

PANTALLONAT

c. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit pantallonat e kostumit të uniformës për meshkuj:

Astar		
Tekstil <i>Silesia</i> prej pambuku për qemerin, profilimin e sallkisë dhe astarin e xhepave.	Përbërja	100% pambuk
	Thurja	diagonale me vija
	Ngjyra	e zezë
Përforcues		
Përforcues me ngjyrë të errët		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me vrima me gjerësi rreth 6 cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me lartësi rreth 3.5 cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive e hollë për ylykët dhe filetot e xhepave.		
Fileto zbukuruese		
Fileto cilindrike zbukuruese për pantallonat (për policet)	Trashësia	± 3 mm
	Përbërja	100% <i>viscose</i>
	Ngjyra	e kuqe
Aksesorë të tjerë		
Zinxhir	Gjatësia	16 –18 cm
	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	njësoj si pantallonat
Kapëse metalike femër-mashkull për qemerin e pantallonave.		
Filli		

Fill qepës për të gjitha qepjet (përfshi vrimat dhe travetat).	Përbërja	100% poliester
	Numri metrik	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	njësoj si pantallonat
Etiketa		
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese dhe instruksionet e mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliester
	Ngjyra	e bardhë
Kopsa plastike		
	1 copë Nr. 34 (d 21mm) 2 copë (d 15 mm) + 1 rezervë	
	Ngjyra	blu e errët
	Përbërja	100% poliester
	Qepja	Kryq

KAPELA

d. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *kapela e uniformës për meshkuj*:

Astar		
Astar në formë rrjete	Përbërja	100% poliester
	Ngjyra	i zi
Përforcues		
Shtresë përforcuese termoadezive prej tekstili të endur.	Përbërja	53% <i>viscose</i> , 47% pambuk.
	Thurja	Garniturë
	Peshë mesatare:	115 gr/m ² ± 5%.
	Temperatura e aplikimit	150° C
	Ngjyra	e zezë
Shtresë sfungjeri me trashësi 7 mm për pjesën ballore të kurorës.		
Shtresë plastike polietileni me lartësi 50 mm dhe trashësi 1mm për fashën rrethore.		
Shtresë e hollë plastike drejtkëndore me përmasa 1.6 x 12 cm dhe trashësi 1,5 mm për vendosjen e stemës së <i>Policiës së Shtetit</i> .		
Fileto zbukuruese		
2 fileto cilindrike zbukuruese për kurorën e kapelës.	Trashësia	± 3 mm
	Përbërja	100% <i>viscose</i>
	Ngjyra	e kuqe
Shirit dekorative.	Gjerësia	30 mm
	Përbërja	100% poliester
	Ngjyra	Blu shumë e errët
Aksesorë të tjerë		
Shirit prej lëkure gjedhi me ngjyrë të zezë dhe me vrima për ajrosje, për shiritin dekorativ.		
Unazë rrethore metalike me trashësi rreth 1mm për fashën rrethore.		

Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese dhe instruksionet e mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliester	
	Ngjyra	e bardhë	
Filli			
Fill për të gjitha qepjet.	Përbërja	100% poliester	
	Numri metrik	80 Nm	
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N	
	Ngjyra	njësoj si tekstili	
Fill për qepjen e strehës.	Përbërja	100% poliester	
	Numri metrik	70 Nm	
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N	
	Ngjyra	e zezë	
Streha			
Pjesa e sipërme (me shkëlqim).	Trashësia	±0.5 mm	
	Përbërja	polivinil kloruri	
	Ngjyra	e zezë	
Pjesa e poshtme (me relief që imiton lëkurën).	Trashësia	±1.5 mm	
	Përbërja	polivinil kloruri	
	Ngjyra	e gjelbër	
Shirit për profilimin të buzës së strehës.	Trashësia	±0.2 mm	
	Përbërja	polivinil kloruri	
	Ngjyra	e zezë	
Kapelet për gradat Drejtues i Lartë dhe Drejtues Madhor, duhet të jenë me elementë dekorues me ngjyrë të artë, në pjesën mbi strehë. Shembull.			
			
Aksesorë të lëvizshëm			
Kopsa metalike  shembull 	2 copë me d 15 mm një me pamje nga e majta dhe një me pamje nga a djathta.		
	Trashësia	në qendër	2 mm
		në buzë	1 mm
	Gjerësia e konturit rrethues		1 mm
	Tipi	me këmbëz rrumbullake	
		Gjatësia	5 mm
		Gjerësia	4 mm
		Trashësia	2 mm
	diametri i vrimës		2 mm
	Ngjyra	e artë, me shkëlqim mat	
	Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm	
	Skalitje	Përkrenarja e Skënderbeut	

		Përmasa	8 x 10 mm
Karficë metalike për montimin e kopsave në kapele.			
Rrip dekorativ me unaza dhe perçina për shtrëngim. 	Rripi dekorativ		
	Përbërja	100 % polivinil kloruri (PVC)	
	Ngjyra	e zezë, me shkëlqim	
	Lartësia	14 mm	
	Trashësia	1 mm	
	Gjatësia	25 cm	
	Unaza 2 (copë)		
	Gjerësia	15 mm	
	Lartësia	17 mm	
	Trashësi	1 mm	
	Përbërja	plastike	
	Perçina (2 copë)		
	Diametër	7 mm	
	Përbërja	metalike	
	Ngjyra	e zezë	
			
Stema metalike		Tipi	me 2 këmbëza me filetimit
		Përmasat	6 x 5 cm
		Trashësia	± 2mm
		Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm
		Ngjyra	e artë, me shkëlqim mat
		Skalitje	detajet e emblemës

Kopsat metalike, stema, rripi dekorativ i zi i kapelës dhe ornamentet e jakës do t'u nënshtrohen testeve të mëposhtme:

- **Rezistencës ndaj ujit.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur në ujë të distiluar për 24 orë në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria ndaj solucioneve larëse.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për 24 orë në ujë me solucion sapun larës 3% në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria ndaj solucioneve tretëse.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë fërkuar lehtë me furçë, me alkool metilik e më pas me benzinë.
- **Qëndrueshmëria ndaj klorurit të sodiumit.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për një orë në 1% klorur sodiumi në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje.** Nuk duhet të ketë ndryshime të ngjyrës pasi të jetë trajtuar me 5% solucion HCl.
- **Rezistenca ndaj korrozionit.**

Produkti final do t'i nënshtrohet kontrollit fizik të thjeshtë në mënyrë që të vërtetohet plotësimi i kushteve teknike për secilin element si p.sh: që materialet e përdorura janë të përshtatshme për produktin, pamja dhe konstruksioni i përgjithshëm, stilizimi, vlerat estetike, etj. Kontrolli do të bëhet me sy të lirë dhe me mjete të caktuara.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë kopsa, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- kokërrzim (punime të ashpra),
- tonalitete të ngjyrës,
- ndryshim në dendësi të materialit,
- deformime të imazhit të skalitur,
- shkëputje të pjesëve,
- gropëzime ose plasaritje,
- relieve jo të rregullta,
- metalizim jo i rregullt dhe jo rezistent,
- oksidime,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon pamjen funksionale dhe estetike të produktit.

e. Materialet që nevojiten për paketimin e artikullit *kostumi i uniformës për meshkuj*

Fotografitë e mëposhtme shërbejnë vetëm si shembull ilustrues.

		 Qese polietileni per kopsen rezerve metalike
kremastar për xhaketën dhe pantallonat	çantë pambuku për paketimin e kostumit	qese polietileni për kopsat rezervë
kartoni për paketimin e kostumeve		
qese plastike polietileni për paketimin e kapelës		

Të gjithë mjetet dhe aksesoret mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *kostumi i uniformës për meshkuj* do të porositet dhe do të prodhohet në masat 44 – 66 dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



1	Perimetri i kokës	cm.
2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.
5	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
6	Perimetri i muskullit të krahut	cm.
7	Perimetri i kyçit të dorës	cm.
8	Perimetri i gjurit poshtë kupës së tij	cm.
9	Perimetri i kyçit të këmbës (kavaljes)	cm.
10	Gjatësia e plotë	cm.
11	Lartësi e përgjithshme e trupit mbrapa (nga supi në tokë)	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale deri tek vija e belit)	cm.
13	Gjatësia e mes shpatullave	cm.
14	Gjatësia nga supi tek bërryli	cm.
15	Gjatësia e krahut, nga supi tek kyçi i dorës	cm.
16	Lartësia e pjesës nga vija e supit tek vija e belit	cm.
17	Gjatësia nga beli tek vija e gjurit (poshtë kupës së gjurit)	cm.
18	Gjatësia nga beli tek kyçi i këmbës	cm.
19	Gjatësia e brendshme e këmbës deri tek vija e gjurit	cm.
20	Gjatësia e brendshme e këmbës deri tek kyçi i këmbës	cm.
21	Gjatësia e shtratit e matur në pozicion ulur	cm.

3. NGJYRAT REFERENCË



Ngjyra blu spektri sipas CIECLCH 18, 14.587, 295.349 për të gjitha pjesët e kostumit të uniformës, astarit dhe kapelës.

Ngjyra e kuqe spektri sipas CIECLCH 41, 70.780, 28.754 për filetot dhe fijet dekorative.

Ngjyra e artë spektri sipas CIECLCH 72, 63.619, 74.057 për kopsat metalike dhe për shenjat dekorative metalike.

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

***Kujdes!** Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.*

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *kostumi i uniformës për meshkuj*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Kollaritja

Ngjitja e materialit tekstil kollaritës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 130–140° C, me kohëzgjatje 8–10 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet kollaritja me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I KOSTUMIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të kostumit të uniformës për meshkuj.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.


I. XHAKETA



Xhaketa e uniformës për meshkuj është e njëjtë në tekstil dhe ngjyrë me atë të femrave, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për meshkuj dhe kopsave, të cilat duhet të jenë në anën e djathtë.

Pjesët përbërëse të xhaketës:

- Pjesa e përparme (me dy pjesë)
- Dy xhepa me kapakë të gjoksit
- Dy xhepa të mëdhenj të poshtëm me kapakë
- Dy pjesë anësore (fianket)
- Dy paramontura
- Jaka e poshtme dhe e sipërme
- Pjesa e pasme (me dy pjesë)
- Dy spaleta
- Dy mëngë
- Astari i brendshëm




Elementë dekorativ metalik



Kopsa e madhe d.25 mm



Kopsa e vogël d.15 mm



PJESA E PËRPARME E XHAKETËS

Pjesët e përparme. (1) Buzët e pjesës së përparme duhet të përshkohen vertikalisht nga një tegel zbukurues sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 1 mm nga buza. Tegeli duhet të fillojë në cepin e poshtëm dhe duhet të përfundojë në afërsi të jakës.

Struktura e xhakëtës duhet të përforcohet me dy shtresa: një prej frazeline termoadezive dhe tjetra prej krinoline. Shtresat duhet të vendosen vetëm në pjesët e përparme. Shtresa prej frazeline termoadezive duhet të vendoset në të gjithë sipërfaqen e xhakëtës ndërsa krinolina vetëm tek supet dhe tek gjoksi. Shtresat përforcuese duhet të jenë fshehura mes astarit dhe tekstit të xhakëtës.

Jaka e poshtme duhet të jetë standarde me kulme. Duhet pasur kujdes që gjatë palosjes së jakës mos të shfaqen defekte.

Pencat (2) duhet të fillojnë në mes të pjesës fundore të xhepave të gjoksit dhe përfundojnë në anë të pjesës së sipërme të xhepave të mëdhenj.

Kopsat. Xhaketa duhet të jetë e pajisur me katër kopsa metalike me diametër 2.5 cm.

Kopsat duhet të qepen në anën e djathtë të xhakëtës në një distancë 8.5 cm nga njëra-tjetra. Qepja e kopsave të mëdha duhet të bëhet sipas ilustrimit të mësipërm të xhakëtës.

Vrimat e kopsave duhet të hapen në pjesën e majtë (të veshur) të xhakëtës me drejtim horizontal.

Gjatësia e vrimave të kopsave duhet të jetë 30 mm, distanca e vrimave nga buza e xhakëtës duhet të jetë 15 mm ndërsa distanca e vrimave nga njëra-tjetra duhet të jetë 85 mm.

Vrima e parë duhet të hapet atje ku fillon thyerja e jakës.

Fundi i xhakëtës (3) duhet të përfundojë me një palosje të brendshme 3 cm. Palosja duhet të përforcohet me frazeline termoadezive me lartësi 4cm. Në fillim duhet të vendoset frazelina pastaj duhet të bëhet palosja. Fundi i xhakëtës duhet të mbulojë vithet. *Shiko kapitullin e marrjes së masave*

Vatat duhet të përbëhen nga një shtresë vatin e përforcuar në të dy anët me tekstil adeziv methurje garniturë (1:1).

Vatat duhet të kenë formë ovale nga njëra anë dhe të drejtë nga ana tjetër.

Vata duhet të qepet në brendësi të xhakëtës, tek linja e supeve, midis tekstit të xhakëtës dhe astarit. Brinja e drejtë duhet të qepet tek tegeli i gavaturës ndërsa brinja rrethore duhet të jetë e lirë.

Vatina duhet të jenë prej materiali 100% poliamid.

JAKA E SIPËRME

Jaka e sipërme (6) duhet të përbëhet nga një shtresë tekstili me ngjyrë blu të errët të përforcuar me frazelinë termoadezive dhe një shtresë prej shajaku me ngjyrë të zezë.

Tekstili dhe shtresa prej shajaku duhet të bashkohen me njëra-tjetrën nëpërmjet një tegeli linear një gjilpërësh me distancë 1 mm nga buza e jakës.

Ndërmjet dy shtresave duhet të qepet një shirit cilindrik (fileto) dekorativ i kuq me trashësi 3 mm. Shiriti duhet të qepet në të tre anët e jakës.

Jaka e sipërme, gjuhëza dhe trupi i xhakëtës duhet të bashkohem me anë të tegelave linearë një gjilpërësh me distancë rreth 1 mm nga buzët.

Tek kulmet e jakës së sipërme duhet të montohen ornamentet metalike dekorative ngjyrë ari me formën e stilizuar të *Përkrenares së Skënderbeut*. Ornamentet duhet të montohen me anë të mbërtheckave metalike me fileto. Përkrenaret duhet të shohin nga njëra-tjetra.



PARAMONTURAT(7)

Të dy pjesët e përparme të xhakëtës duhet të pajisen me paramontura me drejtim vertikal. Ato duhet të jenë dy pjesë tekstili të prera me formën e buzës së xhakëtës dhe duhet të qepen nga brenda.

Paramonturat duhet të jenë të përforcuara me frazelinë termoadezive për paramonturë. Shtresa përforcuese prej frazeline termoadezive duhet të bashkohet me shtresën e paramonturës në tranxhë me avull të nxehtë.

Të gjitha shtresat (pjesët e përparme, paramonturat, astari) duhet të qepen me tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor me ngjyrë të kuqe me hapje 4 mm.

PJESËT ANËSORE (FIANKET) (9)

Fianket nuk kanë nevojë për përforcim me shtresa përforcuese.

PJESA E PASME E XHAKETËS (10)

Pjesa e pasme e xhakëtës duhet të përbëhet nga dy pjesë.

Çarja e pasme e xhakëtës duhet të ketë lartësi rreth 21 cm dhe thellësi 4 cm. Ana e majtë duhet të jetë mbi anën e djathtë.

Çarja duhet të jetë e përforcuar me shtresë frazeline dhe në pjesën e sipërme çarja duhet të jetë e kufizuar me anë të tegelit qepës në drejtim transversal.

Fundi i xhakëtës duhet të përfundojë me një palosje të brendshme 3 cm të përforcuar me frazelinë termoadezive me lartësi 4 cm. Në fillim vendoset frazelina pastaj bëhet palosja.

ASTARI

Trupi i xhakëtës dhe mëngët duhet të jenë të veshur nga brenda me astar. Astar duhet të jetë i ndarë në gjashtë pjesë kryesore (katër pjesë përpara dhe dy pjesë mbrapa), të bashkuara ndërmjet tyre me anë të tegelit linear një gjilpërësh. Astar duhet të qepet tek palosja e brendshme e fundit të xhakëtës dhe duhet të qëndrojë pak i varur, si thes. Që astari të qëndrojë si thes, ai duhet të jetë 1.5 cm më i gjatë se pjesa e pasme e xhakëtës.

XHEPAT E BRENDSHËM

Xhaketa duhet të pajiset me dy xhepa të brendshëm me fileto të dyfishtë, me hapje 13 cm, thellësi 17 cm dhe distancë 8.5 cm nga buza e përparme e xhakëtës. Një xhep në të majtë dhe një në të djathtë.

Astar i xhepit duhet të përshkohet nga një tegel linear një gjilpërësh me distancë rreth 5 mm nga buza.

Hapja e xhepit duhet të jetë në të njëjtin drejtim me vrimën e dytë të xhakëtës.


XHEPAT E GJOKSIT (4)

Xhaketa duhet të ketë xhepa të vegjël me kapak me kopsë, palë të dyanshme dekorative dhe tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Përmasat e xhepave duhet të jenë 12 x 12.5 cm ndërsa përmasat e kapakëve të xhepave duhet të jenë 12 x 5.5 cm. Pala dekorative duhet të jetë 3 cm e gjerë.

Xhepat dhe kapakët duhet të kenë formë drejtkëndore dhe kulme në formë trapezi.

Xhepat dhe kapakët duhet të përshkohen nga një tegel linear një gjilpërësh me distancë 1 mm nga buzët.



Xhepat dhe kapakët e xhepave duhet të përbëhen nga një shtresë tekstili e përforcuar me frazelinë termoadezive dhe astari. Shtresa përforcuese prej frazeline termoadezive duhet të bashkohet me tekstilin në tranxhë me avull të nxehtë.

Xhepat duhet të qepen në lartësinë e gjoksit dhe në linjë me kopsën e parë të xhakëtës. Kapakët e xhepave duhet të qepen me kthim pale 5 mm dhe në një lartësi prej 15 mm mbi xhepa.

Vrima e kopsës duhet të jetë 20 mm e gjatë me drejtim vertikal. Ajo duhet të vendoset në aksin qendror të kapakut me distancë 15 mm nga buza e poshtme e kapakut. Kopsa gjithashtu duhet të vendoset në aksin qendror të xhepit me distancë rreth 15 mm nga buza e sipërme. Kopsa duhet të jetë me diametër 15 mm, metalike, ngjyrë ari dhe me *Përkrenaren e Skënderbeut* të skalitur në sipërfaqe.

Kujdes! Kopsat me *Përkrenaren e Skënderbeut* duhet të shohin njëra-tjetrën. (Shiko ilustrimin teknik të xhakëtës.)

Mbi xhepin e djathtë (të veshur) duhet të qepet një element *Velcro* femër ngjyrë blu (si materiali bazë i xhakëtës) me përmasa 8,6 x 3 cm, e cila do të shërbejë për fiksimin e gradës së gjoksit ose numrit të identifikimit.

Kujdes! Vendosja e xhepave mund të ndryshojë tek masat e vogla dhe të mëdha të kostumit.


XHEPAT E MËDHENJ TË POSHTËM (5)

Xhaketa duhet të ketë xhepa të mëdhenj me kapak me kopsë, palë të dyanshme dekorative dhe tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Përmasat e xhepave duhet të jenë 18 x 17 cm ndërsa përmasat e kapakëve të xhepave duhet të jenë 18 x 6 cm. Pala dekorative duhet të jetë 3.5 cm e gjerë. Xhepat dhe kapakët duhet të kenë formë drejtkëndore dhe kulme në formë trapezi.

Xhepat dhe kapakët duhet të përshkohen nga një tegel linear një gjilpërësh me distancë 1 mm nga buzët.

Xhepat dhe kapakët e xhepave duhet të përbëhen nga një shtresë tekstili e përforcuar me frazelinë termoadezive dhe astari. Shtresa përforcuese prej frazeline termoadezive duhet të bashkohet me tekstilin në tranxhë me avull të nxehtë.



Xhepat duhet të qepen në një linjë horizontale me kopsën e katërt. Kapakët e xhepave duhet të qepen me kthim pale 5 mm dhe në një lartësi prej 15 mm mbi xhepa.


Në brendësi të xhepit, rreth 1 cm poshtë buzës së sipërme, duhet qepur një copë tekstili me të njëjtin material si astari dhe me përmasa 1.5 x 13 cm. Ky përforcues i qepur në të katërta anët shërben për të mbuluar e forcuar qepjen e pencave dhe të fiankeve.

Vrima e kopsës duhet të jetë 20 mm e gjatë me drejtim vertikal. Ajo duhet të vendoset në aksin qendror të kapakut me distancë 15 mm nga buza e poshtme e kapakut. Kopsa gjithashtu duhet të vendoset në aksin qendror të xhepit me distancë rreth 15 mm nga buza e sipërme. Kopsa duhet të jetë me diametër 15 mm, metalike, ngjyrë ari dhe me *Përkrenaren e Skënderbeut* të skalitur në sipërfaqe.

Kujdes! Kopsat me *Përkrenaren e Skënderbeut* duhet të shohin njëra-tjetrën. (Shiko ilustrimin teknik të xhakëtës.)

Kujdes! Vendosja e xhepave mund të ndryshojë tek masat e vogla dhe të mëdha të kostumit.

SPALETAT(8)



Spaletat duhet të jenë drejtkëndore në njërën anë dhe me kulm (me formë shigjete) në anën tjetër. Ana drejtkëndore duhet të qepet tek tegeli i rrethit të mëngës (gavatura). Katër brinjët e tjera përshkohen nga një tegel perimetral sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 5 mm nga buza.

Spaleta duhet të ndërtohet me dy shtresa tekstili ngjyrë blu (njësoj si xhaketa) me përmasa të njëjta. Shtresa e sipërme e spaletës duhet të përforcohet me frazelinë termoadezive.

Vrima e kopsës duhet të jetë në anën e “shigjetës”, distancë rreth 1,5 cm nga kulmi. Gjatësia e vrimës së kopsës duhet të jetë 20 mm.


Kopsa duhet të qepet në të njëjtin pozicion tek supi i xhaketës. Kopsa duhet të jetë me diametër 15 mm, metalike, ngjyrë ari me *Përkrenaren e Skënderbeut* të skalitur në sipërfaqe.

Kujdes! Kopsat e vogla të spaletave me *Përkrenaren e Skënderbeut* duhet të shohin njëra-tjetrën (shiko ilustrimin teknik të xhaketës).

Gjatësia e spaletës duhet të ndryshojë në varësi të masës së xhaketës. Gjatësia e spaletës duhet të rritet me 2–3 mm për çdo masë. Dimensionet bazë duhet të jenë këto: 13,5 x 4,8 cm për masën më të vogël të xhaketës dhe 15 x 4,8 cm për masën më të madhe të xhaketës.

Aksi qendror gjatësor i spaletave duhet të përputhet me tegelin qepës të supeve.

MËNGËT (11)



Mëngët duhet të përbëhen nga dy pjesë: mënga e sipërme dhe mënga e poshtme. Dy pjesët duhet të qepen me njëra-tjetrën me tegel linear një gjilpërësh.

Mëngët duhet të përfundojnë me një çarje false gjatësore me lartësi 8 cm për kopsat. Buzët e çarjes duhet të jenë të mbivendosura me rreth 4 cm.

Kopsat dhe vrimat duhet të jenë gjithashtu false, vetëm për funksion estetik. Kopsat duhet të jenë metalike ngjyrë ari me diametër 15 mm dhe me *Përkrenaren e Skënderbeut* të skalitur në sipërfaqe ndërsa vrimat e kopsave duhet të jenë 20 mm të gjata.

Në fillim të çarjes, 8 cm nga fundi i mëngës duhet vendosur një shirit (fileto) cilindrik perimetral dekorativ me diametër 3 mm.

Mënga duhet të mbyllet në fund me një palosje të brendshme me lartësi 3 cm që qepet me astarin.

VELCRO (12)


Xhaketa e kostumit të uniformës duhet të pajiset me tre elementë *Velcro* femër:

- 1 copë për vendosjen e gradës së gjoksit/ numrit të identifikimit me përmasa 86 x 30 mm.
- 1 copë për vendosjen e stemës së policisë në mëngën e majtë me përmasa 70 x 80 mm.
- 1 copë për vendosjen e shenjave në mëngën e djathtë me përmasa 70 x 80 mm.


Elementët *Velcro* duhet të qepen me tegel zig-zag perimetral me ngjyrë blu dhe të përforcohen me dy tegela diagonalë. Qepja e elementëve *Velcro* duhet të bëhet me ndihmën e shtresës përforcuese prej frazeline në mënyrë që të mos ketë dëmtime ose grisje të tekstilit gjatë qepjes dhe përdorimit.

Elementët *Velcro* në mëngë duhet të ketë një distancë rreth 6 cm nga gavatura e mëngës.

Kujdes! Elementët *Velcro* për mëngën e djathtë duhet të priten në përputhje me shërbimet që kryen punonjësi i policisë. Kufiri i lejuar i gabimit për elementët *Velcro* është ± 1 mm.



II. PANTALLONAT



Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje.
Pjesët përbërëse të pantallonave:

- Qemeri
- Dy pjesët e këmbëve
- Dy xhepat e përparmë
- Dy xhepat e pasmë

QEMERI (1)

Lartësia e qemerit duhet të jetë 3.5 cm. Ai duhet të jetë i përbërë nga dy shtresa tekstili me përmasa të njëjta (brenda dhe jashtë) dhe nga dy shtresa të brendshme përforcuese. Renditja e shtresave të qemerit duhet të bëhet si më poshtë:

5. Shtresa e jashtme prej tekstili të njëjtë me pantallonat.
6. Shtresa e dytë e brendshme me lartësi rreth 6 cm prej tekstili termoadeziv.
7. Shtresa e tretë përforcuese me frazelinë termoadezive me vrima.
8. Shtresa e brendshme (e pantallonave) me tekstil *Silesia* me lartësi rreth 7 cm.

Qemeri duhet të bashkohet me pantallonat me tegel të padukshëm. Ai duhet të ketë një shtesë prej 3 cm (nga vijat e zinxhirit) në të dy anët. Shtesat duhet të përfundojnë me kulme në formë shigjete. Në njërin shtesë duhet të hapet vrima e kopsës me gjatësi 25 mm ndërsa në tjetrën duhet të qepet kopsa e pantallonave.

Në anën e brendshme të qemerit, në linjë me zinxhirin duhet të montohet një kapëse e thjeshtë me mekanizëm “femër-mashkull”.



Kopsat duhet të jenë Nr. 34 (21 mm) me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsave duhet të bëhet kryq.

Ylykët.(2) Pantallonat duhet të kenë gjithsej 6 ylyqe me gjatësi 5 cm dhe gjerësi 1 cm. Dy përpara dhe katër mbrapa. Ylykët e përparme duhet të vendosen në linjën e vijës së hekurosjes së pantallonave. Dy ylyqe të pasme duhet të vendosen të baraslarguar nga linja qendrore e pantallonave dhe dy të tjerët të baraslarguar nga pencat.

Ylykët duhet të përbëhen nga dy shtresa tekstili ngjyrë blu (si xhaketa) dhe një shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive.

Ato duhet gjithashtu të përforcohen në të dy skajet me traveta ngjyrë blu të errët.

DY PJESET E KËMBËVE

Sallkia (4) duhet të ndërtohet me dy pjesë: pjesa e mbuluar dhe kapaku (e zinxhirit). Pjesa e mbuluar duhet të jetë e veshur me tekstil *Silesia* nga brenda dhe me tekstinin e pantallonave nga jashtë ndërsa kapaku duhet të qepet nga të dyja anët me tekstinin e pantallonave.

Zinxhiri i sallkisë. Gjatësia e zinxhirit mund të ndryshojë sipas masave, nga 16–18 cm. Zinxhiri duhet të jetë me fiksion tek koka në mënyrë që të mos hapet vetë gjatë veshjes.

Ngjyra e zinxhirit duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e pantallonave.

Shiritat e kuq dekorativë. (3) Tek tegelat anësorë të këmbëve duhet të qepet fileto dekorative cilindrike me gjerësi ± 3 mm.

Pencat. (5) Në pjesën e pasme të pantallonave, poshtë qemerit, duhet të qepen dy penca vertikale me gjatësi 7 cm, një në të majtë dhe një në të djathtë.

Astari. Pantallonat duhet të jenë të veshura me astar vetëm në pjesën e përparme, deri poshtë linjës së gjurit. Astar duhet të jetë prej materiali me përbërje 100% *viscose*.

Tegeli anësor i këmbëve dhe fundet e pantallonave duhet të jenë të profiluara me syzator.

XHEPAT (6)

Xhepat diagonalë. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonalë. Hapja e xhepit duhet të fillojë poshtë qemerit, në një distancë 3 cm nga tegeli anësor i pantallonave dhe të përfundojë po tek tegeli anësor.

Xhepi duhet të jetë 16 cm i gjatë. Ai duhet të përforcohet në të dy ekstremitetet e tij me travetë.

Xhepat duhet të përshkohen gjatë gjithë gjatësisë nga një tegel linear me distancë 7 mm nga buza e jashtme.

Në pjesën e dukshme (mostra) xhepat duhet të jenë të veshur me tekstil të njëjtë me pantallonat. Astari i xhepave duhet të jetë prej tekstili *Silesia*.

Xhepat fileto. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të pasmë me fileto të dyfishtë të pozicionuar menjëherë poshtë pencave. Filetoja e dyfishtë dhe tekstili përreth hapjes e xhepit duhet të përforcohen me frazelinë termoadezive.


Astari i xhepit duhet të jetë prej tekstili *Silesia*.

Hapja e xhepave me fileto do të ndryshojë sipas prerjes, nga 13–14 cm.

Xhepat duhet të jenë edhe me kopsë. Vrimat e kopsave duhet të kenë gjatësi 25 mm dhe distancë rreth 1cm nga filetoja e poshtme.

Kopsat duhet të jenë (d 15 mm) me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsave duhet të bëhet me kryq. Kopsat duhet të qepen në një distancë prej 15 mm nga filetoja e sipërme e xhepave

III. KAPELA



Kapela duhet të prodhohet në të gjitha masat që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit. Masat për meshkuj variojnë nga 53–65. Njësia e matjes duhet të jetë në centimetra. Ngjyra e kapelës duhet të jetë e njëjtë me materialin bazë të kostumit.

Pjesët përbërëse të kapelës:

1. Tavani (pjesa e sipërme)
2. Kurora
3. Fasha rrethore
4. Streha
5. Brendia
6. Shiriti dekorativ prej tekstili
7. Filetoja cilindrike dekorative
8. Kopsat metalike anësore
9. Stema
10. Rrip i zi dekorativ

Tavani i kapelës duhet të ketë formë ovale. Ai duhet të përbëhet nga një shtresë tekstili ngjyrë blu të errët të përforcuar me tekstil termoadeziv të endur me ngjyrë të zezë.

Tavani duhet të jetë i veshur me astar në formë rrjete me përmbajtje 100% poliestër. Tek astari duhet të qepet edhe etiketa me emrin i fabrikës prodhuese.

Perimetri i brendshëm i tavanit të kapelës duhet të përforcohet me ndihmën e një unaze metalike me trashësi 1–2 mm.

Kurora e kapelës duhet të ndërtohet me 4 prerje: dy para dhe dy mbrapa.

Secila pjesë duhet të përbëhet nga një shtresë tekstili ngjyrë blu të errët të përforcuar me tekstil termoadeziv të endur me ngjyrë të zezë dhe shtresa e sfungjerit me trashësi rreth 7 mm që duhet të vendoset vetëm në pjesën ballore të kapelës.

Kurora e kapelës duhet të jetë e veshur me astar të bardhë methurje garniturë dhe përmbajtje 100% pambuk.

Në pjesën ballore të kapelës, në brendësi të saj, duhet të qepet një shtresë e hollë plastike drejtkëndore e veshur me astar, me trashësi rreth 1.5 mm dhe përmasa 12 x 1.6 cm për montimin e emblemës së Policisë së Shtetit. Qepja e shtresës plastike duhet të bëhet tek tegeli qepës i fashës rrethore.

Lartësia e kurorës (kreshtës ballore) duhet të jetë 8 cm për masën 57.

Fasha rrethore e kapelës duhet të jetë e ndërtuar me një pjesë të vetme, e cila duhet të qepet në anën e pasme të kapelës. Ajo duhet të përbëhet nga 2 shtresa me përmasa të barabarta: shtresa e jashtme prej tekstili blu të errët dhe shtresa plastike prej polietileni me lartësi 50 mm dhe trashësi 1 mm. Shtresa plastike duhet të ketë përkulshmëri të lartë në mënyrë që të ruajë formën gjatë përdorimit.

Fasha rrethore duhet të jetë e veshur me astar methurje garniturë dhe përmbajtje 100% pambuk.

Shirit prej lëkure. Tek buza e poshtme e fashës rrethore të kapelës duhet të qepet një shirit perimetral prej lëkure që shërben për mbrojtjen e kapelës nga djersët. Buza e sipërme e shiritit duhet të jetë e lirë.

Shiriti duhet të jetë prej lëkure gjedhi me ngjyrë të zezë dhe me vrima për ajrosje.

Midis fashës rrethore dhe shiritit perimetral prej lëkure duhet të qepet një fije plastike përforcuese perimetrale me trashësi 0.5 mm që ndihmon ruajtjen e formës së kapelës.

Streha e kapelës duhet të bashkohet me fashën e kapelës me anë të tegelit qepës. Ajo duhet përbëhet nga dy shtresa me përmasa të barabarta: pjesa e sipërme prej polivinil kloruri me ngjyrë të

zezë me shkëlqim, me trashësi rreth 0.5 mm dhe pjesa e poshtme prej polivinil kloruri me ngjyrë të gjelbër pa shkëlqim dhe me relief që imiton pamjen e lëkurës, me trashësi 1.5 mm.

Dy shtresat e strehës duhet të ngjiten në mënyrë uniforme.

Streha duhet të jetë e profiluar me një shirit polivinil kloruri me trashësi rreth 0.2 mm me ngjyrë të zezë me shkëlqim.

Shënim: Kapelet për gradat Drejtues i Lartë dhe Drejtues Madhor, duhet të jenë me elementë dekorues në pjesën mbi strehë.

ELEMENTËT DEKORATIVË

Shiriti dekorativ prej tekstili duhet të jetë ngjyrë blu shumë e errët (pothuajse në të zezë) me gjerësi 3 cm. Sipërfaqja e shiritit duhet të jetë e vijëzuar (me kurrize).

Shiriti duhet të qepet në pjesën e pasme të kapelës.

Filetot e kuqe (e njëjtë me filetot e kostumit) cilindrike dekorative duhet të kenë trashësi 3 mm. Ato duhet të jenë prej materiali 100% viskoz.

Filetot duhet të përshkojnë tegelin e sipërm dhe të poshtëm të kurorës së kapelës.

ELEMENTËT DEKORATIVË TË LËVIZSHËM

Kopsat metalike. Në të majtë dhe në të djathtë të fashës rrethore, në pjesën poshtme të saj, duhet të montohen dy kopsa metalike me diametër 15 mm që shërbejnë për fiksimin e rripit të zi dekorativ.



Kopsat duhet të kenë formë konvekse me bordurë anësore dhe në sipërfaqe duhet të kenë të skalitur *Përkrenaren e Skënderbeut*.

Montimi i kopsave duhet të bëhet me karficë metalike për kopsat.

Stema duhet të jetë prej tunxhi me ngjyrë të artë me përmasa 6 x 5 cm. Sipërfaqja e saj duhet të jetë me relief sipas pamjes zyrtare.

Ajo duhet të montohet në ballë të kapelës dhe të fiksohet tek kapela me dy këmbëza me filetim. Këmbëzat duhet të jenë të mjaftueshëm të gjata që të montohen me lehtësi. Montimi i stemës nuk duhet të krijojë tendosje të tekstilit dhe astarit.



Rip i zi dekorativ duhet të jetë i përbërë nga dy rripa me gjatësi të njëjtë. Secili rrip duhet të jetë i përbërë nga dy shtresa plastike me ngjyrë të zezë me shkëlqim.

Ripi duhet të jetë në total 25 cm i gjatë dhe 1.4 cm i lartë. Çdo komponent i rripit duhet të jetë rreth 1 mm i trashë.

Ripi duhet fiksohet tek kapela me anë të kopsave metalike anësore. Ai duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të mbështetet tek streha e kapelës.

Ripi duhet të pajiset me mekanizëm për shtrëngim dhe lirim që të përshtatet me masën e kapelës.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së kostumit duhet të jenë me hap 6 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e kostumit duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili i kostumit duhet të ruajë hekurosjen për një kohë të gjatë.
- Kostumi duhet të jetë i lehtë për tu mirëmbajtur.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e kostumeve është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Qepja e kopsave në kostum duhet të bëhet rreptësisht sipas përshkrimit tek *Specifikimet Teknike*.
- Kopsat duhet të kenë pamje të rregullta. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash, kopsat nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishen ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Kopsa nuk duhet të lenë shenja tek materialet me të cilat do të bien në kontakt.
- Kopsat duhet të jenë 100% prej materialit të përcaktuar në këtë dokument.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Të gjithë artikujt e kostumit të uniformës për meshkuj duhet të pajisen me etiketa prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja e materialeve dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa e xhaketës duhet të qepet tek tegeli i majtë, anësor i astarit.

Etiketa e pantallonave duhet të qepet në qendër të qemerit, mbrapa (në brendësi).

Tek etiketa e pantallonave duhet të qepet edhe 1 kopsë plastike rezervë.

Kopsat rezervë metalike duhet të vendosen në një qese plastike polietileni të mbyllur mirë. Ato duhet të jenë të pranishme tek secili kostum. Ato duhet të vendosen gjatë paketimit në vrimën e dytë të xhaketës me një fije plastike të siguruar mirë.

Kujdes! Duhet të jenë 3 kopsa rezervë metalike, 1 e madhe dhe 2 të vogla (një me pamje në të majtë një me pamje në të djathtë).

Në momentin e dorëzimit kostumet duhet të jenë të pastër, të hekurosur, pa njolla dhe të varur në kremastarë (varëse) të fortë plastikë.

Kremastari për xhaketën duhet të jetë i përshtatshëm për të ruajtur formën e supeve dhe të jetë i pajisur me bosht transversal për varjen e pantallonave. Boshti i kremastarit duhet të jetë i veshur me “push” që pantallonat të mos rrëshqasin apo të pësojnë rrudha.

Xhaketa dhe pantallonat duhet të futen bashkë në një çantë mbrojtëse prej pambuku, me mbyllje me zinxhir në pjesën qendrore dhe me etiketë për vendosjen e emrit të punonjësit.

Kapela duhet të paketohej në një qese më vete.

Artikujt duhet të paktohen me nga dhjetë kostume për kuti.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e kostumit, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluar me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testeve

Xhaketa dhe pantallonat

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave



Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Hollesia e fije	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodën e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Dendësia	EN 1049-2 1993/ ISO 7211-2: 1984 Tekstile - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodën e analizës - Pjesa 2: Përcaktimi i numrit të fijeve për njësi të gjatësisë.
Qëndrueshmëria në tërheqje	EN ISO 13934-1:2013 Tekstile - Vetitë e pëlhurave në tërheqje - Pjesa 1: Përcaktimi i forcës maksimale dhe zgjatimit në forcën maksimale duke përdorur metodën shirit.
Tkurrja në pastrim në të thatë	EN ISO 3759-2011
Përkueshmëria e ajrit	EN ISO 9237:1995 Tekstilet - Përcaktimi i depërtueshmërisë së pëlhurave nga ajri
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. . (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
	EN ISO 105 - X11
	EN ISO 105 - D01
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
Ph	EN ISO 3071:2006

Procedura e trajtimit	EN ISO 3758
-----------------------	-------------

Kapele

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Hollesia e fijeve	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Dendësia	EN 1049-2 1993/ ISO 7211-2: 1984 Tekstile - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 2: Përcaktimi i numrit të fijeve për njësi të gjatësisë.
Qëndrueshmëria në tërheqje	EN ISO 13934-1:2013 Tekstile - Vetitë e pëlhurave në tërheqje - Pjesa 1: Përcaktimi i forcës maksimale dhe zgjatimit në forcën maksimale duke përdorur metodën shirit.
Tkurrja në pastrim në të thatë	EN ISO 3759-2011
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. . (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
	EN ISO 105 - D01
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.

Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrujes	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
Ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

Per astaret e brendshëm te kostumit

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Hollesia e fijeve	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Dendësia	EN 1049-2 1993/ ISO 7211-2: 1984 Tekstile - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 2: Përcaktimi i numrit të fijeve për njësi të gjatësisë.
Kendi i kthimit pas ngjeshjes	EN 22313:1993
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
	EN ISO 105 - X11
	EN ISO 105 - E06
	EN ISO 105 - D01
	EN ISO 105 - X05
	EN ISO 105 - E07
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni

Azo Ngjyrujes	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
Ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

Per astarin e kapeles

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m2	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Hollesia e fije	ISO 7211-5: 1984 Tekstilet - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 5: Përcaktimi i dendësisë lineare të fijeve të hequra nga pëlhura.
Dendësia	EN 1049-2 1993/ ISO 7211-2: 1984 Tekstile - Pëlhurat e endura - Ndërtimi - Metodat e analizës - Pjesa 2: Përcaktimi i numrit të fijeve për njësi të gjatësisë.
Kendi i kthimit pas ngjeshjes	EN 22313:1993
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
	EN ISO 105 - X11
	EN ISO 105 – E06
	EN ISO 105 – D01
	EN ISO 105 – X05
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105 – E07
	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni

Azo Ngjyrujes	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
Ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme

TE DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Kravata e kostumit të uniformës

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *kravatë e kostumit të uniformës* duhet të jetë i cilësisë së parë me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja %	100 % poliestër	
Thurja	diagonal 2/1	
Masa gr/m ² (± 5 %)	110 gr/m ²	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4-5 (Shkalla gri)	ngjyrosja duhet të jetë në fije
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 10000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4-5	
Azo Ngjyruet	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4.0 - 9.0	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se – nota 6: shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu të errët do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu e errët nuk njollos tekstilin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *kravatë e kostumit të uniformës*:

Frazelinë		
Frazelinë prej tekstili, për ndërtimin e kravatës 	Përbërja	50% lesh, 50% poliestër
	Ngjyra	e bardhë / bezhë
	Thurje	garniturë të dërstiluar
Astari		
Astari	Përbërja	100% acetat
	Ngjyra	njësoj si kravata
	Thurje	diagonale
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	120 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Zgjatueshmëria	≥ 15%
	Ngjyra	njësoj si kravata
Aksesorë të tjerë		
Shirit 	Gjerësia	10 mm
	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	njësoj si kravata
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese dhe instruksionet e mirëmbajtjes. (2 copë)	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e zezë

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *kravatë e kostumit të uniformës*:
Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.



Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. PËRMASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *kravatë e kostumit të uniformës* do të porositet në copë dhe do të prodhohet sipas një përmase standarde për femra dhe për meshkuj.

Kravatë për femra duhet të ketë këto përmasa:	
Gjatësia totale e kravatës	145 cm
Gjerësia maksimale e kravatës në pjesën përpara	7.5 cm

Kravatë për meshkuj duhet të ketë këto përmasa:	
Gjatësia totale e kravatës	145 cm
Gjerësia maksimale e kravatës në pjesën përpara	8.5 cm

3. NGJYRA REFERENCË

Ngjyra blu për tekstin e kravatës dhe astarin sipas spektrit CIELCH 18, 14.587, 295.349.

Ngjyra e paraqitur në këtë dokument shërben si referencë për prodhuesin. Aprovimi i saj do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.



Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *kravatë e kostumit të uniformës*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën.

Kujdes!! Të gjitha detalet e kravatës duhet të pozicionohen në tekstil dhe priten me kënd 45° për t'i dhënë elasticitetin e duhur kravatës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 50 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

5. NDËRTIMI I KRAVATËS


Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të kravatës së kostumit të uniformës.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Kravata para

Kravata mbrapa



Kravata për meshkuj dhe kravata për femra kanë të njëjtën ngjyrë, material dhe formë, përveç përmasave.

Pjesët përbërëse të kravatës janë:

1. Pjesa e përparme,
2. Pjesa rreth qafës
3. "Bishti"


Kravata duhet të jetë e përbërë nga tre pjesë tekstili me ngjyrë blu të errët dhe një shtresë përforcuese më e vogël me tekstil të dërstiluar me përbërje të përzierë. Shtresa përforcuese duhet të ketë formën e kravatës së përfunduar dhe të qepet para se të bëhet palosja.

Kravata duhet të ndërtohet sipas metodave standarde të ndërtimit të kravatave. Pjesët e tekstilit të *kravatës* duhet të kenë prerje 45 gradë. Tre pjesët e kravatës duhet të qepen me njëra-tjetrën me

tegel linear një gjilpërësh, ndërsa buzët anësore të tyre duhet të palosen dy herë para se të bëhet qepja mbyllëse në aksin qendror. Qepja mbyllëse duhet të jetë e qepur me dorë me qepje të fshehtë. Qepja qendrore duhet të përforcohen në fillim dhe në fund me qepje të jashtme me lak.

Fillimi dhe fundi i kravatës duhet të përfundojnë me majë në formë shigjete. Anët e brendshme të majave duhet të vishen me astar.

Kravata duhet të pajiset me mbajtëse bishti me tekstil të njëjtë si kravata dhe me përmasa 4 x 1 cm, i cili duhet të qepet në një distancë rreth 25 cm nga maja e madhe.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME


- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes të kravatës duhet të jenë me hap 7 shpime në 1 cm dhe të jenë të padukshëm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik, me elasticitetin e duhur dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.

- Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
- Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e kravatës duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili i kravatës duhet të ruajë hekurosjen për një kohë të gjatë.
- Kravata duhet të jetë e lehtë për tu mirëmbajtur.
- Artikulli duhet të prodhohet sipas përmasave të përcaktuara në këtë specifikim teknik.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e kravatave është $\pm 2\%$.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me çertifikaten e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Kravata duhet të pajiset me dy etiketa prej tekstili: një etiketë ku do të shënohet emri i fabrikës, viti i prodhimit dhe gjinia e përdoruesit, dhe një tjetër ku do të shënohet informacioni mbi përbërjen dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa me emrin e fabrikës duhet të qepet poshtë mbajtëses së bishtit ndërsa etiketa tjetër duhet të qepet tek maja e bishtit, tek tegeli që qep astarin me tekstin e palosur. *Shiko ilustrimin teknik.*



Kravatat duhet të jenë të pastruara nga fijet, të hekurosura dhe të paketuara me qese polietileni të posaçme për kravatë. Qeset me kravatë duhet të vendosen në kuti të shtrira drejt, në pozicion horizontal, pa palosje ose përdredhje.

Çdo kuti duhet të përmbajë të njëjtën sasi kravatash. Kravatat për femra duhet të jenë në kuti me vete nga ato për meshkuj.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve.

Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar gjinia e kravatës, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese.

Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluar me shirit ngjites (natriban).

ANEKS - Lista e testeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testeve

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. . (pas 5 cikle te larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.

Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Pantallona verore për meshkuj

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *pantallona verore për meshkuj* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	blu e errët (evening blue) spektrit CIELCH 18, 14.587, 295.349		
Përbërja % (± 5%)	62% Poliester	35% Viskozë	3 % Elastan
Thurja	diagonale 2/1 (sarzh)		
Masa gr/m² (± 5%)	210gr/m²		
Qëndrueshmëria e ngjyrës	Nota 4-5 (Shkalla Gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fije.	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle		
Efekti pilling (kokërrzimi)	Nota 4-5		
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm		
pH	4.0 - 9.0		

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme* – nota 4 dhe *shumë e qëndrueshme* – nota 5. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se* – nota 6 : *shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu të errët do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu e errët nuk njollos tekstin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (*kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse*):

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

b. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *pantallona verore për meshkuj*:

Astar		
Tekstil <i>Silesia</i> për qemerin, profilimin e sallkisë dhe xhepat.	Përbërja	100% pambuk
	Ngjyra	e zezë
	Thurje	diagonale me vija
Astar i brendshëm për pantallonat.	Përbërja	100% <i>viscose</i>
	Ngjyra	blu e errët,
	Thurje	diagonale
	Pesha	86 gr/m ² ± 3%
Përforcues		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me vrima me gjerësi rreth 6 cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me lartësi rreth 3.5 cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive e hollë për ylyqet.		
Fileto zbkuruese		
Fileto cilindrike zbkuruese për pantallonat (për policët).	Trashësia	± 3 mm
	Përbërja	100% <i>viscose</i>
	Ngjyra	e kuqe
Aksesorë të tjerë		
1 zinxhir me dhëmbëza plastikë	Gjatësia	16 –18 cm
	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	njësoj si pantallonat
1 kapëse metalike femër-mashkull për qemerin e pantallonave.		
Etiketa prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese dhe instruksionet e mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet (përfshi vrimat dhe travetat).	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	njësoj si pantallonat
Kopsa plastike		
	1 copë Nr. 34 (d 21mm) 2 copë (d 15 mm) + 1 rezervë	
	Ngjyra e kopsës	blu e errët
	Materiali	100% poliestër
	Qepja e kopsës	kryq

c. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *pantallona verore për meshkuj*

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.



Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *pantallona verore për meshkuj* do të porositet dhe do të prodhohet në masat 44 – 66 dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli.




Meshkuj		
4	Perimetri i belit	cm.
5	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
8	Perimetri i gjurit poshtë kupës së tij	cm.
9	Perimetri i kyçit të këmbës (kaviljes)	cm.
10	Gjatësia e plotë	cm.
11	Lartësi e përgjithshme e trupit mbrapa (nga supi në tokë)	cm.
17	Gjatësia nga beli tek vija e gjurit (poshtë kupës së gjurit)	cm.
18	Gjatësia nga beli tek kyçi i këmbës	cm.
19	Gjatësia e brendshme e këmbës deri tek vija e gjurit	cm.
20	Gjatësia e brendshme e këmbës deri tek kyçi i këmbës	cm.

3. NGJYRAT REFERENCE

Ngjyra blu për tekstin e pantallonave dhe astarit spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349 .

Ngjyra e kuqe spektri sipas CIECLCH 41, 70.780, 28.754 për filetot dhe fijet dekorative.



Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *pantallona verore për meshkuj*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.


Aplikimi i frazelinës

Ngjitja e frazelinës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 130–140 °C, me kohëzgjatje 8–10 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagjes nga shiu. Nuk lejohet kollaritja me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I PANTALLONAVE

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të pantallonave verore për meshkuj.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.



Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pjesët përbërëse të pantallonave:

- Qemeri
- Dy pjesët e këmbëve
- Dy xhepat e përparmë
- Dy xhepat e pasmë

QEMERI (1)

Lartësia e qemerit duhet të jetë 3,5 cm. Ai duhet të jetë i përbërë nga dy shtresa tekstili me përmasa të njëjta (brenda dhe jashtë) dhe nga dy shtresa të brendshme përforcuese. Renditja e shtresave të qemerit duhet të bëhet si më poshtë:

9. Shtresa e jashtme prej tekstili të njëjtë me pantallonat.
10. Shtresa e dytë e brendshme me lartësi rreth 6 cm prej tekstili termoadeziv.
11. Shtresa e tretë përforcuese me frazelinë termoadezive me vrima.
12. Shtresa e brendshme (e pantallonave) me tekstil *Silesia* me lartësi rreth 7 cm.

Qemeri duhet të bashkohet me pantallonat me tegel të padukshëm. Qemeri duhet të ketë një shtesë prej 3 cm (nga vijat e zinxhirit) në të dy anët. Shtesat duhet të përfundojnë me kulme në formë shigjete. Në njërin shtesë duhet të hapet vrima e kopsës me gjatësi 25 mm ndërsa në tjetrën duhet të qepet kopsa e pantallonave.

Në anën e brendshme të qemerit, në linjë me zinxhirin duhet të montohet një kapëse e thjeshtë me mekanizëm “femër-mashkull”.



Kopsat duhet të jenë Nr. 34 (21 mm) me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsave duhet të bëhet kryq.

Ylyqet.(2) Pantallonat duhet të kenë gjithsej 6 ylyqe me gjatësi 5 cm dhe gjerësi 1 cm. Dy përpara dhe katër mbrapa. Ylyqet e përparme duhet të vendosen në linjën e vijës së hekurosjes së pantallonave. Dy ylyqe të pasme duhet të vendosen të baraslarguar nga linja qendrore e pantallonave dhe dy të tjerët të baraslarguar nga pencat.

Ylyqet duhet të përbëhen nga dy shtresa tekstili ngjyrë blu (si xhaketa) dhe një shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive.

Ato duhet gjithashtu të përforcohen në të dy skajet me traveta ngjyrë blu të errët.

DY PJESET E KËMBËVE

Sallkia (4) duhet të ndërtohet me dy pjesë: pjesa e mbuluar dhe kapaku (e zinxhirit). Pjesa e mbuluar duhet të jetë e veshur me tekstil *Silesia* nga brenda dhe me tekstilin e pantallonave nga jashtë ndërsa kapaku duhet të qepet nga të dyja anët me tekstilin e pantallonave.

Zinxhiri i sallkisë. Gjatësia e zinxhirit mund të ndryshojë sipas masave, nga 16–18 cm. Zinxhiri duhet të jetë me fiksim tek koka në mënyrë që të mos hapet vetë gjatë veshjes.

Ngjyra e zinxhirit duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e pantallonave.

Shiritat e kuq dekorativë. (3) Tek tegelat anësorë të këmbëve duhet të qepet fileto dekorative cilindrike me gjerësi ± 3 mm.

Pencat. (5) Në pjesën e pasme të pantallonave, poshtë qemerit, duhet të qepen dy penca vertikale me gjatësi 7 cm, një në të majtë dhe një në të djathtë.

Astari. Pantallonat duhet të jenë të veshura me astar vetëm në pjesën e përparme, deri poshtë linjës së gjurit. Astar duhet të jetë prej materiali me përbërje 100% *viscose*.

Tegeli anësor i këmbëve dhe fundet e pantallonave duhet të jenë të profiluara me syzator.

XHEPAT (6)

Xhepat diagonalë. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonalë. Hapja e xhepit duhet të fillojë poshtë qemerit, në një distancë 3 cm nga tegeli anësor i pantallonave dhe të përfundojë po tek tegeli anësor.

Xhepi duhet të jetë 16 cm i gjatë. Ai duhet të përforcohet në të dy ekstremitetet e tij me travetë.

Xhepat duhet të përshkohen gjatë gjithë gjatësisë nga një tegel linear me distancë 7 mm nga buza e jashtme.

Në pjesën e dukshme (mostra) xhepat duhet të jenë të veshur me tekstil të njëjtë me pantallonat. Astari i xhepave duhet të jetë prej tekstili *Silesia*.

Xhepat fileto. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të pasmë me fileto të dyfishtë të pozicionuar menjëherë poshtë pencave. Filetoja e dyfishtë dhe tekstili përreth hapjes e xhepit duhet të përforcohen me frazelinë termoadezive.

Astari i xhepit duhet të jetë prej tekstili *Silesia*.

Hapja e xhepave me fileto do të ndryshojë sipas prerjes, nga 13–14 cm.

Xhepat duhet të jenë edhe me kopsë. Vrimat e kopsave duhet të kenë gjatësi 25 mm dhe distancë rreth 1cm nga filetoja e poshtme.

Kopsat duhet të jenë d 15 mm me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsave duhet të bëhet kryq. Kopsat duhet të qepen në një distancë prej 15 mm nga filetoja e sipërme e xhepave.

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së pantallonave duhet të jenë me hap 6 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniforme, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e pantallonave duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili i pantallonave duhet të ruajë hekurosjen për një kohë të gjatë.
- Pantallonat duhet të jenë të lehta për tu mirëmbajtur.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e pantallonave është $\pm 2\%$.
- Kopsat duhet të kenë pamje të rregullta. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash, kopsat nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishen ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
a. EN ISO 14362-1:2017

- b. EN ISO 14362-3:2017
- c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuksi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.


7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Pantallonat e uniformës verore për meshkuj duhet të pajisen me një etiketë prej tekstili, në të cilën duhet të shënohet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Etiketa duhet të qepet në qendër të qemerit, mbrapa (në brendësi). Në etiketë duhet të qepet edhe 1 kopsë rezervë plastike blu për pantallonat.

Në momentin e dorëzimit pantallonat duhet të jenë të pastra dhe të rregullta. Ato duhet të jenë të hekurosur dhe të paketohen në qese polietileni. Artikulli duhet të paketohen me nga 20 palë pantallona për kuti.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adezive, në të cilën duhet shënuar masa e pantallonave, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).



ANEKS - Lista e testeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testeve

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.

Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. . (pas 5 cikle te larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TE DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Pantallona dhe fund veror për femra

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *pantallona dhe fund veror për femra* është tekstili i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	blu e errët (evening blue) spektrit CIELCH 18, 14.587, 295.349		
Përbërja % (± 5%)	62% Poliester	35% Viskoze	3 % Elastan
Thurja	diagonale 2/1 (sarzh)		
Masa gr/ m² (± 5%)	210gr/ m²		
Qëndrueshmëria e ngjyrës	Nota 4-5 (Shkalla Gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fije.	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle		
Efekti pilling (kokërrzimi)	Nota 4 – 5		
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm		
pH	4.0 - 9.0		

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se – nota 6 : shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu të errët do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu e errët nuk njollos tekstin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

PANTALLONAT

b. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *pantallona verore për femra*:

Astar		
Astar i brendshëm për xhepat	Përbërja	100% <i>viscose</i>
	Ngjyra	njësoj si pantallonat
	Thurje	diagonale
	Pesha	86 gr/m ² ± 5%
Përforcues		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me vrima me gjerësi rreth 6 cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me lartësi rreth 3.5 cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive e hollë për ylyqet.		
Fileto zbukuruese		
Fileto cilindrike zbukuruese për pantallonat	Trashësia	± 3 mm
	Përbërja	100% <i>viscose</i>
	Ngjyra	e kuqe
Aksesorë të tjerë		
1 zinxhir me dhëmbëza plastikë	Gjatësia	16–18 cm
	Përbërja	100 % poliestër
	Ngjyra	njësoj si pantallonat
1 kapëse metalike femër-mashkull për qemerin e pantallonave.		
Etiketa prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese dhe instruksionet e mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet (përfshi vrimat dhe travetat).	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	njësoj si pantallonat
Kopsa plastike		
	1 copë Nr. 34 (d 21mm) + 1 rezervë	
	Ngjyra e kopsës	blu e errët
	Materiali	100% poliestër
	Qepja e kopsës	kryq

FUNDI

c. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *fund veror për femra*:

Astar		
Astar i brendshëm për fundin dhe xhepat.	Përbërja	100% <i>viscose</i>
	Ngjyra	blu e errët
	Thurje	diagonale
	Pesha	86 gr/m ² ± 5%.
Përforcues		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me vrima me gjerësi rreth 6 cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me lartësi rreth 3.5 cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive e hollë për ylyqet.		
Fileto zbukuruese		
Fileto cilindrike zbukuruese për fundin	Trashësia	± 3 mm
	Përbërja	100% <i>viscose</i>
	Ngjyra	e kuqe
Aksesorë të tjerë		
1 zinxhir me dhëmbëza plastike	Gjatësia	16–18 cm
	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	njësoj si fundi
1 kapëse metalike femër-mashkull për qemerin e fundit		
Etiketa prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese dhe instruksionet e mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet (përfshi vrimat dhe travetat).	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	njësoj si fundi
Kopsa plastike		
	1 copë Nr. 34 (d 21mm) + 1 rezervë	
	Ngjyra e kopsës	blu e errët
	Materiali	100% poliestër
	Qepja e kopsës	paralele

d. Materialet që duhet të përdoren për paketimin e artikullit *Pantallona dhe fund veror për femra*.

Fotografia e mëposhtme shërben vetëm si shembull ilustrues.



Qese polietileni për paketimin e pantallonave dhe qese për paketimin e fundit

Kuti kartoni për paketimin e pantallonave dhe për paketimin e fundeve

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *pantallona dhe fund veror për femra* do të porositet dhe do të prodhohet në masat 36–54 dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:




Femra		
5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri tek pjesa e barkut	cm.
7	Perimetri tek pjesa e vitheve	cm.
13	Lartësia nga vija e belit tek linja e kockës abdominale	cm.
14	Lartësia e pjesës abdominale (nga vija e belit tek linja e vitheve)	cm.
15	Gjatësia nga beli tek linja e gjurit (poshtë kupës së gjurit)	cm.
16	Gjatësia nga beli tek kocka e kavaljes	cm.
22	Gjatësia e shtratit e matur ulur	cm.
23	Gjatësia e brendshme këmbës deri tek linja e gjurit.	cm.
24	Gjatësia e brendshme këmbës deri tek kavalja	cm.
25	Gjatësia e personit	cm.

3. NGJYRAT REFERENCË

Ngjyra blu për tekstin e pantallonave dhe astarit spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349 .

Ngjyra e kuqe spektri sipas CIECLCH 41, 70.780, 28.754 për filetot dhe fijet dekorative.



Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecure cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *pantallona dhe fund veror për femra*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Aplikimi i frazelinës

Ngjitja e frazelinës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 130–140 °C, me kohëzgjatje 8–10 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet kollaritja me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I PANTALLONAVE DHE FUNDIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të pantallonave dhe fundit veror për femra. Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.

I. PANTALLONAT E UNIFORMËS VERORE PËR FEMRA



Konstruksioni i pantallonave për femra duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pjesët përbërëse të pantallonave:

- Qemeri
- Dy pjesët e këmbëve
- Dy xhepat e përparmë

QEMERI (1)

Lartësia e qemerit duhet të jetë 3.5 cm.

Qemeri duhet të jetë i përbërë nga dy shtresa tekstili me përmasa të njëjta (brenda dhe jashtë) dhe nga dy shtresa të brendshme përforcuese. Renditja e shtresave të qemerit duhet të bëhet si më poshtë:

1. Shtresa e jashtme prej tekstili të njëjtë me pantallonat.
2. Shtresa e dytë e brendshme me lartësi rreth 6 cm prej tekstili termoadeziv.
3. Shtresa e tretë përforcuese me frazelinë termoadezive me vrima.
4. Shtresa e brendshme (e pantallonave) prej materiali të njëjtë me pantallonat

Qemeri duhet të bashkohet me pantallonat me tegel të padukshëm.

Qemeri duhet të ketë një shtesë prej 3 cm (nga vijat e zinxhirit) në të dy anët. Shtesat duhet të përfundojnë me kulme në formë shigjete. Në njërin shtesë duhet të hapet vrima e kopsës me gjatësi 25 mm ndërsa në tjetrën duhet të qepet kopsa e pantallonave.

Në anën e brendshme të qemerit, në linjë me zinxhirin duhet të montohet një kapëse e thjeshtë me mekanizëm “femër-mashkull”.



Kopsat duhet të jenë Nr. 34 (21 mm) me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsave duhet të bëhet kryq.

Ylyqet (2) Pantallonat duhet të kenë gjithsej 5 ylyqe me gjatësi 5 cm dhe gjerësi 1 cm. Dy përpara dhe tre mbrapa. Ylyqet e përparme duhet të vendosen ngjitur me xhepat. Dy ylyqe të pasme duhet të vendosen ngjitur me pencat nga pjesa e brendshme dhe një në linjën qendrore të pantallonave.

Ylyqet duhet të përbëhen nga dy shtresa tekstili ngjyrë blu dhe një shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive.

Ato duhet gjithashtu të përforcohen në të dy skajet me traveta ngjyrë blu të errët.

DY PJESET E KËMBËVE

Sallkia (4) duhet të ndërtohet me prej të njëjtit material si pantallonat.

Zinxhiri i sallkisë. Gjatësia e zinxhirit mund të ndryshojë sipas masave, nga 16–18 cm. Zinxhiri duhet të jetë me fiksim tek koka në mënyrë që të mos hapet vetë gjatë veshjes. Ngjyra e zinxhirit duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e pantallonave.

Shiritat e kuq dekorativë.(3) Tek tegelat anësorë të këmbëve duhet të qepet fileto dekorative cilindrike me gjerësi ± 3 mm.

Pencat. (5) Në pjesën e pasme të pantallonave, poshtë qemerit, duhet të qepen dy penca vertikale me gjatësi 7 cm, një në të majtë dhe një në të djathtë.

Tegeli anësor i këmbëve dhe fundet e pantallonave duhet të jenë të profiluara me syzator.

XHEPAT (6)

Xhepat diagonalë. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonalë. Hapja e xhepit duhet të fillojë poshtë qemerit, në një distancë 3 cm nga tegeli anësor i pantallonave dhe të përfundojë po tek tegeli anësor.

Xhepat duhet të jenë 16 cm të gjatë. Ato duhet të përforcohen në të dy ekstremitet e tyre me travetë.

Xhepat duhet të përshkohen gjatë gjithë gjatësisë nga një tegel linear me distancë 7 mm nga buza e jashtme.

Në pjesën e dukshme (mostra) xhepat duhet të jenë të veshur me tekstil të njëjtë me pantallonat. Astari i xhepave duhet të jetë 100% *viscose*.

II. FUNDI I UNIFORMËS VERORE PËR FEMRA



Konstruksioni i fundit për femra duhet të jetë sipas modelit klasik me gjatësi deri poshtë kupës së gjurit. *Shiko linjat për referencë te figura e marrjes së masave.*

Pjesët përbërëse të fundit:

- Qemerit
- Pjesa e përparme
- Pjesa e pasme (me dy pjesë)
- Dy xhepat e përparmë

QEMERI (1)

Qemeri duhet të jetë i përbërë nga një shtresë e vetme tekstili e palosur në dysh e përforcuar me frazelinë termoadezive.

Qemeri duhet të jetë 3.5 cm i lartë dhe duhet të bashkohet me fundin me tegel të padukshëm.


Qemeri duhet të zgjatet me 3 cm në të dyja anët. Shtesat duhet të përfundojnë me formë drejtkëndore. Tek shtesa duhet të hapet vrima e kopsës me gjatësi 25 mm ndërsa në ekstremitetin tjetër të qemerit duhet të qepet kopsa e fundit.

Kopsat duhet të jenë Nr. 34 (21 mm) me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsës duhet të bëhet me vija paralele.

Ylyqet.(2) Fundi duhet të kenë gjithsej 4 ylyqe me gjatësi 5 cm dhe gjerësi 1 cm. Dy përpara dhe dy mbrapa. 2 ylyqet përpara dhe 2 ylyqet mbrapa duhet të vendosen ngjitur me pencat, nga ana e brendshme. Shiko ilustrimin më poshtë.

Ylyqet duhet të jenë të përbërë nga dy shtresa tekstili ngjyrë blu (si fundi) dhe një shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive.

Ato duhet gjithashtu të përforcohen në të dy skajet me traveta ngjyrë blu të errët.



PJESA E PËRPARME

Pencat (3): Fundit duhet t'i vendosen përpara dy penca me gjatësi 7 cm.

Shiritat e kuq dekorativë.(4) Tek tegelat anësorë të fundit duhet të qepen fileto dekorative me gjerësi ± 3 mm.

Xhepat diagonalë. (5) Fundi duhet të pajiset me dy xhepa të përparmë diagonalë.

Hapja e xhepit duhet të fillojë poshtë qemerit, në një distancë 3 cm nga tegeli anësor i fundit dhe të përfundojë po tek tegeli anësor. Xhepat duhet të jenë 16 cm të gjatë. Ato duhet të përforcohen në të dy ekstremitetet e tyre me travetë.

Xhepat duhet të përshkohen gjatë gjithë gjatësisë nga një tegel linear me distancë 1 mm nga buza e jashtme.

Në pjesën e dukshme (mostra) xhepat duhet të jenë të veshur me tekstil të njëjtë me fundin.

Astari i xhepave duhet të jetë 100% material *viscose*.

PJESA E PASME

Pencat. (6) Fundit duhet t'i vendosen prapa dy penca me gjatësi 9 cm.

Zinxhiri (7) duhet qepet në aksin qendror, mbrapa. Gjatësia e tij do të ndryshojë sipas masave nga 16–18 cm.

Zinxhiri duhet të jetë me fiksime të mos hapet gjatë përdorimit të fundit.

Zinxhiri duhet të mbulohet nga tekstili i dy pjesëve të pasme.

E çara e fundit (8) duhet të jetë në fund të linjës së prerjes dhe të ketë lartësi 15 cm.
Në brendësi duhet të ketë një palë të brendshme me gjerësi 5.5 cm.
Pala duhet ta ketë palosjen: pjesa e djathtë mbi të majtën.

Astari duhet të ndërtohet me tre pjesë (një para dhe dy mbrapa) dhe të ketë të njëjtën prerje si fundi. Ai duhet të qepet tek buza e poshtme e qemerit.

Njësoj si tek fundi, edhe tek astari duhet të qepen dy penca përpara dhe dy penca mbrapa.

Në linjën fundore të tij astari duhet të jetë i kthyer dy herë dhe i qepur me tegel qepës linear.

Astari duhet të ndërtohet me tekstil, përbërja e të cilit duhet të jetë 100% material *viscose*.

6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME PËR PRODHIMIN E PRODUKTIT


- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së pantallonave dhe fundit duhet të jenë me hap 6 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e pantallonave dhe fundit duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili i pantallonave dhe fundit duhet të ruajë hekurosjen për një kohë të gjatë.
- Pantallonat dhe fundi duhet të jenë të lehtë për tu mirëmbajtur.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e fundit dhe pantallonave është $\pm 2\%$.
- Kopsat duhet të kenë pamje të rregullta. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash, kopsat nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishen ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Të dy artikujt e uniformës verore për femra duhet të pajisen me etiketa prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Tek pantallonat dhe tek fundi duhet të qepet një etiketë në qendër të qemerit, mbrapa (në brendësi).

Në etiketën e pantallonave dhe të fundit duhet të qepet dhe 1 kopsë rezervë plastike blu për pantallonat dhe fundin.



Në momentin e dorëzimit pantallonat dhe fundi duhet të jenë të pastra, të hekurosura dhe të rregullta.

Pantallonat dhe fundet duhet të futen në nga një qese polietilene. Në çdo kuti duhet të vendosen pantallona ose funde të së njëjtës masë. Çdo kuti duhet të ketë sasi të barabartë artikujsh.

Artikujt duhet të pakëtohen me nga 20 palë pantallona ose funde për 1 kuti.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e pantallonave dhe fundit, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testeve

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005

	Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. . (pas 5 cikle te larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Kapela e uniformës verore për meshkuj dhe femra

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *kapela e uniformës verore për meshkuj dhe femra* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	blu e errët spektrit CIELCH 18, 14.587, 295.349	
Përbërja (± 5%)	50% pambuk	50% poliestër
Thurja	diagonale 2/1 (sarzh)	
Pesha (± 5%)	200 - 220 gr/m ²	
Qëndrueshmëria e ngjyrës	nota 4–5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fill.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle	
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4–5	
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm	
pH	4.0 - 9.0	

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t’u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t’i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se – nota 6; shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet ky testim: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu të errët do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu e errët nuk njollos tekstin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (*kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse*):

- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

KAPELA PËR MESHKUJ

a. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *kapela e uniformës verore për meshkuj*:

Astar		
Astar në formë rrjete	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	i zi
Astar për kurorën e kapelës	Përbërja	100% pambuk
	Ngjyra	e bardhë
	Thurje	garniturë
	Pesha	80 gr/m ² ± 5%
Përforcues		
Shtresë përforcuese termoadezive prej tekstili të endur.	Përbërja	53% viscose, 47% pambuk.
	Thurja	garniturë
	Peshë mesatare:	115 gr/m ² ± 5 %.
	Temperatura e aplikimit	150° C
	Ngjyra	e zezë
Shtresë sfungjeri me trashësi 7 mm për pjesën ballore të kurorës.		
Shtresë plastike polietileni me lartësi 50 mm dhe trashësi 1mm për fashën rrethore.		
Shtresë e hollë plastike drejtkëndore me përmasa 1.6 x 12 cm dhe trashësi 1,5 mm për vendosjen e stemës së Policisë së Shtetit.		
Fileto zbukuruese		
2 fileto cilindrike zbukuruese për kurorën e kapelës.	Trashësia	± 3 mm
	Përbërja	100% viscose
	Ngjyra	e kuqe
Shirit dekorative.	Gjerësia	30 mm
	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	Blu shumë e errët
Aksesorë të tjerë		
Shirit prej lëkure gjedhi me ngjyrë të zezë dhe me vrima për ajrosje, për shiritin dekorativ.		
Unazë rrethore metalike me trashësi rreth 1mm për fashën rrethore.		
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese dhe instruksionet e mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë
Filli		
Fill për të gjitha qepjet.	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	njësoj si tekstili
Fill për qepjen e strehës.	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	70 Nm

	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N	
	Ngjyra	e zezë	
Streha			
Pjesa e sipërme (me shkëlqim).	Trashësia	±0.5 mm	
	Përbërja	polivinil kloruri	
	Ngjyra	e zezë	
Pjesa e poshtme (me relief që imiton lëkurën).	Trashësia	± 1.5 mm	
	Përbërja	polivinil kloruri	
	Ngjyra	e gjelbër	
Shirit për profilimin të buzës së strehës.	Trashësia	± 0.2 mm	
	Përbërja	polivinil kloruri	
	Ngjyra	e zezë	
Kapelet për gradat Drejtues i Lartë dhe Drejtues Madhor, duhet të jenë me elementë dekorues me ngjyrë të artë, në pjesën mbi strehë. Shembull.			
			
Aksesorë të lëvizshëm			
Kopsa metalike  shembull 	2 copë me d 15 mm një me pamje nga e majta dhe një me pamje nga a djathta.		
	Trashësia	në qendër	2 mm
		në buzë	1 mm
	Gjerësia e konturit rrethues		1 mm
	Tipi	me këmbëz rrumbullake	
		gjatësia	5 mm
		gjerësia	4 mm
		trashësia	2 mm
	diametri i vrimës		2 mm
	Ngjyra	e artë, me shkëlqim mat	
	Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm	
	Skalitje	Përkrenarja e Skënderbeut	
		përmasa	8 x 10 mm
Karficë metalike për montimin e kopsave në kapele.			
			
Rrip dekorativ me unaza dhe perçina për shtrëngim.	Rripi dekorativ		
	Përbërja	100 % polivinil kloruri (PVC)	
	Ngjyra	e zezë, me shkëlqim	
	Lartësia	14 mm	
	Trashësia	1 mm	

	Gjatësia	25 cm
	Unaza 2 (copë)	
	Gjerësia	15 mm
	Lartësia	17 mm
	Trashësi	1 mm
	Përbërja	plastike
	Perçina (2 copë)	
	Diametër	7 mm
	Përbërja	metalike
	Ngjyra	e zezë

		
--	--	--

Stema metalike		Tipi	me 2 këmbëza me filetimit
		Përmasat	6 x 5 cm
		Trashësia	± 2 mm
		Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm
		Ngjyra	e artë, me shkëlqim mat
		Skalitje	detajet e emblemës

KAPELA PËR FEMRA

b. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesoreve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *kapela e uniformës verore për femra*

Astar		
Astar për veshjen e kapelës.	Përbërja	100% pambuk
	Ngjyra	e bardhë
	Thurje	garniturë
	Pesha	80 gr/m ² ± 5%
Përforcues		
Tekstil i kollarisur për përforcimin e kurorës	Përbërja	100% pambuk
	Pesha	250 g/m ² ± 5%
Tekstil i kollarisur për përforcimin e strehës.	Përbërja	100% pambuk
	Pesha	220 g/m ² ± 5%
Fileto zbukuruese		
fileto cilindrike zbukuruese për kurorën e kapelës.	Trashësia	± 3 mm
	Përbërja	100% viskoze
	Ngjyra	e kuqe
Fashë dekorative me konture të kuqe.	Gjerësia	30 mm
	Trashësia e kontureve	3 mm
	Përbërja	100% poliester

	Ngjyra	Blu shumë e errët	
Aksesorë të tjerë			
Shirit prej lekure gjedhi me ngjyrë të zezë për pjesën e perimetrit të brendshëm të kapeles.			
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese dhe instruksionet e mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliestër	
	Ngjyra	e bardhë	
Llastik i zi me gjerësi 1 cm dhe gjatësi 36 cm për kapjen e kapelës në kokë.			
Filli			
Fill për të gjitha qepjet.	Përbërja	100% poliestër	
	Numri metrik	80 Nm	
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N	
	Ngjyra	njësoj si kapela	
Fill për qepjen e strehës.	Përbërja	100% poliestër	
	Numri metrik	30 Nm	
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N	
	Ngjyra	njësoj si kapela	
Aksesorë të lëvizshëm			
Kopsa metalike  Shembull 	2 copë me d 15 mm një me pamje nga e majta dhe një me pamje nga a djathta.		
	Trashësia	në qendër	2 mm
		në buzë	1 mm
	Gjerësia e konturit rrethues		1 mm
	Tipi	me këmbëz rrumbullake	
		gjatësia	5 mm
		gjerësia	4 mm
		trashësia	2 mm
		diametri i vrimës	2 mm
	Ngjyra	e artë, me shkëlqim mat	
	Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm	
	Gdhendje	Përkrenarja e Skënderbeut	
		përmasa	8 x 10 mm
Karficë metalike për montimin e kopsave në kapele.			
Rrip dekorativ me yllkë për shtrëngim.	Rrip dekorativ		
	Përbërja	100 % PVC	
	Ngjyra	e zezë, me shkëlqim	
	Lartësia	14 mm	
	Trashësia	1 mm	
	Gjatësia	25 cm	

		Unaza 2 (copë)	
		Gjerësia	15 mm
		Lartësia	17 mm
		Trashësi	1 mm
		Përbërja	plastike
		Perçina (2 copë)	
		Diametër	7 mm
		Përbërja	metalike
		Ngjyra	e zezë
			
Stema metalike		Tipi	me 2 këmbëza me filetimit
		Përmasat	6 x 5 cm
		Trashësia	± 2 mm
		Përbërja	tunxh (aliazh zinku dhe bakri) cilësia e I-rë, i pandryshkshëm
		Ngjyra	e artë, me shkëlqim mat
		Skalitje	detajet e emblemës

Kopsat metalike, stema, dhe rripi dekorativ i zi i kapelës do t'u nënshtrohen testimeve të mëposhtme:

- **Rezistencës ndaj ujit.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur në ujë të distiluar për 24 orë në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria ndaj solucioneve larëse.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për 24 orë në ujë me solucion sapun larës 3% në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria ndaj solucioneve tretëse.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë fërkuar lehtë me furçë, me alkool metilik e më pas me benzinë.
- **Qëndrueshmëria ndaj klorurit të sodiumit.** Nuk duhet të shfaqen tjetërsime të pamjes pasi produkti të jetë zhytur për një orë në 1% klorur sodiumi në temperaturë 25°C.
- **Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje.** Nuk duhet të ketë ndryshime të ngjyrës pasi të jetë trajtuar me 5% solucion HCl.
- **Rezistenca ndaj korrozionit.**

Produkti final do t'i nënshtrohet kontrollit fizik të thjeshtë në mënyrë që të vërtetohet plotësimi i kushteve teknike për secilin element si p.sh: që materialet e përdorura janë të përshtatshme për produktin, pamja dhe konstruksioni i përgjithshëm, stilizimi, vlerat estetike, etj. Kontrolli do të bëhet me sy të lirë dhe me mjete të caktuara.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë kopsa, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- kokërrzim (punime të ashpra),
- tonalitete të ngjyrës,
- ndryshim në dendësi të materialit,
- deformime të imazhit të skalitur,
- shkëputje të pjesëve,
- gropëzime ose plasaritje,

- relieve jo të rregullta,
- metalizim jo i rregullt dhe jo rezistent,
- oksidime,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon pamjen funksionale dhe estetike të produktit.

c. Materialet që nevojiten për paketimin e artikullit *kafele e uniformës verore për meshkuj dhe femra*.

qese plastike polietileni për paketimin e kapelës
Kuti kartoni për paketimin e kapelave

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli *kafele e uniformës verore për meshkuj dhe femra* do të porositet dhe do të prodhohet në masat 50 –65 dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



1	Perimetri i kokës	cm.
---	-------------------	-----

3. NGJYRAT REFERENCË



Ngjyra blu spektri sipas CIECLCH 18, 14.587, 295.349 për të gjitha pjesët e kostumit të uniformës, astarit dhe kapelës.

Ngjyra e kuqe spektri sipas CIECLCH 41, 70.780, 28.754 për filetot dhe fijet dekorative.

Ngjyra e artë spektri sipas CIECLCH 72, 63.619, 74.057 për kopsat metalike dhe për shenjat dekorative metalike.

Ngjyra blu për të gjitha pjesët e kapelës.

Ngjyra e kuqe për filetot dekorative.

Ngjyra e artë për kopsat metalike dhe për shenjat dekorative metalike.

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

***Kujdes!** Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.*

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *kapele e uniformës verore për meshkuj dhe femra*

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Kollaritja


Ngjitja e materialit tekstil kollaritës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 130–140° C, me kohëzgjatje 8–10 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet kollaritja me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I KAPELES

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të kapeles së uniformës verore për meshkuj dhe femra.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.

I. KAPELA E UNIFORMËS PËR MESHKUJ



Kapela duhet të prodhohet në të gjitha masat që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të *Policisë së Shtetit*. Masat për meshkuj variojnë nga 53–65. Njësia e matjes duhet të jetë në centimetra.

Pjesët përbërëse të kapelës:

1. Tavani (pjesa e sipërme)
2. Kurora
3. Fasha rrethore
4. Streha
5. Brendia
6. Shiriti dekorativ prej tekstili
7. Filetoja cilindrike dekorative
8. Kopsat metalike anësore
9. Stema
10. Rrip i zi dekorativ

Tavani i kapelës duhet të ketë formë ovale. Ai duhet të përbëhet nga një shtresë tekstili ngjyrë blu të errët të përforcuar me tekstil termoadeziv të endur me ngjyrë të zezë.

Tavani duhet të jetë i veshur me astar në formë rrjete me përmbajtje 100% poliester. Tek astari duhet të qepet edhe etiketa me emrin e fabrikës prodhuese.

Perimetri i brendshëm i tavanit të kapelës duhet të përforcohet me ndihmën e një unaze metalike me trashësi 1–2 mm.

Kurora e kapelës duhet të ndërtohet me 4 prerje: dy para dhe dy mbrapa.

Secila pjesë duhet të përbëhet nga një shtresë tekstili ngjyrë blu të errët të përforcuar me tekstil termoadeziv të endur me ngjyrë të zezë dhe shtresa e sfungjerit me trashësi rreth 7 mm që duhet të vendoset vetëm në pjesën ballore të kapelës.

Kurora e kapelës duhet të jetë e veshur me astar të bardhë methurje garniturë dhe përmbajtje 100% pambuk.

Në pjesën ballore të kapelës, në brendësi të saj, duhet të qepet një shtresë e hollë plastike drejtkëndore e veshur me astar, me trashësi rreth 1.5 mm dhe përmasa 12 x 1.6 cm për montimin e emblemës së *Policisë së Shtetit*. Qepja e shtresës plastike duhet të bëhet tek tegeli qepës i fashës rrethore.

Lartësia e kurorës (kreshtës ballore) duhet të jetë 8 cm për masën 57.

Fasha rrethore e kapelës duhet të jetë e ndërtuar me një pjesë të vetme, e cila duhet të qepet në anën e pasme të kapelës. Ajo duhet të përbëhet nga 2 shtresa me përmasa të barabarta: shtresa e jashtme prej tekstili blu të errët dhe shtresa plastike prej polietileni me lartësi 50 mm dhe trashësi 1 mm. Shtresa plastike duhet të ketë përkulshmëri të lartë në mënyrë që të ruajë formën gjatë përdorimit.

Fasha rrethore duhet të jetë e veshur me astar methurje garniturë dhe përmbajtje 100% pambuk.

Shirit prej lëkure. Tek buza e poshtme e fashës rrethore të kapelës duhet të qepet një shirit perimetral prej lëkure që shërben për mbrojtjen e kapelës nga djersët. Buza e sipërme e shiritit duhet të jetë e lirë.

Shiriti duhet të jetë prej lëkure gjedhi me ngjyrë të zezë dhe me vrima për ajrosje.

Midis fashës rrethore dhe shiritit perimetral prej lëkure duhet të qepet një fije plastike përforcuese perimetrale me trashësi 0.5 mm që ndihmon ruajtjen e formës së kapelës.

Streha e kapelës duhet të bashkohet me fashën e kapelës me anë të tegelit qepës. Ajo duhet përbëhet nga dy shtresa me përmasa të barabarta: pjesa e sipërme prej polivinil kloruri me ngjyrë të zezë me shkëlqim, me trashësi rreth 0.5 mm dhe pjesa e poshtme prej polivinil kloruri me ngjyrë të gjelbër pa shkëlqim dhe me relief që imiton pamjen e lëkurës, me trashësi 1.5 mm.

Dy shtresat e strehës duhet të ngjiten në mënyrë uniforme.

Streha duhet të jetë e profiluar me një shirit polivinil kloruri me trashësi rreth 0.2 mm me ngjyrë të zezë me shkëlqim.

Shënim: Kapelet për gradat Drejtues i Lartë dhe Drejtues Madhor, duhet të jenë me elementë dekorues në pjesën mbi strehë.

ELEMENTËT DEKORATIVË

Shiriti dekorativ prej tekstili duhet të jetë ngjyrë blu shumë e errët (pothuajse në të zezë) me gjerësi 3 cm. Sipërfaqja e shiritit duhet të jetë e vijëzuar (me kurrize).

Shiriti duhet të qepet në pjesën e pasme të kapelës.

Filetot e kuqe cilindrike dekorative duhet të kenë trashësi 3 mm. Ato duhet të jenë prej materiali 100% viskoz.

Filetot duhet të përshkojnë tegelin e sipërm dhe të poshtëm të kurores së kapelës.

ELEMENTËT DEKORATIVË TË LËVIZSHËM

Kopsat metalike. Në të majtë dhe në të djathtë të fashës rrethore, në pjesën poshtme të saj, duhet të montohen dy kopsa metalike me diametër 15 mm që shërbejnë për fiksimin e rripit të zi dekorativ.

Kopsat duhet të kenë formë konvekse me bordurë anësore dhe në sipërfaqe duhet të kenë të skalitur *Përkrenaren e Skënderbeut*.

Montimi i kopsave duhet të bëhet me karficë metalike për kopsat.



Stema duhet të jetë prej tunxhi me ngjyrë të artë me përmasa 6 x 5 cm. Sipërfaqja e saj duhet të jetë me relief sipas pamjes zyrtare.

Ajo duhet të montohet në ballë të kapelës dhe të fiksohet tek kapela me dy këmbëza me filetim. Këmbëzat duhet të jenë të mjaftueshëm të gjata që të montohen me lehtësi. Montimi i stemës nuk duhet të krijojë tendosje të tekstilit dhe astarit.

Rrip i zi dekorativ duhet të jetë i përbërë nga dy rripa me gjatësi të njëjtë. Secili rrip duhet të jetë i përbërë nga dy shtresa plastike me ngjyrë të zezë me shkëlqim.

Rripi duhet të jetë në total 25 cm i gjatë dhe 1.4 cm i lartë. Çdo komponent i rripit duhet të jetë rreth 1 mm i trashë.


Rripi duhet fiksohet tek kapela me anë të kopsave metalike anësore. Ai duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të mbështetet tek streha e kapelës.

Rripi duhet të pajiset me mekanizëm për shtrëngim dhe lirim që të përshtatet me masën e kapelës.



II. KAPELA E UNIFORMËS PËR FEMRA





Kapela do të porositet dhe do të prodhohet në masat 50 – 60 dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të *Policisë së Shtetit*.

Pjesët përbërëse të kapelës:

1. Tavani i kapelës (pjesa e sipërme e kapelës)
2. Kurora
3. Streha
4. Brendia
5. Shiriti dekorativ prej tekstili me kotur të kuq
6. Fileto cilindrike dekorative
7. Kopsat metalike anësore
8. Stema
9. Rripi i zi dekorativ
10. Llastiku

Përmasat e masës 51	
Lartësia e kurorës	8 cm
Perimetri i kokës	54 cm
Perimetri i tavanit	47 cm
Gjatësia e strehës përpara	7 cm
Gjatësia e strehës prapa	5.5 cm
Gjatësia e strehës anash	7 cm
Perimetri i strehës (e hapur)	80 cm

Tavani i kapelës duhet të ketë formë ovale. Ajo duhet të përbëhet nga një shtresë tekstili ngjyrë blu të errët (si xhaketa) dhe një shtresë tekstili pambuku të kollarisur për t'i dhënë formë kapelës.

Kurora e kapelës duhet të përbëhet nga një shtresë tekstili ngjyrë blu të errët (si xhaketa) dhe një shtresë tekstili pambuku të kollarisur për t'i dhënë formë kapelës.

Kurora duhet të qepet në pjesën e pasme të kokës.

Lartësia e kurorës duhet të ndryshojë në varësi të masës së kapelës.

Astari i brendshëm i kapelës duhet të jetë i bardhë me material 100% pambuk. Ai duhet të veshë të gjithë brendinë e kapelës.




Foto për referencë e tekstit të pambukut të kollarisur

Streha e kapelës duhet përbëhet nga dy shtresa tekstili ngjyrë blu të errët (si xhaketa) me përmasa të barabarta të përforcuara secila me nga një shtresë tekstili pambuku të kollarisur për t'i dhënë formë strehës.

Shtresat e strehës duhet të bashkohen me njëra-tjetrën me anë të 9 tegelave lineare një gjilpërësh sipërfaqësorë në largësi çdo 5 mm.

Pjesët anësore të strehës duhet të qëndrojnë të palosura dhe të fiksuara në anë të kurorës.

Në të majtë dhe në të djathtë kurorës vendoset nga një kopsë metalike.

Shirit prej lëkure. Tek buza e poshtme e fashës rrethore të kapelës duhet të qepet një shirit perimetral prej lëkure që shërben për mbrojtjen e kapelës nga djersët. Buza e sipërme e shiritit duhet të jetë e lirë. Shiriti duhet të jetë prej lëkure gjedhi me ngjyrë të zezë dhe me vrima për ajrosje.

Midis fashës rrethore dhe shiritit perimetral prej lëkure duhet të qepet një fije plastike përforcuese perimetrale me trashësi 0.5 mm që ndihmon ruajtjen e formës së kapelës.

Etiketa me emrin e fabrikës duhet të qepet tek astari i tavanit.

ELEMENTËT DEKORATIVË

Llastiku i zi me përmasa 1 cm gjerësi dhe gjatësi 35 cm duhet të qepet në të dyja anët e kapelës ndërmjet shiritit prej lëkure dhe kurorës.

Shiriti dekorativ duhet të jetë ngjyrë blu shumë e errët (pothuajse në të zezë) dhe i konturuar me shirita të kuq në buzë. Sipërfaqja e fashës duhet të jetë e vijëzuar (me kurrije).

Shiriti duhet të jetë i lartë 3 cm ndërsa konturet e kuqe duhet të kenë trashësi ± 3 mm.

Shiriti duhet të bashkohet me kapelën me anë të tegelit qepës përgjatë bordurës së poshtme të shiritit.

Në anën e pasme duhet të modelohet një shirit tjetër si fjongo për efekt dekorativ. *Shiko më sipër modelin e kapelës.*

Filetoja cilindrike dekorative duhet të qepet atje ku bashkohet kurora me kupolën e kapelës. Ajo duhet të ketë të njëjtën ngjyrë me vijat e kuqe tek shiriti dekorativ. Filetoja duhet të jetë prej materiali 100% viskoz.

ELEMENTËT DEKORATIVE TË LËVIZSHËM

Kopsat metalike. Në të majtë dhe në të djathtë të fashës rrethore, në pjesën poshtme të saj, duhet të montohen dy kopsa metalike me diametër 15 mm. Kopsat duhet të kenë formë kupe me bordurë anësore. Montimi i kopsave duhet të bëhet me karficë metalike për kopsat. Kopsat duhet të kenë *Përkrenaren e Skënderbeut* të gdhendur në sipërfaqe. Kopsat shërbejnë për fiksimin e rripit të zi dekorativ.



Stema duhet të jetë prej tunxhi me ngjyrë të artë me përmasa 6 x 5 cm. Sipërfaqja e saj duhet të jetë me relief sipas pamjes zyrtare.

Ajo duhet të montohet në ballë të kapelës dhe të fiksohet tek kapela me dy këmbëza me filetimit. Këmbëzat duhet të jenë të mjaftueshëm të gjata që të montohen me lehtësi. Montimi i stemës nuk duhet të krijojë tendosje të tekstilit dhe astarit.

Rrip i zi dekorativ duhet të jetë i përbërë nga dy rripa me gjatësi të njëjtë. Secili rrip duhet të jetë i përbërë nga dy shtresa plastike me ngjyrë të zezë me shkëlqim.

Rripin duhet të jetë në total 25 cm i gjatë dhe 14 mm i lartë. Çdo komponent i rripit duhet të jetë rreth 1 mm i trashë.

Rripin duhet fiksohet tek kapela me anë të kopsave metalike anësore. Ai duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të mbështetet tek streha e kapelës.

Rripin duhet të pajiset me mekanizëm për shtërngim dhe lirim që të përshtatet me masën e kapelës.



6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së kapeles duhet të jenë me hap 6 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitetet.
- Të gjithë elementët e kapeles duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë

specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.

- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Kapela duhet të jetë e lehtë për tu mirëmbajtur.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e kapeleve është $\pm 2\%$. Tek qepja e strehës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Montimi i kopsave në kapele duhet të bëhet rreptësisht sipas përshkrimit tek *Specifikimet Teknike*.
- Kopsat duhet të kenë pamje të rregullta. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash, kopsat nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishten ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Kopsa nuk duhet të lenë shenja tek materialet me të cilat do të bien në kontakt.
- Kopsat duhet të jenë 100% prej materialit të përcaktuar në këtë dokument.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Kapela duhet të pajiset me një etiketë prej tekstili, tek e cila duhet të shkruhet emri i fabrikës, viti i prodhimit, masa, përbërja, dhe instruksionet e mirëmbajtjes. Etiketa duhet të qepet në brendësi tek astari i kapeles.

Në momentin e dorëzimit kapelat duhet të jenë të pastra, pa njolla dhe të rregullta. Ato duhet të paketohen në qese polietileni.

Kapela duhet të paketohet në një qese më vete dhe më pas të vendosen në kuti. Secila kuti duhet të ketë të njëjtën masë të kapeleve dhe të së njëjtës gjini.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e kapeles, gjinia, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).

ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016

	Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/ m ²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi.
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT
Kostumi i shërbimit civil për femra

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *kostumi i shërbimit civil për femra* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349		
Përbërja % (± 5%)	62 % poliestër	35 % viskozë	3 % elastan
Thurja	diagonale 2/2 (sarzh)		
Masa gr/m ² (± 5%)	250 gr/m ²		
Qëndrueshmëria e ngjyrës	Nota 4-5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fije.	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle		
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4 – 5		
Azo Ngjyruet	Nuk duhet të jenë të pranishëm		
pH	4.0 - 9.0		

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se – nota 6: shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu të errët do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu e errët nuk njollos tekstilin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

XHAKETA

b. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *xhaketa e kostumit të shërbimit civil për femra*.

Astar			
Astar i brendshëm	Përbërja	100% poliester	
	Ngjyra	njësoj si xhaketa	
	Thurje	diagonale	
	Pesha	86 gr/m2 ± 5%	
Përforcues			
Përforcues me ngjyrë antracite për paramonturën/jakën dhe gjoksin.			
Shtresë prej frazeline termoadezive me ngjyrë të zezë për jakën.			
Shtresë prej frazeline termoadeziv me ngjyrë të zezë për filetot e xhepave.			
Aksesorë të tjerë			
Element <i>Velcro</i> femër për stemës së Policisë së Shtetit që do të vendosen në gjoksin e majtë të xhaketës.	Përmasat e <i>Velcro</i> të gjoksit	70 mm x 80 mm	
	Përbërja	100% fibra poliamide	
	Trashësia	2.2 mm	
	Masa lineare	41 g/m ± 5%	
	Ngjyra	njësoj si xhaketa	
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë	- 30 °C	
	E nxehtë	pika e dobësimit	180 °C
		pika e shkrirjes	210 – 250 °C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
	Në larje	jo më pak se 3	
	Në ujë të nxehtë		
	Në djersë		
	Në fërkim		
Vatina prej materiali 100% poliamid			
Filli			
Fill qepës për të gjitha qepjet (përfshi vrimat dhe travetat).	Përbërja	100% poliester	
	Numri metrik	80 Nm	
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N	
	Ngjyra	njësoj si xhaketa	
Kopsat Plastike			
	1 copë d 25 mm + 1 rezervë		
	4 copë d 15 mm + 1 rezervë		
	Ngjyra e kopsës	njësoj si xhaketa	
	Materiali	100% poliester	
	Qepja e kopsës	kryq	

Etiketa		
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës masës, përmbajtjes dhe instruksioneve të mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë

FUNDI

d. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesoreve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit fundi i kostumit të shërbimit civil për femra.

Astar		
Astar i brendshëm.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	blu e errët
	Thurje	diagonale
	Pesha	86 gr/m ² ± 5%.
Përforcues		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me vrima me gjerësi rreth 6 cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive e hollë për ylyqet.		
Aksesorë të tjerë		
1 zinxhir me dhëmbëza plastikë me ngjyrë blu të errët me të njëjtin tonalitë si tekstili.	Gjatësia	16–18 cm
	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	njësoj si fundi
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës prodhuese dhe instruksionet e mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliestër
	Ngjyra	e bardhë
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet (përfshi vrimat dhe travetat).	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	njësoj si tekstili
Kopsa plastike		
	1 copë Nr. 34 (d 21mm) + 1 rezervë.	
	Ngjyra e kopsës	blu e errët
	Materiali	100% poliestër
	Qepja e kopsës	kryq


SHALLI

e. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesoreve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit shalli i kostumit të shërbimit civil për femra.

Tekstili		
Tekstil tezgjahu për shall	Përbërja	100% viskozë
	Pesha	86 gr/m ² ± 3%.
	Thurje	diagonale

		Me pak shkëlqim.
		Stampë e njëjtë nga të dy anët.
Filli		
Fill qepës Kujdes! Filli duhet të jetë i përshtatshëm për qepjen e tekstilit të shallit	Përbërja	100% poliestër
	Numri metrik	120 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	blu e errët

f. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesoreve që nevojiten për paketimin e artikullit kostumit të shërbimit civil për femra. Fotografitë e mëposhtme shërbejnë vetëm si shembull ilustrues.

	
1 copë kremastar për xhaketën	1 copë kremastar për fundin
	
1 qese polietileni për paketimin e shallit	1 çantë pambuku për kostumin
1 kuti kartoni për paketimin e 10 kostumeve	

Të gjithë mjetet dhe aksesoret mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli kostumi i shërbimit civil për femra do të porositet dhe do të prodhohet në masat 36–54 dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



1	Perimetri i kokës	cm.
2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i kraharorit (poshtë gjoksit)	cm.
5	Perimetri i belit	cm.
6	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
7	Perimetri në pjesën e vitheve	cm.
8	Lartësia nga supi në gjoks	cm.
9	Distanca mes gjokseve	cm.
10	Perimetri i krahut	cm.
11	Perimetri i kyçit të dorës	cm.
12	Lartësia përpara nga supi në vijën e belit	cm.
13	Lartësia nga vija e belit në vijën e kockës abdominale	cm.
14	Lartësia e pjesës abdominale (nga vija e belit në vijën e vitheve)	cm.
15	Gjatësia nga beli në vijën e gjurit (poshtë kupës së gjurit)	cm.
16	Gjatësia nga beli në kockën e kavaljes	cm.
17	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
18	Lartësi e përgjithshme e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në tokë)	cm.
19	Gjatësia e supit	cm.
20	Gjatësia nga supi në bërryl	cm.
21	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës.	cm.
22	Gjatësia e shtratit e matur ulur.	cm.
23	Gjatësia e brendshme këmbës deri në vijën e gjurit.	cm.
24	Gjatësia e brendshme këmbës deri në kavalje	cm.
25	Gjatësia e personit	cm.

3. NGJYRAT REFERENCË


Ngjyra blu spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349 për të gjitha pjesët e kostumit dhe astarit.

Ngjyrat e paraqitura në këtë dokument shërbejnë si referencë për prodhuesin. Aprovimi i tyre do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.



Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

Ngjyrat e shallit:

			
spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349	spektri sipas CIELCH 41, 70.780 28.754	spektri sipas CIELCH 96, 2.573 117.861	spektri sipas CIELCH 97, 40,631 17.986

4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit kostumi i shërbimit civil për femra.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 80 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Kollaritja


Ngjitja e materialit tekstil kollaritës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 130–140 °C, me kohëzgjatje 8–10 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet kollaritja me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I KOSTUMIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të kostumit të shërbimit civil për femra.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.


I. XHAKETA



Khaketa për femra është e njëjtë në tekstil dhe ngjyrë me atë të meshkujve, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra dhe kopsave, të cilat duhet të jenë në anën e majtë.

Pjesët përbërëse të xhaketës:

- Pjesa e përparme (me dy pjesë)
- Dy xhepa fileto të poshtëm
- Dy paramontura
- Dy fianket e përparme
- Dy fianket e pasme
- Jaka e poshtme dhe e sipërme
- Pjesa e pasme (me dy pjesë)
- Dy mëngë
- Astari i brendshëm



PJESA E PËRPARME E XHAKETËS

Pjesët e përparme. (1) Buzët e pjesës së përparme duhet të përshkohen vertikalisht nga një tegel zbukurues sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 1mm nga buza. Tegeli duhet të fillojë në cepin e poshtëm dhe duhet të përfundojë në afërsi të jakës.

Për përforcimin e strukturës së xhaketës duhet të përdoret frazelinë termo adesive. Frazelina duhet të vendoset në të gjithë sipërfaqen e copës. Shtresa përforcuese duhet të jetë e fshehur mes astarit dhe tekstit të xhaketës.

Jaka e poshtme duhet të jetë standarde me kulme. Duhet pasur kujdes që gjatë palosjes së jakës mos të shfaqen defekte.

Kopsa. Xhaketa duhet të jetë e pajisur me një kopsë plastike me diametër 25 mm.

Kopsa duhet të qepet në anën e majtë të xhaketës. Vendosja e kopsës të madhe në xhakete duhet të bëhet sipas ilustrimit të mësipërm.

Vrima e kopsës duhet të hapet në pjesën e djathtë (të veshur) të xhaketës me drejtim horizontal.

Gjatësia e vrimës së kopsës duhet të jetë 30 mm, distanca e vrimës nga buza e xhaketës duhet të jetë 15mm.

Fundi i xhaketës (3) duhet të përfundojë me një palosje 3 cm të përforcuar me frazeline adezive me lartësi 4 cm. Palosja duhet të jetë nga brenda. Në fillim vendoset frazelina adesive pastaj bëhet palosja.

Vatat duhet të përbëhen nga një shtresë vatin e përforcuar në të dy anët me tekstil adeziv me thurje garniturë (1:1).

Vatat duhet të kenë formë ovale nga njëra anë dhe të drejtë nga ana tjetër.

Ajo duhet të qepet në brendësi të xhaketës, tek linja e supeve. Brinja e drejtë duhet të qepet tek tegeli i gavaturës ndërsa brinja rrethore duhet të jetë e lirë.

Vatina duhet të jenë prej materiali 100% poliamid.

JAKA E SIPËRME (4)

Jaka duhet të përbëhet nga dy shtresa tekstili me ngjyrë blu të errët të përforcuara me frazelinë termoadezive mes tyre.

Dy shtresat e tekstit duhet të bashkohen me njëra-tjetrën nëpërmjet një tegeli linear një gjilpërësh me distancë 1 mm nga buza e jakës.

Thellësia e jakës tek kulmet duhet të jetë rreth 7 cm. Kjo përmasë duhet të ndryshojë proporcionalisht me masën e xhaketës.

Jaka e sipërme, gjuhëza dhe trupi i xhaketës duhet të bashkohet me anë të tegelave linearë një gjilpërësh me distancë rreth 1 mm nga buzët.

PARAMONTURAT

Të dy pjesët e përparme të xhaketës duhet të pajisen me paramontura me drejtim vertikal. Ato duhet të jenë dy pjesë tekstili të prera me formën e buzës së xhaketës dhe duhet të qepen nga brenda.

Paramonturat duhet të jenë të përforcuara me frazelinë termoadezive për paramonturë. Shtresa përforcuese prej frazeline termoadezive duhet të bashkohet me shtresën e paramonturës në tranxhë me avull të nxehtë.

PJESA E PASME E XHAKETËS (5)

Pjesa e pasme e xhaketës duhet të përbëhet nga dy pjesë.

Çarja e pasme e xhakëtës duhet të ketë lartësi rreth 14 cm dhe thellësi 3.5 cm. Ana e majtë duhet të jetë mbi anën e djathtë.

Çarja duhet të jetë e përforcuar me shtresë frazelinë dhe në pjesën e sipërme çarja duhet të jetë e kufizuar me anë të tegelit qepës në drejtim transversal.

Fundi i xhakëtës duhet të përfundojë me një palosje 3 cm të përforcuar me frazelinë termoadezive me lartësi 4 cm. Palosja duhet të jetë nga brenda. Në fillim vendoset frazelina pastaj bëhet palosja.

FIANKET (2)

Xhaketa nuk ka penca por ajo modelohet sipas formës së trupit me anë të fiankeve të përparme dhe fiankeve të pasme.

ASTARI


Trupi i xhakëtës, mëngët dhe xhepat duhet të jenë të veshur nga brenda me astar të brendshëm. Astari duhet të ndahet në gjashtë pjesë kryesore (katër pjesë përpara dhe dy pjesë mbrapa) të bashkuara ndërmjet tyre me anë të tegelit qepës një gjilpërësh. Në linjën fundore të xhakëtës astari përfundon me një shtesë rreth 1,5 cm.

XHEPAT (6)

Xhaketa duhet të pajiset me dy xhepa me konstruksion të brendshëm dhe fileto të dyfishtë, një xhep në të majtë dhe një në të djathtë.

Përmasat e xhepit duhet të jenë 15 x 1.2 cm.


Filetot duhet të jenë nga 6 mm të larta dhe të përforcuara me frazelinë të lehtë termoadesive.



Astari i xhepit duhet të qepet me tekstil me përbërje 100% poliestër.

Xhepat duhet të qepen sipas ilustrimit të mësipërm të xhakëtës. Buzët e sipërme të xhepave duhet të jenë në linjën e belit dhe të kopsës. Xhepat nuk duhet të kenë asnjë tegel qepës të dukshëm

MËNGËT (7)




Mëngët duhet të përbëhen nga dy pjesë: mënga e sipërme dhe mënga e poshtme. Dy pjesët duhet të qepen me njëra-tjetrën me tegel linear një gjilpërësh.

Mëngët duhet të përfundojnë me çarjen e kopsave, me lartësi 6 cm dhe thellësi rreth 4 cm. Buza e sipërme duhet të mbivendoset mbi të poshtmen.


Mbyllja e çarjes duhet të bëhet me anë të dy kopsave plastike me diametër 15 mm. Për secilën kopsë të duhet hapur përkatësisht nga një vrimë me gjatësi 20 mm.

VELCRO

Khaketa duhet të ketë në përbërjen e saj një element *Velcro* femër me formën e stemës së policisë, të qepur në anën e majtë të gjoksit, me përmasa 70 x 80 mm.



II. FUNDI I KOSTUMIT TË SHËRBIMIT CIVIL PËR FEMRA



Konstruksioni i fundit për femra duhet të jetë sipas modelit klasik me gjatësi deri poshtë kupës së gjurit. *Shiko linjat për referencë te figura e marrjes së masave.*

Pjesët përbërëse të fundit:

- Qemeri
- Pjesa e përparme
- Pjesa e pasme (me dy pjesë)

QEMERI (1)

Lartësia e qemerit duhet të jetë 3.5 cm.

Qemeri duhet të jetë i përbërë nga dy shtresa tekstili të njëjta (brenda dhe jashtë) dhe një shtresë tekstili termoadeziv. Renditja e shtresave të qemerit duhet të bëhet si më poshtë:

1. Shtresa e jashtme (ballore) prej materiali të njëjtë me fundin.
2. Shtresa e dytë e brendshme me lartësi rreth 6 cm prej tekstili termoadeziv.
3. Shtresa e jashtme (e brendshme e fundit) prej materiali të njëjtë me fundin.

Qemeri duhet të bashkohet me fundin me tegel të padukshëm.


Qemeri duhet të ketë një shtesë prej 3 cm (nga vijat e zinxhirit) në njërën anë. Shtesat duhet të përfundojnë me formë drejtkëndore. Tek shtesa duhet të hapet vrima e kopsës me gjatësi 25 mm ndërsa në ekstremitetin tejtr të qemerit duhet të qepet kopsa.

Kopsat duhet të jenë Nr. 34 (21 mm) me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsës duhet të bëhet kryq.

Ylyqet.(2) Fundi duhet të kenë gjithsej 4 ylyqe me gjatësi 5 cm dhe gjerësi 1 cm. Dy përpara dhe dy mbrapa. 2 ylyqet përpara dhe 2 ylyqet mbrapa duhet të vendosen ngjitur me pencat, nga ana e brendshme. Shiko ilustrimin më poshtë.

Ylyqet duhet të jenë të përbërë nga dy shtresa tekstili ngjyrë blu (si fundi) dhe një shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive.

Ato duhet gjithashtu të përforcohen në të dy skajet me traveta ngjyrë blu të errët.



PJESA E PËRPARME

Pencat (3): Fundit duhet t'i vendosen përpara dy penca me gjatësi 7 cm.

PJESA E PASME

Pencat. (4) Fundit duhet t'i vendosen prapa dy penca me gjatësi 9 cm.

Zinxhiri (5) duhet qepet në aksin qendror, mbrapa. Gjatësia e tij do të ndryshojë sipas masave nga 16–18 cm.

Zinxhiri duhet të jetë me fiksion e të mos hapet gjatë përdorimit të fundit.
Zinxhiri duhet të mbulohet nga tekstili i dy pjesëve të pasme.

E çara e fundit (6) duhet të jetë në fund të linjës së prerjes dhe të ketë lartësi 15 cm.

Në brendësi duhet të ketë një palë të brendshme me gjerësi 5.5 cm.

Pala duhet ta ketë palosjen: pjesa e djathtë mbi të majtën.

Astari duhet të ndërtohet me tre pjesë (një para dhe dy mbrapa) dhe të ketë të njëjtën prerje si fundi. Ai duhet të qepet tek buza e poshtme e qemerit.

Njësoj si tek fundi, edhe tek astari duhet të qepen dy penca përpara dhe dy penca mbrapa.

Në linjën fundore të tij astari duhet të jetë i kthyer dy herë dhe i qepur me tegel qepës linear.

Astari duhet të ndërtohet me tekstil, përbërja e të cilit duhet të jetë 100% poliester.

IV. SHALLI I KOSTUMIT TË SHËRBIMIT CIVIL PËR FEMRA

Tekstili i shallit duhet të jetë methurje saten, me pak shkëlqim dhe dizeno të njëjtë në të dy anët.

Shalli duhet të jetë prej materiali 100% viscose.

Përmasat e shallit duhet të jenë: 140 x 20 cm

Shalli duhet të ketë buzët e qepura me dorë ose me makinë qepëse për realizimin e tegelit të fshehtë tubolar.




6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së kostumit duhet të jenë me hap 6 shpime në 1 cm.

- Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
- Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
- Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e kostumit duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili i kostumit duhet të ruajë hekurosjen për një kohë të gjatë.
- Kostumi duhet të jetë i lehtë për tu mirëmbajtur.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e kostumeve është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Kopsat duhet të kenë pamje të rregullta. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash, kopsat nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishen ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesoret e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyruës. Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
 - a. EN ISO 14362-1:2017
 - b. EN ISO 14362-3:2017
 - c. EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI



Të gjithë artikujt e kostumit të shërbimit civil për femra duhet të pajisen me etiketa prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes.

Kjo etiketë duhet të qepet në brendësi të xhaketës, tek astari, në anën e majtë, rreth 20 cm nga fundi i xhaketës. Po në këtë etiketë duhet të vendosen edhe kopsat rezervë. Tek fundi duhet të qepet një etiketë në qendër të qemerit, mbrapa (në brendësi).

Në etiketë duhet të qepet dhe 1 kopsë rezervë plastike blu për fundin.

Në momentin e dorëzimit kostumet duhet të jenë të pastër, të hekurosur, pa njolla dhe të varur në kremastarë (varëse) të fortë plastikë.

Për kostumin nevojiten 1 kremastar për xhaketën dhe 1 kremastar me kapse për fundin. Kremastari për xhaketën duhet të jetë i përshtatshëm për të ruajtur formën e supeve dhe të jetë të pajisur me bosht transversal të veshur me "push".

Xhaketa dhe fundi duhet të futen bashkë në një çantë mbrojtëse prej pambuku, me mbyllje me zinxhir në pjesën qendrore dhe me etiketë transparente për vendosjen e emrit të punonjës.

Artikujt duhet të paktohen me nga 10 kostume për kuti.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e kostumit, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjites (natriban).



ANEKS - Lista e testimeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testimeve

Analizat	Metodat e testimeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/ m²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle te larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

TË DHËNAT TEKNIKE PËR PRODHIMIN E ARTIKULLIT

Kostumi i shërbimit civil për meshkuj

1. MATERIALET

a. Materiali bazë që duhet të përdoret për prodhimin e artikullit *kostumi i shërbimit civil për meshkuj* duhet të jetë i cilësisë së parë, me këto të dhëna teknike:

Ngjyra	Blu e errët (evening blue) Spektri sipas CIELCH 18, 14.587, 295.349		
Përbërja % (± 5%)	62 % poliestër	35 % viscose	3 % elasthan
Thurja	diagonale 2/2 (sarzh)		
Masa gr/m² (± 5%)	250 gr/m²		
Qëndrueshmëria e ngjyrës	Nota 4-5 (Shkalla gri)	Ngjyrosja duhet të jetë në fije.	
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	Nota ≥ 6 (Shkalla Blu)	Tekstili duhet të ketë qëndrueshmëri të lartë.	
Qëndrueshmëria në fërkim	mbi 15000 cikle		
Efekti pilling (kokërrzimi)	nota 4 – 5		
Azo Ngjyrues	Nuk duhet të jenë të pranishëm		
pH	4.0 - 9.0		

Shënim: Lexo aneksin në fund të dokumentit për t'u njohur me metodat e testimeve dhe listën e plotë të analizave që duhet të shoqërojnë artikullin.

Ngjyra e tekstilit të produktit përfundimtar duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kampionit të tekstilit që shoqëron *ofertën teknike* të depozituar nga subjekti pjesëmarrës në konkurrim. Ajo duhet t'i nënshtrohet provës së rezistencës ndaj fërkimit në të thatë, në të njomë, larjes me solucion sapuni, djersës dhe dritës (rrezatimit UV). Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës së tekstilit duhet të jetë: *e qëndrueshme – nota 4 dhe shumë e qëndrueshme – nota 5*. Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrës ndaj dritës duhet të jetë: *jo më pak se – nota 6: shumë e mirë*.

Si provë për qëndrueshmërinë e ngjyrës, mbi kampionin e paraqitur në *ofertën teknike* do të kryhet kjo provë fizike: kampioni i tekstilit me ngjyrë blu të errët do të fërkohet për një kohë të caktuar me një cohë tjetër të bardhë. Rezultati quhet pozitiv kur ngjyra blu e errët nuk njollos tekstilin e bardhë.

Grupi i kontrollit të cilësisë nuk do të aprovojë përdorimin e tekstileve apo materialeve të tjera, në të cilat do të jenë të pranishme këto defekte (kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse):

- elementë *Velcro* që konsumohen shpejt gjatë përdorimit,
- papastërtitë me origjinë bimore,
- njolla vaji ose boje,
- tonalitete të ngjyrës,
- oksidime,
- rrudhosje,
- mungesë të fijeve të indit dhe të bazës,
- trashim të fijeve të indit dhe të bazës,
- vrima në sipërfaqe,
- dhe çdo parregullsi tjetër që cenon anën funksionale dhe estetike të uniformës.

XHAKETA

b. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit *xhaketa e kostumit të shërbimit civil për meshkuj*.

Astar			
Astar i brendshëm	Përbërja	100% poliester	
	Ngjyra	njësoj si xhaketa	
	Thurje	diagonale	
	Pesha	86 gr/m2 ± 5%	
Përforcues			
Përforcues me ngjyrë antracite për paramonturën/jakën dhe gjoksin.			
Shtresë prej frazeline termoadezive me ngjyrë të zezë për jakën.			
Shtresë prej frazeline termoadeziv me ngjyrë të zezë për filetot dhe kapakët e xhepave.			
Aksesorë të tjerë			
Element <i>Velcro</i> femër për stemës së Policisë së Shtetit që do të vendosen në gjoksin e majtë të xhaketës.	Përmasat <i>Velcro</i> të stemës	70 mm x 80 mm	
	Përbërja	100% fibra poliamide	
	Trashësia	2.2 mm	
	Masa lineare	41 g/m ± 5%	
	Ngjyra	njësoj si xhaketa	
	Qëndrueshmëria në temperatura ekstreme		
	E ftohtë	- 30 °C	
	E nxehtë	pika e dobësimit	180 °C
		pika e shkrirjes	210—250 °C
	Qëndrueshmëria e ngjyrës		
	Në larje	jo më pak se 3	
	Në ujë të nxehtë		
	Në djersë		
	Në fërkim		
Vatina prej materiali 100% poliamid			
Filli			
Fill qepës për të gjitha qepjet (përfshi vrimat dhe travetat).	Përbërja	100% poliester	
	Numri metrik	80 Nm	
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N	
	Ngjyra	njësoj si xhaketa	
Kopsat Plastike			
	2 copë d 25 mm + 1 rezervë		
	6 copë d 15 mm + 1 rezervë		
	Ngjyra e kopsës	njësoj si xhaketa	
	Materiali	100% poliester	
	Qepja e kopsës	kryq	

Etiketa		
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës masës, përmbajtjes dhe instruksioneve të mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliester
	Ngjyra	e bardhë

PANTALLONAT

c. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit pantallonat e kostumit të shërbimit civil për meshkuj:

Astar		
Tekstil <i>Silesia</i> prej pambuku për qemerin, profilimin e sallkisë dhe xhepave.	Përbërja	100% pambuk
	Thurja	diagonale me vija
	Ngjyra	e zezë
Përforcues		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me vrima me gjerësi rreth 6 cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive me lartësi rreth 3.5cm për qemerin.		
Shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive e hollë për ulyqet dhe filetot e xhepave.		
Aksesorë të tjerë		
1 zinxhir me dhëmbëza plastike	Gjatësia	16–18 cm
	Përbërja	100% poliester
	Ngjyra	njësoj si pantallonat
1 kapse metalike femër-mashkull për qemerin e pantallonave.		
Etiketat prej tekstili për identifikimin e fabrikës masës, përmbajtjes dhe instruksioneve të mirëmbajtjes.	Përbërja	100% poliester
	Ngjyra	e bardhë
Filli		
Fill qepës për të gjitha qepjet (përfshi vrimat dhe travetat).	Përbërja	100% poliester
	Numri metrik	80 Nm
	Qëndrueshmëria në tërheqje	jo më pak se 12N
	Ngjyra	njësoj si pantallonat
Kopsa plastike		
	1 copë d 21mm dhe 2 copë d 15 mm + 1 rezervë	
	Ngjyra e kopsës	blu e errët
	Materiali	100% poliester
	Qepja e kopsës	kryq

d. Lista e materialeve ndihmëse dhe aksesorëve që duhet të përdoren për ndërtimin e artikullit kostumi i shërbimit civil për meshkuj.

Fotografitë e mëposhtme shërbejnë vetëm si shembull ilustrues.

	
1 copë kremastar për xhaketën dhe pantallonat	1 çantë pambuku për paketimin e kostumit
1 kuti kartoni për paketimin e 10 kostumeve	

Të gjithë mjetet dhe aksesorët mund të zëvendësohen me produkte të ngjashme ose të përmirësuara.


Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik nëpërmjet një kërkesë zyrtare.

2. MASAT DHE SASIA E PRODHIMIT

Artikulli kostumi i shërbimit civil për meshkuj do të porositet dhe do të prodhohet në masat 44 – 66 dhe në sasi të që do të rezultojnë pas matjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Marrja e masave trupore

Marrja e masave trupore të mëposhtme është e nevojshme për nxjerrjen e përmasave të këtij artikulli:



1	Perimetri i kokës	cm.
2	Perimetri i qafës	cm.
3	Perimetri i gjoksit	cm.
4	Perimetri i belit	cm.
5	Perimetri në pjesën e barkut	cm.
6	Perimetri i muskulit të krahut	cm.
7	Perimetri i kyçit të dorës	cm.
8	Perimetri i gjurit poshtë kupës së tij	cm.
9	Perimetri i kyçit të këmbës (kavilies)	cm.
10	Gjatësia e personit	cm.
11	Lartësi e përgjithshme e trupit mbrapa (nga supi në tokë)	cm.
12	Lartësia e trupit mbrapa (nga kocka cervikale në vijën e belit)	cm.
13	Gjatësia e mes -shpatullave	cm.
14	Gjatësia nga supi në bërryl	cm.
15	Gjatësia e krahut, nga supi në kyçin e dorës.	cm.
16	Lartësia e pjesës nga vija e supit në vijën e belit	cm.
17	Gjatësia nga beli në vijën e gjurit (poshtë kupës së gjurit)	cm.
18	Gjatësia nga beli në kockën e kavilies	cm.
19	Gjatësia e brendshme këmbës deri në vijën e gjurit	cm.
20	Gjatësia e brendshme këmbës deri në kavilie	cm.
21	Gjatësia e shtratit e matur ulur	cm.

3. NGJYRA REFERENCË

Ngjyra blu spektri sipas CIECLCH 18, 14.587, 295.349 për të gjitha pjesët e kostumit dhe elementëve të saj.

Ngjyra e paraqitur në këtë dokument shërben si referencë për prodhuesin. Aprovimi i saj do të kryhet në momentin e dorëzimit të kampioneve.

Kujdes! Çdo zëvendësim, përshtatje apo ndryshim duhet të bëhet me miratimin paraprak të grupit të punës së specialistëve teknik, nëpërmjet një kërkesë zyrtare.



4. PËRPUNIMI DHE PËRGATITJA E MATERIALEVE BAZË

Përgatitja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse në mënyrë të saktë dhe të drejtë është bazë për një ecuri cilësore të proceseve teknologjike të mëtejshme gjatë prodhimit me cilësi të artikullit *kostumi i shërbimit civil për meshkuj*.

Modelimi (ndërtimi i kallëpeve)

Ky proces duhet të realizohet me metoda matematikore të ndërtimit të kallëpeve. Pjesët përbërëse të artikullit/produktit duhet të kenë përputhshmëri të saktë dhe mbi to duhet të shënohen shenjat e prerjes dhe të bashkimit me njëra-tjetrën. Të gjitha pjesët e artikullit duhet të pozicionohen në tekstil në drejtim të fijeve të bazës.

Prerja

Gjatë procesit të prerjes nuk duhet të ketë devijime në fletët e fundit të dyshekut. Rekomandohet që dysheku të mos ketë më shumë se 100 fletë. Kujdes duhet të bëhet dhe në pjesët e harkuara të detajeve që buzët e prera që të mos jenë me dhëmbëza.

Markimi i pjesëve përbërëse të artikullit

Ky proces duhet të garantojë që të gjitha detalet e produktit të kenë të njëjtën ngjyrë, pa tonacione të dukshme.

Kollaritja


Ngjitja e materialit tekstil kollaritës duhet të bëhet me presë speciale në presion 2–3 bar, me avull, në temperaturën 130–140 °C, me kohëzgjatje 8–10 sekonda. Ky proces duhet të kryhet sa më i saktë, në mënyrë që produkti mos të humbasë formën fillestare pas hekurosjes me avull, larjes dhe lagies nga shiu. Nuk lejohet kollaritja me shtesa. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet prerjes së detaleve. Nuk duhet të mbeten shenja të hekurit/presës në tekstil. Adezivi nuk duhet të depërtojë në anën tjetër të tekstilit.

5. NDËRTIMI I KOSTUMIT

Udhëzimet teknike të ndërtimit dhe prodhimit të kostumit të shërbimit civil për meshkuj.

Kjo skemë mund të pësojë ndryshime ose përmirësime pasi të jetë aprovuar prototipi zyrtar. Çdo ndryshim ose përmirësim duhet të reflektohet tek dokumenti i specifikimeve teknike dhe mund t'i bashkëngjiten këtij dokumenti vetëm nga grupi i punës së specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit.


I. XHAKETA



Xhaketa për meshkuj është e njëjtë në tekstil dhe ngjyrë me atë të femrave, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për meshkuj dhe kopsave, të cilat duhet të jenë në anën e djathtë.

Pjesët përbërëse të xhaketës:

- Pjesa e përparme (me dy pjesë)
- Dy xhepa fileto me kapakë
- Dy pjesë anësore (fianket)
- Dy paramontura
- Jaka e poshtme dhe e sipërme
- Pjesa e pasme (me dy pjesë)
- Dy mëngë
- Astari i brendshëm



PJESA E PËRPARME E XHAKETËS

Pjesët e përparme. (1) Buzët e pjesës së përparme duhet të përshkohen vertikalisht nga një tegel zbukurues sipërfaqësor një gjilpërësh me distancë rreth 1mm nga buza. Tegeli duhet të fillojë në cepin e poshtëm dhe duhet të përfundojë në afërsi të jakës.

Për përforcimin e strukturës së xhaketës duhet të përdoret frazelinë termo adesive. Frazelina duhet të vendoset në të gjithë sipërfaqen e copës. Shtresa përforcuese duhet të jetë e fshehur mes astarit dhe tekstit të xhaketës.

Jaka e poshtme duhet të jetë standarde me kulme. Duhet pasur kujdes që gjatë palosjes së jakës mos të shfaqen defekte.

Pencat (2) duhet të fillojnë tek gjoksi dhe përfundojnë në anë të pjesës së sipërme të xhepave të mëdhenj.

Kopsat. Xhaketa duhet të jetë e pajisur me dy kopsa plastike me diametër 25 mm.

Kopsat duhet të qepen në anën e djathtë të xhaketës në një distancë 12 cm nga njëra-tjetra. Vendosja e kopsave të mëdha në xhakete duhet të bëhet sipas ilustrimit të mësipërm.

Vrimat e kopsave duhet të hapen në pjesën e majtë (të veshur) të xhaketës me drejtim horizontal.

Gjatësia e vrimave të kopsave duhet të jetë 30 mm, distanca e vrimave nga buza e xhaketës duhet të jetë 15 mm ndërsa distanca e vrimave nga njëra-tjetra duhet të jetë 12 cm.

Vrima e parë duhet të hapet atje ku fillon thyerja e jakës.

Fundi i xhaketës (3) duhet të përfundojë me një palosje 3 cm të përforcuar me frazelinë adezive me lartësi 4 cm. Palosja duhet të jetë nga brenda. Në fillim vendoset frazelina adesive pastaj bëhet palosja.

Vatat duhet të përbëhen nga një shtresë vatin e përforcuar në të dy anët me tekstil adeziv me thurje garniturë (1:1).

Vatat duhet të kenë formë ovale nga njëra anë dhe të drejtë nga ana tjetër.

Ajo duhet të qepet në brendësi të xhaketës, tek linja e supeve. Brinja e drejtë duhet të qepet tek tegeli i gavaturës ndërsa brinja rrethore duhet të jetë e lirë.

Vatina duhet të jenë prej materiali 100% poliamid.

JAKA E SIPËRME (5)

Jaka duhet të përbëhet nga dy shtresa tekstili me ngjyrë blu të errët të përforcuara me frazelinë termoadezive mes tyre.

Dy shtresat e tekstit duhet të bashkohen me njëra-tjetrën nëpërmjet një tegeli linear një gjilpërësh me distancë 1 mm nga buza e jakës.

Thellësia e jakës tek kulmet duhet të jetë rreth 7.5 cm. Kjo përmasë duhet të ndryshojë proporcionalisht me masën e xhaketës.

Jaka e sipërme, gjuhëza dhe trupi i xhaketës duhet të bashkohem me anë të tegelave linearë një gjilpërësh me distancë rreth 1 mm nga buzët.

PARAMONTURAT

Të dy pjesët e përparme të xhaketës duhet të pajisen me paramontura me drejtim vertikal. Ato duhet të jenë dy pjesë tekstili të prera me formën e buzës së xhaketës dhe duhet të qepen nga brenda.

Paramonturat duhet të jenë të përforcuara me frazelinë termoadezive për paramonturë. Shtresa përforcuese prej frazeline termoadezive duhet të bashkohet me shtresën e paramonturës në tranxhë me avull të nxehtë.

PJESËT ANËSORE (FIANKET) (6)

Fianket nuk kanë nevojë për përforcim me shtresa përforcuese.

PJESA E PASME E XHAKETËS (7)

Pjesa e pasme e xhakëtës duhet të përbëhet nga dy pjesë.

Çarja e pasme e xhakëtës duhet të ketë lartësi rreth 18 cm dhe thellësi 4 cm. Ana e majtë duhet të jetë mbi anën e djathtë.

Çarja duhet të jetë e përforcuar me shtresë frazeline dhe në pjesën e sipërme çarja duhet të jetë e kufizuar me anë të tegelit qepës në drejtim transversal.

Fundi i xhakëtës duhet të përfundojë me një palosje 3 cm të përforcuar me frazelinë termoadezive me lartësi 4 cm. Palosja duhet të jetë nga brenda. Në fillim vendoset frazelina pastaj bëhet palosja.

ASTARI

Trupi i xhakëtës, mëngët, kapakët e xhepave dhe xhepat duhet të jenë të veshur nga brenda me astar të brendshëm. Astar duhet të ndahet në gjashtë pjesë kryesore (katër pjesë përpara dhe dy pjesë mbrapa) të bashkuara ndërmjet tyre me anë të tegelit qepës një gjilpërësh. Në linjën fundore të xhakëtës astari përfundon me një shtesë rreth 1,5 cm.

XHEPAT (4)


Xhaketa duhet të pajiset me dy xhepa me konstruktion të brendshëm me kapak me fileto, një në të majtë dhe një në të djathtë.

Përmasat e kapakut duhet të jenë 13 cm – 16 cm x 5.6 cm: 0.6 cm fileto dhe 5 cm kapaku.

Filetot dhe kapaku i xhepit duhet të jenë të përforcuara me frazelinë të lehtë termoadezive.


Astar i xhepit duhet të qepet me tekstil me përbërje 100% poliester.

Xhepat duhet të qepen sipas ilustrimit të mësipërm të xhakëtës. Buzët e sipërme të kapakëve të xhepave duhet të jenë në linjën e belit (midis dy kopsave). Xhepat nuk duhet të kenë asnjë tegel qepës të dukshëm




MËNGËT (8)

Krahu i djathtë



Palosje

Krahu i majtë




Mëngët duhet të përbëhen nga dy pjesë: mënga e sipërme dhe mënga e poshtme. Dy pjesët duhet të qepen me njëra-tjetrën me tegel linear një gjilpërësh.

Mëngët duhet të përfundojnë me çarjen e kopsave, me lartësi 8 cm dhe thellësi rreth 4 cm. Buza e sipërme duhet të mbivendoset mbi të poshtmen.


Mbyllja e çarjes duhet të bëhet me anë të tre kopsave plastike me diametër 15 mm. Për secilën kopsë të duhet hapur përkatësisht nga një vrimë me gjatësi 20 mm.

VELCRO

Khaketa duhet të ketë në përbërjen e saj një element *Velcro* femër me formën e stemës së policisë, të qepur në anën e majtë të gjoksit, me përmasa 70 x 80 mm.



II. PANTALLONAT E KOSTUMIT TË SHËRBIMIT CIVIL PËR MESHKUJ



Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pjesët përbërëse të pantallonave:

- Qemeri
- Dy pjesët për këmbë
- Dy xhepa e përparmë
- Dy xhepa e pasmë

QEMERI (1)

Lartësia e qemerit duhet të jetë 3.5 cm.

Qemeri duhet të jetë i përbërë nga dy shtresa tekstili me përmasa të njëjta (brenda dhe jashtë) dhe nga dy shtresa të brendshme përforcuese. Renditja e shtresave të qemerit duhet të bëhet si më poshtë:

1. Shtresa e jashtme prej tekstili të njëjtë me pantallonat.
2. Shtresa e dytë e brendshme me lartësi rreth 6 cm prej tekstili termoadeziv.
3. Shtresa e tretë përforcuese me frazelinë termoadezive me vrima.
4. Shtresa e brendshme (e pantallonave) me tekstil Silesia me lartësi rreth 7 cm.

Qemeri duhet të bashkohet me pantallonat me tegel të padukshëm.

Qemeri duhet të ketë një shtesë prej 3 cm (nga vijat e zinxhirit) në dy anët. Në njërin shtesë duhet të hapet vrima e kopsës me gjatësi 25 mm ndërsa në tjetrën duhet të qepet kopsa e pantallonave.

Në anën e brendshme të qemerit, në linjë me zinxhirin duhet të montohet një kapëse e thjeshtë me mekanizëm “femër-mashkull”.



Kopsat duhet të jenë Nr. 34 (21 mm) me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsave duhet të kryq.

Ylyqet.(2) Pantallonat duhet të kenë gjithsej 6 ylyqe me gjatësi 5 cm dhe gjerësi 1 cm. Dy përpara dhe katër mbrapa. Ylyqet e përparme duhet të vendosen në linjën e vijës së hekurosjes së pantallonave. Dy ylyqe të pasme duhet të vendosen të baraslarguar nga linja qendrore e pantallonave dhe dy të tjerët të baraslarguar nga pencat.

Ylyqet duhet të jenë të përbërë nga dy shtresa tekstili ngjyrë blu (si fundi) dhe një shtresë përforcuese prej frazeline termoadezive.

Ato duhet gjithashtu të përforcohen në të dy skajet me traveta ngjyrë blu të errët.

DY PJESËT E KËMBËVE

Sallkia (3) duhet të ndërtohet me dy pjesë: pjesa e mbuluar dhe mbulesa (e zinxhirit). Pjesa e mbuluar duhet të jetë e veshur me tekstil *Silesia* nga brenda dhe me tekstilin e pantallonave nga jashtë ndërsa mbulesa duhet të qepet nga të dyja anët me tekstilin e pantallonave.

Zinxhiri i sallkisë. Gjatësia e zinxhirit mund të ndryshojë sipas masave, nga 16–18 cm.

Zinxhiri duhet të jetë me fiksime tek koka në mënyrë që të mos hapet vetë gjatë veshjes.

Ngjyra e zinxhirit duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e pantallonave.

Pencat (4) Në pjesën e pasme të pantallonave, poshtë qemerit, duhet të qepen dy penca vertikale me gjatësi 7 cm, një në të majtë dhe një në të djathtë.

Astari. Pantallonat duhet të jenë të veshura me astar vetëm në pjesën e përparme, deri poshtë linjës së gjurit. Astari duhet të jetë prej materiali me përbërje 100% viskoze.

Tegeli anësor i këmbëve dhe fundet e pantallonave duhet të jenë të profiluara me syzator.

XHEPAT (5)

Xhepat diagonalë. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonalë. Hapja e xhepit duhet të fillojë poshtë qemerit, në një distancë 3 cm nga tegeli anësor i pantallonave dhe të përfundojë po tek tegeli anësor.

Xhepi duhet të jetë 16 cm e gjatë. Ai duhet të përforcohet në të dy ekstremitetet e tij me travetë.

Xhepat duhet të përshkohen gjatë gjithë gjatësisë nga një tegel linear me distancë 7 mm nga buza e jashtme.

Në pjesën e dukshme (mostra) xhepat duhet të jenë të veshur me tekstil të njëjtë me pantallonat. Astari i xhepave duhet të jetë tekstil *silesia*.

Xhepat fileto. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të pasmë me fileto të dyfishtë të pozicionuar menjëherë poshtë pencave. Filetoja e dyfishtë dhe tekstili përreth hapjes e xhepit duhet të përforcohen me frazelinë termoadezive.

Astari i xhepit duhet të jetë prej tekstili *silesia*.

Hapja e xhepave me fileto do të ndryshojë sipas prerjes, nga 13–14 cm.

Xhepat duhet të jenë edhe me kopsë. Vrimat e kopsave duhet të kenë gjatësi 25 mm dhe distancë rreth 1cm nga filetoja e poshtme.

Kopsat duhet të jenë $d = 15$ mm me ngjyrë blu të errët. Qepja e kopsave duhet të bëhet kryq. Kopsat duhet të qepen në një distancë prej 1.5 cm nga filetoja e sipërme e xhepave


6. KUSHTE TË DOMOSDOSHME

- Produkti përfundimtar duhet të jetë identik me kampionin e aprovuar gjatë procedurave të vlerësimit.
- Filli qepës duhet të ketë ekzakt karakteristikat e përcaktuara tek *Specifikimet Teknike*.
 - Tegelat e qepjes së kostumit duhet të jenë me hap 6 shpime në 1 cm.
 - Tegelat duhet të jenë të drejtë, uniformë, simetrik dhe nuk duhet të kenë shqepje ose defekte.
 - Tegelat duhet të jenë të fortë dhe nuk duhet të shqepen nëse tërhiqen me duar. Fortësia e tegelave duhet të jetë mbi 12N.
 - Tegelat duhet të jenë të përforcuar në ekstremitete.
- Të gjithë elementët e kostumit duhet të jenë simetrik.
- Përpara se të fillojë prodhimi i artikujve, prodhuesi duhet të bëjë testimin e stabilitetit dimensional (aftësinë e tekstilit për të ruajtur formën fillestare pas prerjes, qepjes, larjes, hekurosjes, etj.)
- Në varësi të llojit, tekstilet nuk duhet të lahen ose hekurosen në temperatura që kalojnë kufijtë e specifikuar nga prodhuesi në skedën teknike sipas EN ISO 3758 ose që janë specifikuar në këtë dokument. Gjithashtu tekstili nuk duhet të fitojë shkëlqim gjatë hekurosjes.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë të lartë ndaj rrezatimit Ultraviolet.
- Tekstili duhet të ketë rezistencë maksimale ndaj përdorimit dhe konsumit.
- Tekstili i kostumit duhet të ruajë hekurosjen për një kohë të gjatë.
- Kostumi duhet të jetë i lehtë për tu mirëmbajtur.
- Kufiri i lejuar i gabimit tek përmasat e kostumeve është $\pm 2\%$. Tek qepja e jakës nuk lejohet asnjë kufi gabimi.
- Kopsat duhet të kenë pamje të rregullta. Nëse hidhen me forcë në tokë nga një lartësi prej 2 metrash, kopsat nuk duhet të thyhen, plasariten, gërvishten ose të pësojnë dëmtime të tjera.
- Elementëve *Velcro* nuk duhet t'u dalin fijet anësore gjatë përdorimit të shpeshtë.
- Tekstilet, materialet dhe aksesorët e përdorur në prodhimin e këtij artikulli nuk duhet të përmbajnë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut apo AZO ngjyrues. Për produktin

- e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testimeve sipas standardeve:
- EN ISO 14362-1:2017
 - EN ISO 14362-3:2017
 - EN ISO 3071:2006 (vlera limit e pH për veshjet që kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 7.5 dhe për veshjet që nuk kanë kontakt direkt me lëkurën është 4.0 - 9.0)
- Prodhuesi i artikullit të mësipërm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e standardit ISO 9001.

7. AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

Të gjithë artikujt e kostumit të shërbimit civil për meshkuj duhet të pajisen me etiketa prej tekstili, në të cilat duhet të shkruhet ky informacion: emri i fabrikës, viti i prodhimit, përmasa, përbërja dhe instruksionet e mirëmbajtjes.



Kjo etiketë duhet të qepet në brendësi të xhaketës, tek astari, në anën e majtë, rreth 20 cm nga fundi i xhaketës. Po në këtë etiketë duhet të vendosen edhe kopsat rezervë. Tek pantallonat duhet të qepet një etiketë në qendër të qemerit, mbrapa (në brendësi).

Në etiketën e pantallonave duhet të qepet edhe 1 kopsë rezervë plastike blu për pantallonat.

Në momentin e dorëzimit kostumet duhet të jenë të pastër, të hekurosur, pa njolla dhe të varur në kremastarë (varëse) të fortë plastikë.

Për kostumin nevojiten 1 kremastar për xhaketën dhe pantallonat. Kremastari për xhaketën duhet të jetë i përshtatshëm për të ruajtur formën e supeve dhe të jetë i pajisur me bosht transversal për varjen e pantallonave. Boshti i kremastarit duhet të jetë i veshur me “push” që pantallonat të mos rrëshqasin apo të pësojnë rrudha.

Khaketa dhe pantallonat duhet të futen bashkë në një çantë mbrojtëse prej pambuku, me mbyllje me zinxhir në pjesën qendrore dhe me etiketë transparente për vendosjen e emrit të punonjësit.

Artikujt duhet të paktohen me nga 10 kostume për kuti.

Kartoni i kutive (me peshë rreth 600 gr/m²) duhet të jetë i përshtatshëm për transportin e sigurt të produkteve. Çdo kuti duhet të jetë e pajisur me një etiketë me adeziv, në të cilën duhet shënuar masa e kostumit, viti i prodhimit, sasia dhe emri i fabrikës prodhuese. Kutitë duhet të jenë të padëmtuara dhe të izoluara me shirit ngjitës (natriban).



ANEKS - Lista e testeve që duhet të shoqërojnë ofertën teknike të këtij artikulli dhe referencat për metodat e kryerjes së këtyre testeve

Analizat	Metodat e testeve sipas standardeve EN - ISO*
Ngjyra	EN ISO 105-J03:2009 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa J03: Llogaritja e ndryshimit të ngjyrës
Përbërja %	EN ISO 1833: 2019 Tekstile - Analizat kimike sasiore ose CEN ISO/TR 11827:2016 Tekstile - Testimi i përbërjes - Identifikimi i fibrave
Thurja	ISO 7211- 1: 1984 Tekstilet -Pëlhurat e endura.
Masa gr/m²	ISO 3801:1977 / EN 12127:2005 Tekstile - Pëlhurat e endura - Përcaktimi i masës për njësi të gjatësisë dhe masës për njësi të sipërfaqes.
Qëndrueshmëria e ngjyrës	EN ISO 105 -C06: 2010 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në larje shtëpiake dhe lavanderi. (pas 5 cikle të larjes)
	EN ISO 105- E01: 2013 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E01: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj ujit
	EN ISO 105-E04 :2013 Tekstile - Prova për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Pjesa E04: Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj djersës acide dhe alkaline
	EN ISO 105 - X12: 2016 Tekstile - Testet për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës në fërkim, në të thatë dhe në të lagur.
Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës (rrezatimit UV)	EN ISO 105- B02: 2014 Tekstile - Provat për qëndrueshmërinë e ngjyrës - Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj dritës artificiale: Testi me llambë me hark ksenoni
Qëndrueshmëria në fërkim	EN ISO 12947-2: 2016 Tekstilet - Përcaktimi i qëndrueshmërisë së pëlhurave në fërkim me metodën Martindale.
Efekti pilling (kokërrzimi)	EN ISO 12945-2: 2005 Tekstilet - Përcaktimi i prirjes së pëlhurave për të shprishur sipërfaqen dhe për t'u pushëzuar - Pjesa 2: Metoda e modifikuar Martindale
Azo Ngjyrues	Për produktin e gatshëm duhet të paraqiten rezultatet e këtyre testeve sipas standardeve: a. EN ISO 14362-1:2017 b. EN ISO 14362-3:2017
ph	EN ISO 3071:2006
Procedura e trajtimit	EN ISO 3758

*Shënim: Grupi i specialistëve teknikë të Policisë së Shtetit do të pranojë skeda teknike të materialit bazë, në të cilat figurojnë standarde dhe metoda testimi ndërkombëtare në fuqi, ekuivalente me ato të përmendura në tabelën e mësipërme.

KOLAUDIMI

Policia e Shtetit ka të drejtën që të garantojë cilësinë e produktit final nëpërmjet një mekanizmi kontrolli që quhet *kolaudim*. Kolaudimi përfshin këto masa:

1. Verifikimi i fletë-analizës së tekstileve.
2. Matjet dhe provat fizike të artikujve të plotë ose elementëve individualë të tyre.
3. Krahasimin e rezultateve të matjeve me specifikat e përcaktuara në dokumentin e *Specifikimeve Teknike*.

Vetëm pasi të jenë bërë të gjitha verifikimet përkatëse nga grupi i kontrollit të cilësisë dhe rezultatet të kenë dalë pozitive, siç është parashikuar në kontratë dhe në dokumentin e *Specifikimeve Teknike*, *Policia e Shtetit* do të bëjë pranimin e produktit përfundimtar. Artikujt konsiderohen të pranuar vetëm kur plotësohen të gjitha kërkesat e *Specifikimeve Teknike*.

GARANCIA

Afati i garancisë duhet të jetë 1 vit për artikujt që e kanë afatin e përdorimit 1 vit dhe të paktën 2 vjet për artikujt që kanë afatin e përdorimit mbi 2 vjet. Në rastet kur artikulli pëson defekt si pasojë e mosrespektimit të kërkesave teknike të specifikuara në këtë dokument, Operatori Ekonomik duhet të sigurojë riparimin ose zëvendësimin e plotë të artikullit, pa pagesë, konform specifikimeve teknike në këtë dokument. Lëvrimi i mallit duhet të shoqërohet detyrimisht me deklaratën e garancisë. Afati i garancisë fillon në momentin e kolaudimit.

AUTORËSIA

Specifikimet Teknike të artikujve të mësipërm janë pronë e *Policisë së Shtetit* dhe mund të përdoren vetëm nga strukturat e këtij institucioni. Kopjimi dhe shumëfishimi i *Specifikimeve Teknike* të këtyre artikujve është i ndaluar.